



Manual për vëzhgimin e fushatave zgjedhore dhe mjediseve politike

Manual për vëzhgimin e fushatave zgjedhore dhe mjediseve politike




Ky dokument është publikuar fillimisht nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në gjuhën angleze në vitin 2021 me titull “Handbook for the Observation of Election Campaigns and Political Environments”. Versioni në gjuhën shqipe është përkthim, i përgatitur dhe i publikuar nga projekti “Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe me financim nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Në rast mospërputhjes mes teksteve në të dyja gjuhët, ju lutemi referojuni versionit origjinal në anglisht. Për informacion të mëtejshëm lidhur me projektin dhe për të hyrë në bibliotekën e Projektit, jeni të lutur të futeni në adresën:
<http://www.osce.org/odihr/wb>



Funded by
the European Union

With funding
from the  Austrian
Development
Agency



Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
Ul. Miodowa 10
00-251 Warsaw
Poland

www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe për qëllime të tjera jotregtare, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim, ku të thuhet se burimi është OSBE/ODIHR-i.

ISBN 978-83-66690-70-7

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Formulimi grafik nga Dejan Kuzmanovski
Kopertina, Kapitulli 1, Kapitulli 2, Kapitulli 3, Kapitulli 4: OSBE/Dejan Kuzmanovski



Pasqyra e lëndës

Parathënie	5
Shkurtesat	7
Hyrje	8
1. Qëllimi i Manualit	8
2. Si të përdoret ky Manual	9
KAPITULLI I: DETYRIMET, ANGAZHIMET DHE STANDARDET E NEVOJSHME PËR ZGJEDHJE DHE FUSHATA ZGJEDHORE TË QENËSISHME	12
1. Detyrimet dhe standardet ndërkombëtare	14
a. DUDNj-ja, PNDCP-ja dhe Komentet e Përgjithshme	14
b. Instrumente të tjera të OKB-së	17
2. Angazhimet e OSBE-së	19
a. Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990	19
b. Standardet dhe parimet zgjedhore në dokumente të tjera të OSBE-së	22
3. Instrumentet rajonale në zonën e OSBE-së	25
4. Praktika e mirë	27
KAPITULLI II: KONTEKSTI DHE SFONDI POLITIK	30
1. Vlerësimi i lirive themelore	32
a. Liria e tubimit	33
b. Liria e organizimit	34
c. Liria e shprehjes dhe e mendimit	35
d. Liria e lëvizjes	37
e. E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake	37
2. Rrethanat e posaçme	41
a. Zgjedhjet në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme	41
b. Dhuna politike dhe zgjedhore	43
3. Aspektet e situatës zgjedhore	46
a. Sistemi politik dhe përbërja e parlamentit dhe qeverisë (që u mbaron mandati)	46
b. Zhvillimi i zgjedhjeve të mëparshme	46

c. Elemente të tjera që duhen marrë parasysh	47
KAPITULLI III: FUSHATA ZGJEDHORE	50
1. Vlerësimi i mjedisit të fushatës	52
a. Respektimi i lirive themelore në fushatën zgjedhore	53
b. Klimë e paanshme dhe e lirë e fushatës	57
c. Trajtimi i barabartë dhe barazia e mundësive	60
d. Keqpërdorimi i burimeve administrative	62
e. Pjesëmarrja e grave, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara në fushatën zgjedhore	64
f. Elemente të tjera për t'u marrë parasysh	69
i. Kohëzgjatja e periudhës së fushatës	69
ii. Normimi i tepërt i fushatës	64
iii. Zhvillimet paszgjedhore	70
2. Vlerësimi i zhvillimit të fushatës	71
a. Takimet me garuesit zgjedhorë	73
i. Temat e fushatës	74
ii. Metodot e fushatës	75
b. Takimet me aktorët e tjerë	76
i. Organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe komuniteti akademik	76
ii. Komuniteti ndërkombëtar	77
KAPITULLI IV: GJETJET E VAGJ-VE	80
1. Roli i Koordinatorit të VAGJ-ve për vëzhgimin e fushatës zgjedhore	80
2. Komunikimi me VAGJ-të	82
3. Caktimi i detyrave dhe udhëzimi i VAGJ-ve	83
4. Grumbullimi dhe përmbledhja e gjetjeve të VAGJ-ve	86
a. Raportet Javore të VAGJ-ve	87
b. Raporti i Incidenteve	89
c. Raportet e Tubimeve	90
d. Raportet për çështjet e posaçme dhe formularët e fushatave	92
e. Raportet Përmbledhëse Javore	93
f. Raportet Përfundimtare të VAGJ-ve	94
5. Pretendimet në lidhje me fushatën	94
a. Llojet e pretendimeve	95
b. Vërtetimi i pretendimeve	96
SHTOJCA I – MATERIALET DHE BURIMET	99

Parathënie

Zgjedhjet janë themeli i demokracisë. Ato janë procese të ndërlikuara me natyrë politike, ligjore dhe organizative, të cilat zhvillohen në një kontekst politik më të gjerë të zhvillimeve vendase dhe ndërkombëtare. Mjedisi politik, ku zhvillohen zgjedhjet, mund të ketë ndikim të madh, madje edhe vendimtar, tek mbarëvajtja dhe rezultati i tyre. Që zgjedhjet të jenë qenësishëm demokratike, kërkohet respektimi i të drejtave dhe lirive themelore, si gjatë, ashtu edhe përtej periudhës zyrtare të zgjedhjeve dhe fushatës. Gjithashtu, janë shumë të rëndësishme kushtet e barabarta për konkurrim të drejtë dhe aftësia e votuesve për të zgjedhur në mënyrë të informuar mes disa ofertave politike.

Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë marrë angazhimin të zhvillojnë zgjedhje demokratike. Në dokumentin e Kopenhagenit, dokument themelor i OSBE-së, i vitit 1990, thuhet se: “vullneti i popullit, i shprehur lirisht dhe në mënyrë të drejtë, përmes zgjedhjeve periodike dhe të vërteta, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverie”. Gjithashtu, në të njëjtin dokument, shtetet pjesëmarrëse ranë dakord për një diapazon të gjerë angazhimesh në lidhje me të drejtat e njeriut, duke përcaktuar për herë të parë aq hollësisht, kriteret e nevojshme që një palë zgjedhje të quhen qenësishëm demokratike.

Fushatat zgjedhore janë pjesë shumë e rëndësishme e proceseve zgjedhore, ku kandidatët konkurrojnë për të marrë mbështetjen e votuesve. Gjatë fushatave zgjedhore, aktorët politikë u japin zgjedhësve energji, i gjallërojnë dhe i mobilizojnë, por njëkohësisht, në këto periudha, vihen në provë liritë themelore. Fushatat zgjedhore u japin mundësi të gjithë aktorëve zgjedhorë, përfshirë dhe autoritetet, partitë politike dhe votuesit, të tregojnë respekt për liritë themelore dhe të drejtat e njeriut. Ajo që ndodh veçanërisht në këtë kohë shërben si lakmus për të matur zbatimin e angazhimeve të OSBE-së në fushën e zgjedhjeve. Vëzhgimi i fushatave zgjedhore dhe vlerësimi i mjedisit politik, ku zhvillohen zgjedhjet, kanë qenë pjesë përbërëse e veprimtarive të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në lidhje me zgjedhjet, që prej krijimit të saj.

Fushatat zgjedhore janë veprimtari të shumanshme dhe kërkohen elemente të ndryshme për t'i vëzhguar në mënyrë të plotë dhe sistematike. Veçanërisht, së bashku me vlerësimin e respektimit të lirive themelore dhe

të drejtave të njeriut, për të pasur vëzhgim të mirë të fushatës zgjedhore dhe mjedisit ku zhvillohet, duhen shqyrtuar aspektet financiare të fushatës, si dhe pjesëmarrja, gjithëpërfshirja dhe trajtimi i grupeve të papërfaqësuarara mjaftueshëm historikisht në jetën politike, të tilla si: gratë, pakicat kombëtare apo personat me aftësi të kufizuara. Megjithëse ky Manual përmban mjetet bazë për vëzhgimin e fushatave zgjedhore, ai duhet lexuar në mënyrë të kombinuar me botimet e tjera të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet, të tilla si: manualët për vëzhgimin e financimit të fushatave dhe për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, si dhe dokumentet e tjera që përmenden në Shtojcën I. Është e rëndësishme të thuhet se ky Manual vetëm sa e prek zhvillimin e fushatave zgjedhore në internet. Ky aspekt shumë i rëndësishëm trajtohet me hollësi në Udhëzuesin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Fushatave Zgjedhore në Rrjetet Sociale, botuar njëkohësisht me këtë material.

Matteo Mecacci
Drejtor i ODIHR-it

Shkurtesat

KEGJFDG – Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

KSHP – Komënuelthi i Shteteve të Pavarura

KDPAK - Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

KEDNJ - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

OAZ-të – Organet e Administrimit Zgjedhor

BE – Bashkimi Evropian

KDNJ – Këshilli për të Drejtat e Njeriut

PNDCP – Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

KNEDR – Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial

Koordinatori i VAGJ-ve – Koordinator i vëzhguesve afatgjatë

VAGJ-të – Vëzhguesit Afatgjatë

MVN – Misioni i Vlerësimit të Nevojave

ODIHR – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

DUDNJ – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

KKBKK – Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit

RPU – Rishikimi Periodik Universal

Hyrje

1. Qëllimi i Manualit

Ky manual parashtron qasjen e ODIHR-it ndaj vëzhgimit dhe vlerësimit të fushatave zgjedhore dhe mjediseve politike, ku zhvillohen këto të fundit. Gjithashtu, ai synon të ravijëzojë dhe të zhvillojë më tej metodologjinë ekzistuese të vëzhgimit të zgjedhjeve, e cila është ndërtuar përgjatë vëzhgimit të zgjedhjeve në rajonin e OSBE-së në 30 vite dhe që njihet gjerësisht për gjithëpërfshirjen dhe qasjen sistematike.¹

Metodologjia që përshkruhet në Manual, vlen për të gjitha llojet e veprimtarive të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet, përfshirë dhe Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Misionet e Kufizuara të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Misionet e Vlerësimit të Zgjedhjeve dhe Ekipet e Specializuara të Zgjedhjeve.² Edhe organizatat e tjera vëzhguese ndërkombëtare dhe vendase mund të përfitojnë nga Manuali dhe e njëjta gjë vlen për ato shtete pjesëmarrëse të OSBE-së që synojnë të përmirësojnë legjislacionin dhe praktikën në lidhje me fushatat zgjedhore.

Ndonëse Manuali synon të shërbejë si dokument reference për të gjithë ekspertët zgjedhorë të ODIHR-it, ata Analistë Politikë që kanë përgjegjësinë të vlerësojnë kontekstin politik dhe mjedisin e fushatës zgjedhore, do të përfitojnë gjithashtu drejtpërsëdrejti prej tij. Në varësi të përmasës dhe fushës së veprimit të vëzhgimit të zgjedhjeve, Analistët Politikë mund të bazohen tek gjetjet e bëra nga Vëzhguesit Afatgjatë (VAGJ-të) – të cilët vendosen për disa javë në një shtet të caktuar – si ndihmë për të vlerësuar procesin në të gjithë vendin. Gjithashtu, përmes Manualit synohet të mbështetet puna e VAGJ-ve dhe Koordinatorëve të Vëzhguesve Afatgjatë (Koordinatorëve të VAGJ-ve) gjatë grumbullimit të gjetjeve të vëzhgimit të fushatës nga pjesë të ndryshme të vendit. Duke qenë se fushatat zgjedhore dhe mjedisi ku zhvillohen kanë natyrë shumështrësore, është i domosdoshëm bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet analistëve të misionit – kjo nënvizohet edhe në kapitujt në vijim. Në veçanti, kjo vlen për Analistin Politik dhe Analistin Ligjor gjatë vlerësimit të respektimit të lirive themelore në kontekstin e përgjithshëm apo gjatë shqyrtimit të rregullave të fushatës, si dhe për Analistin Politik

1 ODIHR-i është i angazhuar të shqyrtojë dhe përsosë rregullisht metodologjinë e tij për vëzhgimin e zgjedhjeve në përputhje me detyrat përkatëse, të dhënat nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (Vendimi 19/06 i Këshillit Ministror). Ky botim është zhvilluar në bazë të kontributeve jashtëbuxhetore të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

2 Për më shumë, shih Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (Botimi i gjashtë).

dhe Koordinatorin e VAGJ-ve gjatë vlerësimit të zhvillimit të përgjithshëm të fushatës në rajonet e ndryshme të vendit.

Analistët Politikë kanë rol shumë të rëndësishëm për vlerësimin e kontekstit politik dhe të fushatave zgjedhore. Ata janë pjesë e shumicës së misioneve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe kanë si rol parësor ato pjesë të raporteve të misionit, që trajtojnë “Sfondin dhe Kontekstin Politik” dhe “Mjedisin e Fushatës”. Natyra e shumanshme e fushatave zgjedhore i detyron Analistët Politikë të kryejnë hulumtime të gjera dhe gjithëpërfshirëse, por gjithsesi ata duhet të tregohen të strukturuar dhe të përmbledhur gjatë raportimit të gjetjeve. Hulumtimi i tyre plotësohet me anë të takimeve me një diapazon të gjerë aktorësh zgjedhorë, me qëllim përforcimin dhe faktimin e vlerësimit të mjedisit të fushatës zgjedhore. Për të analizuar situatën e përgjithshme dhe kushtet e pjesëmarrjes në fushata, goftë si kandidatë, apo si votues, për gratë, pakicat kombëtare, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë, Analisti Politik duhet të takohet me përfaqësuesit e këtyre grupeve të papërfaqësuar mjaftueshëm historikisht. Më tej, Analisti Politik është përgjegjës edhe për hartimin e rekomandimeve në lidhje me zhvillimin e fushatës zgjedhore dhe/ose për mjedisin e përgjithshëm, në të cilin zhvillohen zgjedhjet.

2. Si përdoret ky Manual

Manuali mbështetet tek detyrimet dhe standardet ndërkombëtare përkatëse për zgjedhjet demokratike dhe përqendrohet veçanërisht tek angazhimet e OSBE-së dhe tek praktikat e mira ndërkombëtare. Qëllimi është të parashtrohet një paketë e përgjithshme elementesh që duhen marrë parasysh për vlerësimin e sfondit politik dhe të kushteve të nevojshme për zhvillimin e fushatave zgjedhore të qenësishme dhe pluraliste. Në kapitullin e parë shqyrtohen në hollësi disa prej instrumenteve ndërkombëtare kryesore, për të cilat janë angazhuar shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Në kapitullin e dytë trajtohet vlerësimi i kontekstit politik, ku zhvillohen zgjedhjet. Angazhimet e OSBE-së i referohen proceseve dhe praktikave më të gjera që kërkojnë respektim të pluralizmit demokratik dhe të të drejtave të njeriut. Ato zgjedhje që respektojnë disa prej standardeve ndërkombëtare nga pikëpamja e procedurës, por që nuk janë pluraliste apo që zhvillohen në mjedise shtrënguese ku nuk respektohen si duhet të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, ka pak gjasa të karakterizohen si demokratike dhe në përputhje me standardet e vërtetësisë.

Në kapitullin e tretë trajtohen në mënyrë të posaçme vlerësimi dhe vëzhgimi i fushatës zgjedhore. Nuk mund të ketë zgjedhje demokratike pa shkëmbimin e lirë të ideve ndërmjet garuesve dhe ndërmjet garuesve dhe votuesve. Prandaj, pluralizmi politik dhe garantitë ligjore dhe praktike për lirinë e shprehjes, grumbullimit, organizimit, lëvizjes dhe për të drejtën e lirisë dhe sigurisë vetjake janë parakushte të nevojshme për fushata zgjedhore demokratike të qenësishme. Përveç të drejtave politike, të njohura ndërkombëtarisht, Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990, me të cilin janë pajtuar të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, ofron garanci politike të mëtejshme që votuesit dhe garuesit të gëzojnë një mjedis fushate të lirë dhe të ndershëm, si dhe mundësi të barabarta.

Në kapitullin e fundit jepen disa sugjerime praktike, kryesisht për Koordinatorin e VAGJ-ve dhe Analistin Politik, në lidhje me mënyrën e organizimit dhe konsolidimit të gjetjeve të shumta të fushatave rajonale. Duke qenë se proceset zgjedhore kanë karakteristikat e tyre dhe se fushatat zgjedhore zhvillohen sipas rrethanave të posaçme, veprimtaritë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve zbatohen duke pasur parasysh kontekstet e posaçme dhe hartohen për të pasqyruar elementet e dallueshme. Duke qenë se secila fushatë zgjedhore ka natyrë të mëvetshme, përmes këtij kapitulli synohet të ofrohen udhëzime bazë për Analistin Politik dhe Koordinatorin e VAGJ-ve, në lidhje me hedhjen e vëzhgimeve dhe gjetjeve rajonale në raporte, në mënyrë sistematike dhe të paraqitshme, si dhe në mënyrë të njëjësuar. Përveç metodave të rekomanduara për bashkëpunimin ndërmjet Analistit Politik dhe Koordinatorit të VAGJ-ve, si dhe formularëve dhe instrumenteve që sugjerohen për grumbullimin dhe përmbledhjen e gjetjeve të VAGJ-ve, anëtarët e ekipit kryesor mund të përdorin mjete të tjera, që kanë nivel të mjaftueshëm besueshmërie, përfshirë dhe mjetet në internet, për grumbullimin e vëzhgimeve të fushatave rajonale.



KAPITULLI I

DETYRIMET, ANGAZHIMET DHE STANDARDET E NEVOJSHME PËR ZGJEDHJE DHE FUSHATA ZGJEDHORE TË QENËSISHME

ODIHR-i vëzhgon dhe vlerëson aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, përfshirë kuadrin ligjor, të drejtat e votuesve e të kandidatëve, regjistrimin e kandidatëve, administrimin e zgjedhjeve dhe procedurat në ditën e zgjedhjeve, mjedisin e fushatës dhe atë të mediave, financimin e partive dhe të fushatës, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Vlerësimi kryhet në

kontekstin e përgjithshëm politik, në të cilin zhvillohen zgjedhjet, dhe kundrejt detyrimeve, standardeve dhe angazhimeve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit vendas.

E drejta ndërkombëtare publike përmban detyrime të kodifikuara në traktate, siç është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), të cilat kthehen në detyrim ligjor për palët nënshkruese. Deklaratat dhe angazhimet politike, përfshirë dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) apo Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, janë mekanizma detyruese politike. Dokumentet interpretuese të organeve të mbikëqyrjes së traktateve, qoftë me natyrë globale, siç është Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, apo me natyrë rajonale, siç janë gjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sqarojnë detyrimet që rrjedhin prej traktateve dhe kanë natyrë autoritare të lartë me bazë ligjore, edhe pse nuk përbëjnë detyrim ligjor për ato shtete që nuk kanë përfshirje të drejtpërdrejtë në çështje. Këto dokumente plotësohen më tej nga burime të tjera, që shpesh njihen si “instrumente me natyrë jodetyruese”, dhe nga praktikat e mira, që përfshijnë përmbledhjet e kodeve, mendimet ligjore, doracakët dhe manualët.

Në këtë kapitull shqyrtohen detyrimet, standardet dhe angazhimet kryesore ndërkombëtare në lidhje me zgjedhjet demokratike, që kanë të bëjnë me zhvillimin e fushatave dhe me kontekstin e gjerë politik, në të cilin zhvillohen zgjedhjet. Nëpërmjet disa dokumenteve të OSBE-së, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar t’u përmbahen këtyre instrumenteve universale dhe rajonale të të drejtave të njeriut.

Disa dokumente themelore të OSBE-së u kërkojnë shteteve pjesëmarrëse t’u përmbahen instrumenteve të tjera ndërkombëtare të njohura të të drejtave të njeriut, të miratuara në nivel global apo rajonal. Për shembull, me Aktin Përfundimtar të Helsinkit, të vitit 1975, shtetet pjesëmarrëse u angazhuan të “veprojnë në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të vitit 1948”, dhe të “përmbushin detyrimet e parashtruara në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të fushës, përfshirë, ndër të tjera, Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut”. Dokumenti i Madridit, i vitit 1983, u bën thirrje “atyre shteteve pjesëmarrëse që ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë, të shqyrtojnë mundësinë e aderimit në Konventa”. Dokumente të tjera të OSBE-së theksojnë rëndësinë e përqaimit të instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të protokolleve përkatëse fakultative, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e Këshillit të Evropës, e vitit 1950.³

3 Të 47 anëtarët e Këshillit të Evropës janë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.

1. Detyrimet dhe standardet ndërkombëtare

a. DUDNJ-ja, PNDCP-ja dhe Komentet e Përgjithshme

Parimet e zgjedhjeve demokratike lidhen në mënyrë të qenësishme me liritë themelore, të njohura shprehimisht nga disa instrumente universale të të drejtave të njeriut, përfshirë dhe **Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) të OKB-së, të vitit 1948**. Kjo e fundit përcakton të drejtat thelbësore për proceset zgjedhore, përfshirë liritë themelore:

- › E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake (Neni 3);
- › Liria e lëvizjes (Neni 13);
- › E drejta e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa u ndikuar, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë (Neni 19); dhe
- › Liria e tubimit paqësor dhe organizimit (Neni 20).

Posaçërisht për zgjedhjet, **Neni 21 i DUDNJ-së** thotë se “Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror, [...] shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira [...] të përgjithshme dhe votimi të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) i OKB-së, i vitit 1966, thekson dhe zgjeron disa prej të drejtave të mbrojtura nga DUDNJ-ja. PNDCP-ja është detyruese për të gjitha palët nënshkruese, të cilat bartin detyrimin t'i bëjnë këto të drejta të zbatueshme; kjo do të thotë se palët nënshkruese kanë rol madhor për t'u siguruar që qytetarët t'i gëzojnë këto të drejta në praktikë. Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë palë nënshkruese të PNDCP-së. Ndër të tjera, instrumenti normon që palët nënshkruese:

- › Të sigurojnë pa diskriminim të drejtat e parashikuara nga PNDCP-ja (Neni 2(1));
- › Të kërkojnë ndërmarrjen e hapave të nevojshëm, të tillë si miratimi i ligjeve apo masave të tjera, për t'i bërë të zbatueshme të drejtat që njihen nga PNDCP-ja (Neni 2(2));
- › Të sigurohen se individët, të cilëve u janë shkelur të drejtat apo liritë, të kenë të drejtën e një mjeti juridik të efektshëm (Neni 2(3));

- › Të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat civile dhe politike (Neni 3);
- › Të njohin të drejtën e lirisë dhe sigurisë vetjake (Neni 9);
- › Të garantojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit, si dhe të drejtën për të kërkuar dhe dhënë informacione dhe ide (Neni 19(2)); dhe
- › Të mbrojnë liritë e lëvizjes (Neni 12), tubimit paqësor (Neni 21) dhe të organizimit (Neni 22), si dhe të ndalojnë çdo kufizim të këtyre të drejtave, përveç atyre të parashikuara në ligj dhe që janë të nevojshme në shoqërinë demokratike, për interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit publik, apo të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.⁴

Në **nenin 25 të PNDCP-së** trajtohen posaçërisht zgjedhjet dhe kërkohet që palët nënshkruese t'i sigurojnë çdo qytetari të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje periodike të qenësishme.

Për të plotësuar PNDCP-në, Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB-së nxjerr interpretime autoritare të dispozitave të Paktit nëpërmjet **Komenteve të Përgjithshme**.⁵ Komentet e Përgjithshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e zgjedhjeve të qenësishme dhe demokratike, janë:

Komenti i Përgjithshëm nr. 25, i vitit 1996, për pjesëmarrjen në drejtimin e punëve publike dhe për të drejtën e votës. Në dokument përcaktohet se individët duhet të jenë të lirë të mbështesin apo të kundërshtojnë qeverinë, pa ndërhyrje apo shtrëngim të papërshtatshëm, që mund të shtrembërojë apo të pengojë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesit. Më tej, aty thuhet se votuesit duhet të kenë mundësinë të formojnë mendime në mënyrë të pavarur, pa dhunë apo kërcënim për dhunë dhe pa asnjë lloj ndërhyrjeje manipuluese. Gjithashtu, pohohet se qytetarët marrin pjesë në drejtimin e punëve publike duke ushtruar ndikim nëpërmjet debatit dhe dialogut publik me përfaqësuesit e tyre ose nëpërmjet aftësisë për t'u organizuar. Në këtë koment parashikohet se liritë e të shprehurit, grumbullimit dhe

⁴ Kjo njihet si "cilësimi trepjesësh" i ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. PNDCP-ja parashikon që çdo kufizim i lirive themelore (1) duhet të jetë përcaktuar qartësisht me ligj, me mundësi ankimi; (2) duhet të jetë qartësisht i justifikueshëm për rrethana përjashtimore, të tilla si: për interes të sigurisë kombëtare, rendit publik, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit publik, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe parandalimit të një krimi; dhe (3) duhet të jetë proporcional me interesin që synon të mbrojë. Në lidhje me derogimet nga detyrimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shih edhe raportin e ODIHR-it për Angazhimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë së COVID-19.

⁵ Deri më sot, Këshilli për të Drejtat e Njeriut nuk ka nxjerrë asnjë Koment të Përgjithshëm në lidhje me fushën e lirisë së organizimit.

organizimit përbëjnë kushte të domosdoshme për të pasur ushtrim të efektshëm të së drejtës së votës dhe duhen mbrojtur plotësisht, qoftë edhe me masa pozitive. Aty theksohet roli i tejçimit të lirë të informacioneve dhe ideve rreth çështjeve publike dhe politike ndërmjet qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe i lirisë për t'u organizuar, përfshirë dhe të drejtën për të krijuar dhe për t'u bashkuar me organizata ose shoqata të interesuara për çështjet politike dhe publike.

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 28, të vitit 2000, për barazinë e të drejtave midis burrave dhe grave parashikohet se palët nënshkruese duhet t'u sigurojnë grave të drejtat e parashikuara në nenin 25 (të PNDCP-së) në mënyrë të barabartë me burrat dhe të ndërmarrin masa të efektshme dhe pozitive për të përkrahur dhe për të garantuar pjesëmarrjen e grave në drejtimin e punëve publike dhe në poste publike. Më tej, aty vërehet se “e drejta për të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike nuk zbatohet plotësisht në mënyrë të barabartë kudo” dhe “kërkohet nga shtetet palë të japin informacione statistikore në lidhje me përqindjen e grave të zgjedhura në poste publike, përfshirë ato në pushtetin legjislativ”. Gjithashtu, aty kërkohet që palët nënshkruese “të trajtojnë mënyrat se si rastet e diskriminimit me baza të tjera ndikojnë posaçërisht tek gratë dhe të ofrojnë informacione rreth masave të marra për të kundërvepruar ndaj ndikimeve të tilla”.

Komenti i Përgjithshëm nr. 34, i vitit 2011, për lirinë e shprehjes radhit ato kufizime të diskutimit politik, që përbëjnë bazë për shqetësim sipas Këshillit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së, përfshirë “ndalimin e fushatës derë më derë, kufizime për numrin dhe llojin e materialeve të shkruara, që mund të shpërndahen gjatë fushatave zgjedhore, bllokimin e qasjes në burime të ndryshme informacioni, gjatë periudhave zgjedhore, përfshirë dhe mediat vendase e ndërkombëtare dhe komentet politike, dhe kufizimin e qasjes së partive dhe politikanëve të opozitës në organet mediatike”. Më tej, parashikohet se liria e shprehjes mund të kufizohet vetëm nëse normohet me ligj dhe nëse kufizimet në fjalë pajtohen me cilësimin trepjesësh të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Në **Komentin e Përgjithshëm nr. 35, të vitit 2014,** shtjellohen detyrimet për të mbrojtur lirinë dhe sigurinë vetjake, edhe nga arrestimet dhe ndalimet arbitrare. Për pasojë, “ligji vendas mund të autorizojë arrestimin apo ndalimin, megjithatë kjo nuk mund të bëhet në mënyrë arbitrare”, dhe arrestime apo ndalime të tilla, si ndëshkim për ushtrimin e ligjshëm të të drejtave themelore që garantohen nga PNDCP-ja, janë arbitrare. Për më tepër, aty thuhet se “e drejta e sigurisë vetjake i detyron gjithashtu, shtetet palë të marrin masa të përshtatshme për të reaguuar ndaj kërcënimeve me vdekje kundrejt personave që bëjnë pjesë në sferën publike dhe, nga pikëpamja më e përgjithshme, të mbrojnë individët nga kërcënimet e

parashikueshme ndaj jetës apo mirëqenies trupore, që bëhen nga aktorë në qeverisje apo në sferën private”.

Në **Komentin e Përgjithshëm nr. 37, të vitit 2020**, për të drejtën e tubimit paqësor përcaktohet se, së bashku me liritë e tjera përkatëse, kjo “përbën vetë themelin e sistemit të qeverisjes me pjesëmarrje që bazohet tek demokracia, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe tek pluralizmi”, dhe se “mund të shqyrtohet ndalimi i një grumbullimi të posaçëm vetëm kur kjo përbën masën e fundit në dispozicion”. Në dokument shtjellohet mbrojtja e të drejtës, siç garantohet nga PNDCP-ja, dhe vihet në dukje se grumbullimet paqësore, përfshirë dhe ato të lindura në mënyrë spontane, “kudo që zhvillohen: në mjedise të jashtme, të brendshme dhe në internet; në mjediset publike dhe private; apo një kombinim i tyre”, duhet të mbrohen. Në të, më tej, thuhet se “këto grumbullime mund të kenë forma të ndryshme, përfshirë demonstratat, protestat, takimet, kortezhet, tubimet, manifestimet e protestës ndenjor, grumbullimet me nderje qirinsh dhe kryerje aktesh të bashkërenduara në mjedise publike”, dhe se ato mbrohen nga PNDCP-ja, “qofshin të palëvizshme, si grumbullimet në vend, apo të lëvizshme, si kortezhet dhe marshimet”. Aty thuhet se nëse tubimi është paqësor, fakti se nuk janë përmbushur disa kërkesa të caktuara të legjislacionit vendas në lidhje me grumbullimet, në vetvete, nuk i nxjerr pjesëmarrësit jashtë fushës së mbrojtjes së PNDCP-së. Palët nënshkruese kanë detyra pozitive për të lehtësuar grumbullimet paqësore dhe për të nxitur terrenin mundësues për ushtrimin e efektshëm të së drejtës së tubimit paqësor pa diskriminim. Në dokument njihet rëndësia e rolit të gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe vëzhguesve zgjedhorë në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e grumbullimeve, për hir të gëzimit të plotë të së drejtës së tubimit paqësor dhe, duke qenë kështu, në të përcaktohet se ata mbrohen nga PNDCP-ja.

b. Instrumente të tjera të OKB-së

Disa dokumente të specializuara të OKB-së për të drejtat e njeriut përmbajnë një varg garancish për grupe të posaçme, të cilat mund të kenë nevojë për vëmendje të shtuar gjatë proceseve zgjedhore. Prandaj, në këto dokumente theksohen disa dispozita të PNDCP-së, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KNEDR), e vitit 1965, i angazhon anëtarët për eliminimin e diskriminimit racial dhe garanton gëzimin e të drejtave politike dhe lirive themelore në mënyrë të barabartë. KNEDR-ja u kërkon palëve ta kualifikojnë

gjuhën e urrejtjes si vepër penale dhe pjesëmarrjen në organizata raciste ta sanksionojë në kodin penal. Më tej, konventa i angazhon palët të garantojnë të drejtën e gjithsecilit për të qenë i barabartë përpara ligjit, pavarësisht racës, ngjyrës, apo origjinës kombëtare ose etnike. Barazia duhet të gjejë zbatim tek trajtimi i barabartë nga gjykatat dhe tribunalet, tek siguria vetjake dhe tek mbrojtja nga dhuna, si dhe tek të drejtat civile dhe politike, të parashtruara nga PNDCP-ja.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGJFDG), e vitit 1979, është instrument ligjor ndërkombëtar, që u kërkon palëve nënshkruese të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në jetën politike e publike të vendit, dhe që i fton ato të miratojnë masa të veçanta të përkohshme për të përsheptuar barazinë *de facto*. KEGJFDG-ja u garanton grave barazi në jetën politike e publike, duke u përqendruar tek barazia në votim, pjesëmarrja në qeverisje dhe në “organizata dhe shoqata joqeveritare, që merren me jetën publike dhe politike të vendit”. Më tej, KEGJFDG-ja u kërkon shteteve palë të marrin masa për të synuar eliminimin e “paragjykimeve, zakoneve dhe të gjitha praktikave të tjera, që bazohen tek ideja e inferioritetit apo superioritetit të secilit prej seksve apo tek rolet dhe stereotipet gjinore të burrave dhe grave”.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (KKBKK), e vitit 2003, parashtron standardet e transparencës, me qëllim uljen e llojeve të ndryshme të korrupsionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, përfshirë fushën e shkëmbimit të ndikimeve politike dhe abuzimin me pushtetin. Kjo konventë përbën traktatin e vetëm ndërkombëtar shumëpalësh me detyrim ligjor kundër korrupsionit dhe vlen posaçërisht për zbatimin e masave për parandalimin e abuzimit me burimet shtetërore për qëllim fushate. KKBKK-ja mbulon pesë fusha kryesore: masat parandaluese, penalizimin dhe zbatimin e ligjit, bashkëpunimin ndërkombëtar, rikuperimin e pasurive, ndihmën teknike dhe shkëmbimin e informacioneve. Ajo përmban si dispozita detyruese, ashtu edhe jodetyruese.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), e vitit 2007, u kërkon palëve të “përkrahin, mbrojnë dhe sigurojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara dhe të sigurohen se ata gëzojnë barazi të plotë sipas ligjit”. KDPAK-ja u kërkon shteteve palë t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejta politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato në mënyrë të barabartë me të tjerët, përfshirë dhe mbrojtjen e të drejtës së tyre për të votuar pa u frikësuar. Në të përcaktohet se palët nënshkruese “marrin të gjitha masat e nevojshme për t’u siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit, përfshirë lirinë e kërkimit, marrjes dhe dhënies së informacionit dhe ideve në mënyrë të barabartë me të tjerët dhe

nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit që ata zgjedhin”, dhe të nxisin median, përfshirë dhe ofruesit e informacionit me anë të internetit, t’i bëjnë shërbimet e tyre të jenë të qasshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, e vitit 1992, thekson se individët që u përkasin këtyre llojeve të pakicave kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë të efektshme në jetën publike dhe në vendimet e nivelit kombëtar dhe rajonal në lidhje me pakicën, të cilës ata u përkasin ose me rajonet ku ata jetojnë, të krijojnë dhe të ruajnë shoqatat e tyre dhe të ushtrojnë në mënyrë të plotë dhe të efektshme të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, pa diskriminim dhe në barazi të plotë përpara ligjit.

2. Angazhimet e OSBE-së

OSBE-ja vepron nëpërmjet një “procesi në bazë të konsensusit”, që çon në krijimin e angazhimeve dhe parimeve politike të detyrueshme. Duke qenë se janë politike, ato ndonjëherë lënë vend për interpretim dhe mund të ofrojnë garanci më të gjera, që vlejnë për kontekstet e fushatave dhe mund të mundësojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Tjetër përparësi e tyre është se ato janë të vlefshme që nga momenti i arritjes së marrëveshjes nga shtetet pjesëmarrëse, pa iu nënshtuar proceseve të ratifikimit, përfshirë dhe rezervat. Sapo shtetet pjesëmarrëse arrijnë konsensus, vendimet e tyre hyjnë menjëherë në fuqi dhe janë të detyrueshme nga pikëpamja politike për të gjithë, pa përjashtim. Universaliteti i këtyre angazhimeve, të rëna dakord së bashku nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, si dhe cilësia e “vlerësimit të tyre nga ekspertë të fushës”, përbëjnë pikat e forta të dimensionit njerëzor të OSBE-së.

a. Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990

Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990, është dokument themelor i angazhimeve të OSBE-së. Në dokumentin e Kopenhagenit, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së pranuan faktin se demokracia pluraliste dhe sundimi i ligjit janë thelbësorë për sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. Si i tillë, ky instrument përbën pikë reference kryesore për veprimtaritë e ODIHR-it, që kanë të bëjnë me zgjedhjet, përfshirë vlerësimin e zhvillimit të zgjedhjeve, si dhe mjedisin më të gjerë politik dhe atë të fushatës, ku zhvillohen zgjedhjet. Në Dokumentin e Kopenhagenit, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së pohuan shprehimisht se “demokracia është element i qenësishëm i sundimit të ligjit”, njohën “rëndësinë e pluralizmit në

lidhje me organizatat politike” dhe shprehën “vendosmërinë e përbashkët për të ndërtuar shoqëri demokratike, që bazohen tek zgjedhjet e lira dhe tek sundimi i ligjit”.

Angazhimet që lidhen posaçërisht me zgjedhjet, përcaktohen tek paragrafët 5, 6, 7 dhe 8 të Dokumentit të Kopenhagenit. Paragrafi 6 parashikon se “vullneti i popullit, i shprehur lirisht dhe në mënyrë të drejtë, përmes zgjedhjeve periodike dhe të vërteta, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverie”. Në të njëjtin paragraf, shtetet pjesëmarrëse angazhohen të “respektojnë të drejtën e shtetasve të tyre që të marrin pjesë në qeverisjen e vendit, drejtpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre, përmes proceseve të ndershme zgjedhore” dhe të “pranojnë përgjegjësinë e tyre që të mbrojnë, në përputhje me ligjet e tyre, detyrimet e tyre ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe angazhimet e tyre ndërkombëtare, rendin demokratik”. Paragrafi 8 trajton praninë e vëzhguesve të huaj dhe vendas të zgjedhjeve dhe përfshin një ftesë të përhershme nga të gjitha dhe për të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Paragrafi 7 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, parashtrohet bazat për vlerësimin e nivelit të respektimit të angazhimeve dhe përmban deklarime politike të qarta për organizimin e zgjedhjeve demokratike në lidhje me:

- › Organizimin e zgjedhjeve të lira në intervale të arsyeshme (Paragrafi 7.1);
- › Lejimin e votimit të lirë të popullit për, të paktën, njërën prej dhomave të parlamentit (Paragrafi 7.2);
- › Respektimin e votimit universal dhe të barabartë dhe të drejtën e qytetarëve për të synuar një post, dhe krijimin e garancive për konkurrim zgjedhor të lirë dhe të ndershëm (Paragrafi 7.3);
- › Sigurimin e votimit të fshehtë dhe numërimit të ndershëm dhe me rezultate të gjindshme publikisht (paragrafi 7.4);
- › Respektimin e të drejtës së qytetarëve për të synuar poste politike ose publike pa u diskriminuar, qoftë si individë, apo si anëtarë të partive politike (Paragrafi 7.5);
- › Respektimin e të drejtës së individëve dhe grupeve për t’u organizuar në parti politike dhe ofrimin e garancive... “që të kenë mundësi të konkurrojnë me njëra-tjetrën, mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe nga autoritetet” (Paragrafi 7.6);

- Garantimin që “ligji dhe politika shtetërore të kontribuojnë që fushatat politike të lejohet të zhvillohen në një klimë të paanshme dhe të lirë, në të cilën as veprimet administrative dhe as dhuna apo kanosja të mos i pengojnë partitë dhe kandidatët të shprehin lirisht pikëpamjet dhe cilësitë e tyre, ose t’i pengojnë zgjedhësit që të informohen për to dhe t’i diskutojnë ato, apo ta hedhin votën e tyre pa frikën se mos ndëshkohen” (Paragrafi 7.7);
- Ofrimin e qasjes pa pengesa në media për të gjithë garuesit zgjedhorë pa diskriminim (Paragrafi 7.8); dhe
- Sigurimin që garuesit fitues të marrin sipas rregullit funksionet e tyre dhe të lejohen të mbeten në atë detyrë derisa mandati i tyre të mbarojë ose, përndryshe, të ndërpritet, në një mënyrë që rregullohet me ligj, në përputhje me procedurat demokratike parlamentare dhe kushtetuese (Paragrafi 7.9).

Përveç dispozitave të mësipërme, të posaçme për zgjedhjet, zhvillimi i zgjedhjeve demokratike dhe i fushatave zgjedhore në përgjithësi varet nga faktorë politikë më të gjerë. Dokumenti i Kopenhagenit radhit disa angazhime që kanë të bëjnë me mjedisin e gjerë politik, përfshirë ato që lidhen me liritë themelore dhe me sundimin e ligjit. Disa prej tyre përmbajnë angazhimet e mëposhtme për:

- Organizimin e “zgjedhjeve të lira [...] në intervale të arsyeshme, me votim të fshehtë apo sipas një procedure të barasvlershme votimi të lirë, në kushte që, në praktikë, garantojnë shprehjen e lirë të mendimit të zgjedhësve për zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre” (Paragrafi 5.1);
- Sigurimin e “ndarjes së qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike; veçanërisht, partitë politike nuk shkrihen me shtetin” (Paragrafi 5.4);
- Garantimin që “kushdo ka në dispozicion mjete efektive për korrigjim” (Paragrafi 5.10);
- Respektimin e lirive themelore që janë shtylla të zhvillimit të zgjedhjeve demokratike, si: liria e shprehjes dhe komunikimit (paragrafi 9.1), tubimit paqësor (paragrafi 9.2) dhe organizimit (paragrafi 9.3); dhe
- Sigurimin se çdo kufizim i lirive themelore përputhet me detyrimet që rrjedhin nga PNDKP-ja dhe me angazhimet ndërkombëtare, veçanërisht

me DUDNJ-në, dhe që me to të mos abuzohet dhe të mos zbatohen në mënyrë arbitrare, por në një mënyrë që lejon sigurimin e ushtrimit të efektshëm të këtyre të drejtave (paragrafi 24).

b. Standardet dhe parimet zgjedhore në dokumente të tjera të OSBE-së

Disa dokumente të tjera themelore të OSBE-së nënvizojnë parimet dhe standardet kryesore të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve dhe të fushatave zgjedhore demokratike. Disa prej tyre paraqiten më poshtë, të grupuara sipas temës:

Zgjedhjet e qenësishme dhe periodike: Në Dokumentin Plotësues të Kartës së Parisit për një Evropë të Re, të vitit 1990, shtetet pjesëmarrëse pohuan “të drejtën universale për të marrë pjesë në zgjedhje të lira dhe të ndershme”. Në Dokumentin e Stambollit, të vitit 1999, ata u zotuan të “garantojnë konkurrencë të drejtë ndërmjet kandidatëve, si dhe partive, edhe nëpërmjet qasjes së tyre në media dhe respektimit të së drejtës së grumbullimit”. Në Deklaratën Përkujtimore të Astanës, të vitit 2010, ata njohën “rolin e rëndësishëm që luajnë shoqëria civile dhe media e lirë, për të ndihmuar [...] garantimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, lirive themelore, demokracisë, përfshirë zgjedhjet e lira dhe të ndershme, dhe sundimin e ligjit”.

Liritë e organizimit dhe të grumbullimit: Në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, të vitit 1990, shtetet pjesëmarrëse pohuan se çdo individ ka të drejtën e lirisë së organizimit dhe tubimit paqësor. Në vitin 2008, në Helsinki, ata nxorën një Deklaratë Ministrore me Rastin e Përvjetorit të 60-të të DUDNJ-së, dhe theksuan se “gjithsecili ka të drejtën e lirisë së të menduarit, ndërjegjes, fesë apo besimit; lirinë e mendimit dhe të shprehjes, lirinë e tubimit paqësor dhe të organizimit”.

Liria e shprehjes dhe e mendimit: Në Dokumentin e Budapestit, të vitit 1994, shtetet pjesëmarrëse nënvizuan se “liria e shprehjes është e drejtë themelore e njeriut dhe përbërës bazë i një shoqërie demokratike”. Në dokumentin e Stambollit, të vitit 1999, ata ripohuan rëndësinë e rrjedhës së lirë të informacionit dhe qasjes së publikut ndaj informacionit, si dhe u angazhuan për të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mundësuar kushtet bazë për rrjedhën e informacionit.

Liria e lëvizjes: Në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, shtetet pjesëmarrëse u angazhuan të heqin “të gjitha kufizimet ligjore e të llojeve të tjera në lidhje me udhëtimin brenda territoreve të tyre të nënshtetasve dhe të huajve, si dhe në lidhje me vendbanimin për të gjithë ata që u takon

vendbanimi i përhershëm, me përjashtim të atyre kufizimeve që mund të jenë të nevojshme për interesat legjitime të qeverisjes, sipas ligjeve të tyre vendase, në përputhje me angazhimet e KSBE-së dhe detyrimet ndërkom-bëtare në lidhje me të drejtat e njeriut”, duke marrë përsipër që këto kufizime t’i mbajnë në nivelin minimal.

Pjesëmarrja e grave: Në Dokumentin e Madridit, të vitit 1983, shtetet pjesëmarrëse u angazhuan të garantojnë të drejta të barabarta për burrat dhe gratë dhe ranë dakord të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të nxitur pjesëmarrje po aq të efektshme në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në Dokumentin e Vjenës, të vitit 1989, ata pohuan vendosmërinë për të mundësuar të drejta të barabarta dhe u zotuan të marrin çdo masë, përfshirë masa legislative, për të nxitur pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në jetën politike. Në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, ata njohën se “barazia e plotë dhe e vërtetë ndërmjet burrave dhe grave është aspekt thelbësor i një shoqërie të drejtë dhe demokratike, që bazohet tek sundimi i ligjit”.

Duke theksuar universalitetin e vlerave që mbështesin, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u kanë bërë thirrje shteteve të tjera, përmes dokumenteve në kohë të ndryshme, përfshirë **Dokumentin e Vjenës, të vitit 1989**, dhe **Dokumentin e Moskës, të viti 1991**, të miratojnë **KEGJFDG-në** ose të heqin të gjitha rezervat nëse janë anëtarë. Në vitin 2004, shtetet pjesëmarrëse përsëritën thirrjen dhe mbështetën **Planin e Veprimit të OSBE-së për Përkrahjen e Barazisë Gjinore**, përmes të cilit ata u angazhuan të sigurojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike, të marrin masat e nevojshme për të nxitur ndërgjegjësimin gjinor dhe barazinë e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave në shoqëri, duke u zotuar të integrojnë pikëpamjen gjinore në të gjitha fushat dhe nivelet. Në **Dokumentin e Lubjanës, të vitit 2005**, ata u angazhuan për të mundësuar zbatimin proaktiv të Planit të Veprimit. Më tej, në **Dokumentin e Athinës, të vitit 2009**, ata ranë dakord të “shqyrtojnë parashikimin e masave të posaçme për të arritur qëllimin e ekuilibrit gjinor në të gjitha organet legislative, gjyqësore dhe ekzekutive” si dhe “masa të tjera të mundshme legislative për të lehtësuar një pjesëmarrje më të ekuilibruar të grave dhe burrave në jetën politike dhe publike [dhe] për të nxitur të gjithë aktorët politikë të nxisin pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në partitë politike, me qëllim arritjen e një përfaqësimi gjinor të ekuilibruar më mirë, në poste publike të të gjitha niveleve, për të cilat zhvillohen zgjedhje”.

Pjesëmarrja e pakicave kombëtare: Në Raportin e Gjenevës, të vitit 1991, për Takimin e Ekspertëve të KSBE-së për Pakicat Kombëtare, shtetet pjesëmarrëse u angazhuan të krijojnë “kushtet që personat që u përkasin pakicave të kenë mundësi të barabarta për t’u përfshirë në mënyrë të efektshme në jetën publike”. Në Dokumentin e Helsinkit, të vitit 1992, ata u zotuan të shpreshtojnë “përpjekjet për t’u mundësuar personave që u përkasin pakicave kombëtare, si individë apo në komunitet me të tjerët, ushtrimin e lirë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, përfshirë

të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë të plotë, në përputhje me procedurat vendimmarrëse të secilit shtet, në jetën politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vendeve të tyre, edhe nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike në organet vendimmarrëse dhe këshillimore të nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor, ndër të tjera, nëpërmjet partive politike dhe shoqatave”. Dhe në Dokumentin e Mاستrihtit, të vitit 2003, ata ripohuan “rëndësinë e rekomandimeve të Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare për [...] pjesëmarrjen publike”. Gjithashtu, dokumenti rekomandon që shtetet pjesëmarrëse të organizojnë fushata ndërgjegjësimi për të rritur pjesëmarrjen e votuesve romë, të garantojnë që votuesit romë të mund të bëjnë zgjedhje të lira dhe të bazuara në informuar në gjatë proceseve zgjedhore dhe të “marrin masa për të garantuar të drejtën e barabartë të votës për gratë, përfshirë zbatimin e ndalimeve ndaj të ashtuquajturit votim familjar.

Personat me aftësi të kufizuara: Në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, të vitit 1990, shtetet pjesëmarrëse theksuan se “demokracia është rojtari më i mirë i lirisë së shprehjes, tolerancës së të gjithë grupeve të shoqërisë dhe i barazisë së mundësive për gjithsecilin”. Në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan shprehimisht të “garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara” dhe po aq e rëndësishme, të “ndërmarrin hapa për të garantuar mundësitë e barabarta që këta persona të marrin pjesë në mënyrë të plotë në jetën e shoqërisë së tyre”. Ata u angazhuan gjithashtu të “përkrahin pjesëmarrjen e përshtatshme të personave në fjalë në vendimmarrjen për fushat me interes për ta”, çka përfshin ligjet, rregulloret dhe politikat në lidhje me zgjedhjet. Ata “nxisin [nxitën] kushtet e favorshme për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesa dhe shërbime publike, strehim, transport, si dhe në veprimtari kulturore dhe rekreative”, përfshirë qasjen në qendrat e votimit, mjediset e fushatave dhe në mjediset e tjera gjatë zgjedhjeve.

Kundërvënia ndaj nxitjes së dhunës, diskriminimit, armiqësisë dhe urrejtjes: Në Raportin e Gjenevës, të vitit 1991, për Takimin e Ekspertëve të KSBE-së për Pakicat Kombëtare, shtetet pjesëmarrëse shprehën shqetësimin e tyre për “përhapjen e akteve të urrejtjes racore, etnike dhe fetare, antisemitizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit, nënvizojnë [nënvizuan] vendosmërinë e tyre për të dënuar, në vazhdimësi, akte të tilla ndaj kujtdo”. Ata gjithashtu u zotuan të marrin “masa të efektshme, përfshirë këtu miratimin, në përputhje me ligjin kushtetues të tyre dhe me detyrimet ndërkombëtare, nëse nuk e kanë bërë tashmë një gjë të tillë, e ligjeve që ndalojnë aktet të cilat përbëjnë nxitje të dhunës në bazë të diskriminimit për shkaqe, të tilla si: kombësia, raca, etnia apo feja, armiqësisë

apo urrejtjes, përfshirë antisemitizmin, dhe të politikave për zbatimin e këtyre ligjeve”.

Ndërsa dokumentet e OSBE-së nuk përmendin shprehimisht **pjesëmarrjen e të rinjve** në zgjedhje, shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar në disa dokumente të nxisin rolin dhe përfshirjen e të rinjve në programin e tyre të paqes dhe sigurisë, përfshirë **Aktin Përfundimtar të Helsinkit, të vitit 1975, Deklaratën e Këshillit Ministror të Bazelit, të vitit 2014, “Deklaratën për të Rinjtë dhe Sigurinë” të Këshillit Ministror të Beogradit, të vitit 2015, dhe “Deklaratën për Rolin e të Rinjve në Kontributin për Përpjekjet për Paqe dhe Siguri” të Këshillit Ministror të Milanos, të vitit 2018.** Organizata të tjera ndërkombëtare, posaçërisht OKB-ja dhe Këshilli i Evropës, kanë miratuar rezolutën (Rezoluta 2250 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së) dhe rekomandimin (KM/Rec 2016/7) për qasjen e të rinjve tek të drejtat dhe një thirrje për shtetet anëtare që të heqin pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e të rinjve në demokraci e zgjedhje.

3. Instrumentet rajonale në zonën e OSBE-së

Disa organizata rajonale dhe instrumente të tjera përgjatë zonës së OSBE-së, të cilat radhiten më poshtë, ofrojnë kuadro të mëtejshëm për të garantuar të drejtat e njeriut dhe fushatat e zgjedhjet demokratike.

Këshilli i Evropës ka 47 anëtarë dhe të gjithë janë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e vitit 1950,** nënshkruar dhe ratifikuar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës, radhit disa liri themelore që kanë të bëjnë me zgjedhjet. KEDNJ-ja mbron lirinë e shprehjes, posaçërisht “lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike”. Ajo garanton të drejtën e tubimit paqësor dhe të organizimit, si dhe të drejtën e lirisë dhe sigurisë vetjake. Gjithashtu, KEDNJ-ja përcakton se çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar.

Në nivelin mbikombëtar, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrton aplikime në lidhje me shkelje të pretenduara të dispozitave që lidhen me të drejtat e njeriut, të parashtruara në KEDNJ dhe në protokollet e saj. Disa prej vendimeve të Gjykatës trajtojnë çështje që lidhen me zgjedhjet, përfshirë të drejtën e votimit dhe liritë e organizimit, të grumbullimit dhe të shprehjes.

Protokolli nr. 1 i KEDNJ-së, i vitit 1952, përmban garanci të ngjashme me ato që gjenden në instrumente ndërkombëtare dhe u kërkon shteteve të “organizojnë

zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme dhe me votim të fshehtë, në kushte që garantojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve për zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre”. Edhe pse, fillimisht, dispozita u hartua në formën e një grupi detyrimesh, jo si e drejtë e njeriut, më pas, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ndryshoi këtë interpretim dhe që prej vitit 1987 e sheh të drejtën e votës dhe të konkurrimit në zgjedhje si të drejtë të mirëfilltë të njeriut.

Bashkimi Evropian (BE) ka 27 anëtarë dhe të gjithë janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. BE-ja ka miratuar gjithashtu, traktate me dispozita që kanë të bëjnë me demokracinë përfaqësuese dhe me sundimin e ligjit. **Traktati i Bashkimit Evropian** përmend “vlerat universale të të drejtave të pashkelshme dhe të patjetërsueshme të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë dhe sundimit të ligjit” dhe pohon për shtetet anëtare “lidhjen me parimet e lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe sundimit të ligjit”. **Traktati i Lisbonës**, i cili hyri në fuqi në vitin 2009, lejon vendosjen e sanksioneve ndaj anëtarëve të BE-së, që janë në shkelje të vazhdueshme të vlerave themelore të tij. **Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e vitit 2000**, parashikon liritë e shprehjes, informacionit, tubimit paqësor dhe të organizimit. Dokumenti radhit të drejtat e qytetarëve, përfshirë të drejtën për të votuar dhe për të garuar si kandidat në Parlamentin Evropian dhe në zgjedhjet vendore. Dispozitat e të dy dokumenteve janë detyruese për të gjithë anëtarët.

Komënuelthi i Shteteve të Pavarura (KSHP), i cili ka nëntë anëtarë dhe të gjithë janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, përcakton detyrime ligjore në fushën e zgjedhjeve demokratike me anë të **Konventës për Standardet e Zgjedhjeve Demokratike, të Drejtat dhe Liritë Zgjedhore, të vitit 2002**. Në vitin 1995, KSHP-ja miratoi **Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore**. Të dyja Konventat vërejnë nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë ato që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me llogaridhënien nga individët që i shkelin këto të drejta. Nene të shumta të të dy dokumenteve u referohen lirive themelore dhe kushteve të tjera të nevojshme për fushatën dhe mjedisin demokratik të lirë dhe të ndershëm për zhvillimin e zgjedhjeve të qenësishme, në përputhje me legjislacionin vendas dhe angazhimet ndërkombëtare.

Organizata e Shteteve Amerikane (OSHA) ka 35 anëtarë, dy prej të cilëve janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. **Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1969**, e cila është e detyrueshme nga pikëpamja ligjore, parashtron të drejtat dhe liritë themelore, të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve demokratike, mbrojtjen e lirisë dhe mendimit dhe të shprehjes, përfshirë të drejtën e kërkimit, marrjes dhe dhënies së informacionit dhe ideve, të drejtën e grumbullimit dhe lirisë e organizimit dhe lëvizjes. **Karta Demokratike Ndëramerikane, e vitit 2001**, e cila i jep mandat OSHA-së të ofrojë vëzhgim zgjedhjesh dhe ndihmë teknike për anëtarët e saj, e njeh rëndësinë e “respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, qasjen në

pushtet dhe ushtrimin e tij në përputhje me sundimin e ligjit, organizimin e zgjedhjeve periodike, të lira dhe të ndershme në bazë të votimit të fshehtë dhe të drejtës universale të votës [...], sistemin pluralist të partive politike dhe organizatave, si dhe ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e degëve të qeverisjes”.

4. Praktika e mirë

Së bashku me traktatet apo angazhimet e detyrueshme ligjore ose politike, organizatat ndërkombëtare kanë miratuar edhe dokumente plotësuese të tjera në lidhje me zgjedhjet, të cilat shpesh njihen me emrin “praktikë e mirë” ndërkombëtare. Disa prej këtyre teksteve kanë përmasë globale, ndërsa disa të tjera rajonale. Këto dokumente mund të tregojnë nivel të lartë mbështetjeje nga ana e anëtarëve të organizatës përkatëse, për disa rregulla të posaçme dhe mund të përdoren gjerësisht në veprimtari që lidhen me zgjedhjet, si bazë për dhënien e udhëzimeve për shtetet pjesëmarrëse.

Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit i Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias) është organ këshillimor për çështjet kushtetuese dhe ligjore, dhe 51 prej 62 anëtarëve të tij janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. **Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore, i vitit 2002, dhe Kodi i Praktikës së Mirë për Referendumet, i vitit 2006,** nga Komisioni i Venecias, ofrojnë udhëzime praktike, edhe në lidhje me kushtet e përgjithshme të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve/referendumeve demokratike dhe për zhvillimin e fushatave zgjedhore/për referendumet (si dhe aspektet teknike të këtyre proceseve). Dokumenti i parë ofron përkufizime të parimeve të “Trashëgimisë Zgjedhore të Evropës”, përcakton kushtet për zbatimin e tyre dhe përmban Shënime Shpjeguese që sqarojnë disa prej interpretimeve. Në të vihet në dukje se “nuk mund të ketë zgjedhje demokratike pa respektim të të drejtave të njeriut, veçanërisht të lirisë së shprehjes dhe të shtypit, të lirisë së lëvizjes brenda vendit, lirisë së grumbullimit dhe lirisë së organizimit për qëllime politike, përfshirë krijimin e partive politike”.

Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore tregon sa e rëndësishme është që zgjedhjet të jenë periodike, tregon rëndësinë e mundësive të barabarta që “detyrojnë një qëndrim neutral nga ana e autoriteteve shtetërore, veçanërisht për [...] fushatën zgjedhore” dhe shtjellon më tej, dallimet ndërmjet koncepteve të barazisë “së rreptë” dhe asaj “proporcionale”. Kodi ofron interpretime të parimeve të barazisë së pakicave kombëtare dhe të barazisë së sekseve. Në të parashikohet se votuesit duhet të jenë të lirë të kenë mendimet e tyre dhe se autoritetet shtetërore dhe publike duhet të respektojnë detyrën e tyre për të qenë neutrale – veçanërisht në lidhje me përdorimin e

mjeteve të komunikimit masiv, afishimin, të drejtën për të bërë demonstrata në rrugët publike, si dhe financimin e partive dhe të kandidatëve – në mënyrë që t'u garantohen të gjithë garuesve mundësi të barabarta. Në këtë Kod parashikohet se liria e votuesve për të pasur mendimet e tyre mund të ndikohet negativisht, për shembull, kur dikush përpiqet të blejë votën e një individi: blerja e votës (dhe shitja e votës) është praktikë, të cilën shtetet kanë detyrim ta parandalojnë dhe ta ndëshkojnë.

Përveç kodeve, në dokumentet e tjera të rëndësishme të Këshillit të Evropës përfshihen rekomandimet e Komitetit të Ministrave dhe tekstet e tjera në lidhje me zgjedhjet, të botuara nga Komisioni i Venecias, shpesh, në bashkëpunim me organizata të tjera, përfshirë dhe ODIHR-in. Në lidhje me fushatat zgjedhore, **Udhëzuesi i Përbashkët i ODIHR-it dhe i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Keqpërdorimit të Burimeve Administrative gjatë Proceseve Zgjedhore, i vitit 2016**, përfaqëson dokumentin e parë që i kushtohet kësaj teme në rajonin e OSBE-së. Udhëzuesi zgjeron botimet e mëparshme të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës për këto çështje dhe përkufizon keqpërdorimin e burimeve administrative si “përparësi e padrejtë që përfitohet nga parti apo kandidatë të caktuar, nëpërmjet përdorimit të pozitës zyrtare apo lidhjeve me institucionet qeveritare, me qëllim ndikimin e rezultatit të zgjedhjeve”. Dokumenti përqendrohet tek disa kategori të ndryshme të keqpërdorimit të burimeve shtetërore, përfshirë ato institucionale, financiare, apo të organeve ligjzbatuese dhe nxit një përjasje gjithëpërfshirëse që përmban vlerësimin e vullnetit politik, kuadrin ligjor dhe mekanizmat e mbikëqyrjes, si dhe procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Raportet e agjencive të OKB-së dhe raportuesve specialë përfaqësojnë burime të tjera udhëzimesh zyrtare për zhvillimin e fushatave zgjedhore demokratike. Për shembull, **Raporti i Raportuesit Special për të Drejtat e Lirisë së Tubimit Paqësor dhe të Organizimit, i vitit 2013**, u kërkon shteteve të “sigurohen që grumbullimet paqësore të normohen kryesisht nga një regjim njoftimi në lidhje me organizimin e grumbullimeve paqësore, në vend të një regjimi autorizimi”. Kur përdoret, procedura e njoftimit duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe më e shpejtë që të jetë e mundur. **Raportet e rregullta të Raportuesit Special të OKB-së për Përkrahjen dhe Mbrojtjen e të Drejtës së Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes** përmbajnë rekomandime dhe sugjerime rreth mënyrave dhe mjeteve për të nxitur dhe mbrojtur më mirë të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, në të gjitha shfaqjet e saj, përfshirë dhe në internet. **Parimet Udhëheqëse të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, të vitit 2011**, përcaktojnë një grup udhëzimesh për shtetet dhe kompanitë për të trajtuar abuzimet me të drejtat e njeriut, të shkaktuara nga veprimet e biznesit, edhe në lidhje me mediat dhe rrjetet sociale, të cilat, ndër të tjera, përqendrohen tek detyra e shtetit për të mbrojtur, tek përgjegjësia e korporatës për të respektuar dhe tek qasja në mjete juridike.

Deklarata e Kritereve për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme e Unionit Ndërparlamentar, e vitit 1994, një organizatë botërore kjo e përbërë prej 179 parlamenteve kombëtare, përcakton se autoriteti i qeverisjes mund të rrjedhë vetëm nga vullneti i njerëzve i shprehur në zgjedhje të qenësishme, të lira dhe të ndershme, që mbahen në intervale të rregullta dhe në bazë të votimit universal, të barabartë dhe të fshehtë. Ndër të tjera, në këtë deklaratë parashikohet e drejta e organizimit; të drejtat për të shprehur mendime politike pa u ndikuar; për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione dhe për të bërë zgjedhje të bazuar në informacion; për të lëvizur lirisht brenda vendit për të bërë fushatë zgjedhore; aftësia për të bërë fushatë në mënyrë të barabartë me partitë e tjera politike, përfshirë dhe partinë që përbën qeverinë ekzistuese; dhe e drejta e sigurisë.



KAPITULLI II

KONTEKSTI DHE SFONDI POLITIK

Që garuesit në zgjedhje të konkurrojnë dhe të bëjnë fushatë në mënyrë të drejtë dhe që votuesit të bëjnë zgjedhje të lirë dhe të bazuar në informacion, duhet të ekzistojnë kushtet e nevojshme për të pasur zgjedhje demokratike të qenësishme. Këto kushte përfshijnë qasjen e votuesve dhe respektimin nga ana e shtetit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë periudhës zgjedhore dhe jashtë saj. Ato zgjedhje që përmbushin disa prej standardeve ndërkombëtare, por që nuk janë pluraliste apo që zhvillohen në mjedis kufizues, ku nuk respektohen tërësisht të drejtat e njeriut apo liritë themelore, gjatë apo ndërmjet zgjedhjeve, nuk kanë gjasa të vlerësohen si qenësishëm demokratike. Përshkrimi dhe vlerësimi i elementeve që formësojnë

kontekstin dhe mjedisin politik, ku zhvillohen zgjedhjet, duhet të përfshihet në pjesën e Kontekstit Politik të raportit standard të ODIHR-it për zgjedhjet.⁶

Zakonisht, pjesa e Kontekstit Politik radhit të dhënat kryesore faktike në lidhje me zgjedhjet, duke iu përgjigjur pyetjeve: çfarë, ku, kush, kur dhe si, që kanë të bëjnë me procesin. Ajo ofron informacione bazë rreth sistemit politik të shtetit pjesëmarrës, siç parashikohet në kushtetutë dhe siç vlerësohet në praktikë. Duke nënvizuar faktin se zgjedhjet nuk zhvillohen në zbrazëti, kjo pjesë e krahason procesin me sfondin më të gjerë të zhvillimeve të fundit politike, ligjore, institucionale dhe shoqërore. Vlerësimet e përmbushjes së standardeve demokratike në zgjedhje duhen inkuadruar në kontekst më të gjerë, përfshirë synimin e ushtrimit të demokracisë dhe të funksionimit të institucioneve demokratike, sundimin e ligjit dhe lirinë e medias, si pjesë të ciklit zgjedhor. Konteksti Politik duhet të përfshijë informacione faktike dhe vlerësimin e kushteve për pluralizëm politik, respektimin e lirive themelore dhe mundësinë e qenësishme për pjesëmarrje civile dhe politike dhe që votuesit të bëjnë zgjedhje të bazuar në informacion, ndarjen e pushteteve dhe funksionimin e saktë të institucioneve demokratike, të tilla si: gjyqësori, dhe respektimin e sundimit të ligjit, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

Për të prezantuar tablonë politike, në të cilën zhvillohen zgjedhjet, është shumë e rëndësishme të theksohen disa prej faktorëve kontekstualë kryesorë, që mund të kenë ndikim tek procesi. Zakonisht, bëhet një vlerësim i respektimit të lirive themelore të posaçme dhe i zbatimit të tyre gjatë periudhës zgjedhore dhe përfshihet tek raporti standard i ODIHR-it për zgjedhjet në pjesët e Kuadrit Ligjor, Regjistrimit të Zgjedhësve, Regjistrimit të Partive dhe Kandidatëve ose të Medias. Sidoqoftë, vlerësimi i përgjithshëm i zgjedhjeve është punë e përbashkët e të gjithë misionit dhe Analisti Politik duhet të punojë ngushtë me anëtarët e tjerë të ekipit kryesor, veçanërisht me Analistin Ligjor, Zgjedhor dhe atë të Medias, gjatë vlerësimit të aspekteve kontekstuale përkatëse.

Ndërsa Analistët Politikë zhvillojnë analizën e tyre në bazë të shqyrtimit të dokumenteve dhe takimeve me aktorët e fushatës, ata duhet të familjarizohen gjithashtu, me vlerësimet e bëra nga aktorë të tjerë të respektuar, p.sh.: nga organizata të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare. Raportet e veçanta të OKB-së ose vlerësimet e tjera të bëra nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Komisioni i Venecias, si dhe botime të tjera të OSBE-së dhe ODIHR-it, që trajtojnë respektimin e lirive themelore të posaçme, mund të jenë burime të mira informacioni rreth situatës së përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe rreth çështjeve të posaçme në lidhje me kontekstin politik. Për shembull, Rishikimi Periodik Universal (RPU) është mekanizëm i mëvetshëm i Këshillit për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), që ka për qëllim përmirësimin

6 Përgjatë tekstit, fraza “kontekst politik” përdoret në mënyrë të ndërsjellë me termin “sfond” (politik). Përveç rastit nëse thuhet e kundërta, këto dy terma duhet të shihen si sinonime.

e situatës së të drejtave të njeriut në secilin prej 193 Shteteve Anëtare të OKB-së. Në kuadër të këtij mekanizmi, çdo pesë vite, botohen raporte që shqyrtojnë të drejtat e njeriut. Një burim tjetër informacioni mund të jenë deklaratat dhe raportet e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, veçanërisht kur trajtojnë çështje që lidhen me lirinë e shprehjes. Gjithashtu, opinionet ligjore të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, që shpesh hartohen bashkërisht nga të dy institucionet, dhe raportet e Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GSHKEKK) mund të shërbejnë si burime të besueshme informacionesh për kontekstin politik.

1. Vlerësimi i lirive themelore

Liritë themelore mbrohen më mirë në kushtet e mungesës së të gjendurit ngushtë, shtrëngimit ose kufizimit të zgjedhjeve apo veprimeve politike dhe civile. Ato mbrohen nga të drejta, të cilat janë universale dhe të patjetërsueshme, por edhe të pandashme, të ndërlidhura dhe të ndërvarura. Privimi i njërës prej të drejtave mund të ndikojë negativisht qasjen tek të drejtat e tjera. Këto të drejta, të cilat përcaktohen nga instrumentet ndërkombëtare që trajtohen në kapitullin e parë, duhet të garantohen dhe mbrohen me ligj. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e morën përsipër këtë detyrim me nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve dhe angazhimeve.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lejon disa kufij të të drejtave që garantojnë qasje tek liritë themelore. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se lejohen kufizimet. Mund të vendosen vetëm ato kufij që pajtohen me “cilësimin trepjesësh” të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Kufizimet duhet të interpretohen dhe zbatohen në kuptim sa më të ngushtë dhe me kujdes, për t’u siguruar se nuk çojnë në shkelje të standardeve ndërkombëtare duke ndikuar negativisht tek pjesëmarrja qoftë dhe e një individi apo segmenti të shoqërisë në jetën publike.⁷

Evidentimi i instrumenteve ndërkombëtare ku bën pjesë shteti pjesëmarrës (dhe i ndonjë rezerve të mundshme) shërben zakonisht, si pikënisje e punës së Analistit Politik ,gjatë misionit të vëzhgimit. Për të kryer këtë detyrë, Analisti Politik duhet të punojë së bashku me Analistin Ligjor dhe të analizojë nëse shteti i ka mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, të drejtat kryesore që u garantojnë qytetarëve liritë themelore. Në vend që t’i hedhë vetëm një sy ligjit zgjedhor, i cili normalisht normon vetëm aspektet në lidhje me periudhën zgjedhore, analisti duhet të shqyrtojë kushtetutën, ligjin

7 Për shembull, në gjykimin e çështjes “Sidiropoulos & të tjerë kundër Greqisë” (10 korrik 1998), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut deklaroi se: “përjashtimet ndaj lirisë së organizimit duhen interpretuar në kuptim sa më të ngushtë, në mënyrë që radhitja e tyre të jetë rreptësisht shteruese dhe përcaktimi i tyre të jetë kufizues në bazë të nevojës”.

mbi partitë politike dhe/ose ligjet që normojnë themelimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe çdo ligj të posaçëm që normon liritë themelore (p.sh.: rregullat në lidhje me grumbullimin paqësor). Analistët Politikë dhe Ligjorë duhet të përcaktojnë gjithashtu, nëse ka ndonjë çështje të kohëve të fundit në lidhje me liritë themelore, që është dërguar përpara KDNJ-së së OKB-së apo Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, lidhur me shtetin pjesëmarrës apo me zgjedhjet që vëzhgohen. Ata duhet të verifikojnë gjithashtu, nëse ka gjykime apo vendime të nxjerra nga organet përkatëse mbikombëtare, apo aktualisht në procedurë ekzekutimi, si dhe statusin e këtyre gjykimeve, vendimeve apo procedurave.

a. Liria e tubimit

Liria e tubimit është një element thelbësor përbërës i demokracisë.⁸ Ajo parashikon të drejtën për t'u grumbulluar në publik me qëllim organizimin e grumbullimeve, protestave dhe takimeve politike paqësore, si gjatë, ashtu edhe jashtë periudhës zgjedhore. Çdo normim i lirisë së tubimit duhet të kufizohet tek kërkesa për njoftim të autoriteteve përkatëse dhe procedura e njoftimit duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe e shpejtë, që të jetë e mundur. Siç parashikohet në Komentin e Përgjithshëm nr. 37, “detyrimi për të kërkuar leje nga autoritetet bie në kundërshtim me idenë që tubimi paqësor është e drejtë bazë” dhe “kjo kërkesë nuk duhet të keqpërdoret për të ndrydhur grumbullimet paqësore”.

Paragrafi 9.2 i **Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, thekson në mënyrë të posaçme se kushdo ka të drejtën e tubimit dhe demonstratës paqësore.

Rastet e përqasjes kufizuese ndaj grumbullimit publik, veçanërisht kur ndodhin në mënyrë sistematike, duhet të pasqyrohen në pjesën e Kontekstit Politik. Kufizimet e papërshtatshme të kësaj lirie mund të përfshijnë ndalimin e plotë të grumbullimeve, shpesh të atyre që organizohen nga kritikët e qeverisë apo të politikave të saj; vendosjen e barrave të papërshtatshme ndaj organizuesve të grumbullimit apo kufizime të orarit, vendit dhe llojit të grumbullimit; refuzimin e mbrojtjes së përshtatshme për pjesëmarrësit në grumbullime paqësore; kërkesën ndaj organizuesve për të mbuluar kosto të paarsyeshme për mbrojtjen policore apo vendosjen e tarifave të tjera administrative; dhe qëndrimin shtypës të papërshtatshëm ndaj grumbullimeve spontane. Çdo kufizim ekzistues duhet të jetë objekt i shqyrtimit të gjykatës brenda një kohe të përshtatshme.

8 Për më shumë, shih Udhëzuesin e ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Lirinë e Tubimit Paqësor.

b. Liria e organizimit

Si pjesë e domosdoshme e procesit demokratik, liria e organizimit garanton të drejtën e qytetarëve për t'u organizuar në parti politike dhe në grupe të shoqërisë civile. Ky koncept përfshin të drejtën për të krijuar dhe për t'u bashkuar në parti politike dhe shoqata dhe për të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre të ligjshme. Shtetet duhet të respektojnë detyrimet ndërkombëtare në fushën e lirisë së organizimit, të cilat përcaktohen në disa instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Të gjitha shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar në bazë të **Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, se do të "respektojnë të drejtën e individëve dhe grupeve që të krijojnë lirisht partitë e tyre politike apo organizata të tjera politike, dhe këtyre partive dhe organizatave politike do t'u japin garancitë ligjore të nevojshme që të kenë mundësi të konkurrojnë me njëra-tjetrën, mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe nga autoritetet". Më tej, në paragrafin 9.3, shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar gjithashtu të respektojnë të drejtën për të themeluar dhe për t'u bashkuar me sindikatat; dhe në paragrafët 10.3 dhe 10.4, ata u zotuan të garantojnë të drejtën për të themeluar dhe për të marrë pjesë në veprimtaritë e organizatave joqeveritare dhe të bashkëpunojnë dhe të kenë shkëmbime me organizata të tilla të tjera, si vendase edhe të huaja.

Ndërsa, normalisht, e drejta e organizimit trajtohet tek pjesa e raporteve të zgjedhjeve, që mbulojnë Regjistrimin e Partive dhe të Kandidatëve – veçanërisht, në lidhje me themelimin e partive politike – shpesh është e rëndësishme që kjo të pasqyrohet edhe në pjesën e Kontekstit Politik. Kjo nuk përmban vetëm referimin e zhvillimeve të kohëve të fundit në tablonë e konkurrimit dhe partive politike, por edhe sferën e veprimtarive të shoqërisë civile. Refuzimet e regjistrimit dhe rastet e vendosjes sistematike të pengesave për regjistrimin e partive të reja politike apo për funksionimin e lirë të tyre duhet të pasqyrohen qartësisht në pjesën e Kontekstit Politik. Në mënyrë të ngjashme, analistët duhet të pasqyrojnë çdo kufizim të papërshtatshëm për regjistrimin apo veprimtaritë e organizatave të shoqërisë civile. Kufizimet e papërshtatshme të lirisë së organizimit përfshijnë: kërkesa rënduese, si ato për pasjen e strukturave të posaçme partiake (p.sh.: prani me zyra në të gjitha rrethet); kërkesën për organizimin e detyrueshëm të veprimtarive të rregullta të partisë, si p.sh.: kongreset vjetore; kërkesën për paraqitje të një numri të madh nënshkrimesh mbështetëse apo mbajtjen e një niveli të caktuar të kuotave të anëtarësisë; apo kërkesa për të dhëna të hollësishme dhe ndërhyrëse të panevojshme në lidhje me themeluesit e partisë dhe/ose anëtarët.⁹ Nga ana tjetër, shtetet kanë një detyrim pozitiv

9 Shih Udhëzuesin e ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias për Normimin e Partive Politike, botimi 2 (2020).

për të ndaluar veprimtari të caktuara, çka mund të çojë në ndalimin e disa organizimeve.¹⁰

c. Liria e shprehjes dhe e mendimit

Liria e shprehjes është thelbi i demokracisë. Ajo garantohet nga e drejta për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion. Njësoj si me liritë e përmendura më parë, liria e shprehjes garantohet nga PNDCP-ja, e cila parashikon se gjithsecili gëzon të drejtën të marrë dhe të përhapë informacione dhe “ide të të gjitha llojeve [...] qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij”. Me qëllim nxitjen e shkëmbimit të lirë të ideve, që është e domosdoshme për lulëzimin e shoqërisë demokratike, e drejta e lirisë së shprehjes duhet të ruhet në çdo kohë.

Paragrafi 9.1 i **Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, thekson në mënyrë të posaçme se në të drejtën e lirisë së shprehjes “përfshihet liria e mendimit dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve, pavarësisht kufijve, pa ndërhyrjen e autoritetit publik”.

Edhe pse qasja tek liria e shprehjes trajtohet gjerësisht, në pjesën e raporteve të zgjedhjeve që mbulojnë Median, sulmet sistematike ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes apo çdo shkelje e posaçme e saj, që përbën një pjesë të rëndësishme të mjedisit ku zhvillohen zgjedhjet, duhen pasqyruar tek pjesa e Kontekstit Politik. Një prej kufijve të njohur gjerësisht, që zbatohet për lirinë e fjalës, përfshin ndalimin për nxitjen e dhunës dhe urrejtjes. Në këtë kontekst, PNDCP-ja parashikon se “çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare, që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi dhe dhunë, ndalohet me ligj”.

Duhet të vihet në dukje se nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar të ‘gjuhës së urrejtjes’. Jo çdo ligjëratë që përmban elemente përçmimi dhe i drejtohet individëve apo edhe grupeve, duhet të shihet si gjuhë e urrejtjes sipas kuptimit të formulimit të nenit 20 të PNDCP-së.¹¹ Siç është theksuar nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, “qeveritë nuk duhet të nxjerrin ligje që e kthejnë një acarim të thjeshtë të tensioneve

10 Neni 4 i KNEDR-së u kërkon shteteve të përdorin masa pozitive, të tilla si: ndalimi i organizatave që përkrahin dhe nxisin diskriminimin racor. Shih edhe gjykimin e Gjykatës Evropiane “Vona kundër Hungarisë” (9 korrik 2013), për të cilin Gjykata vendosi se një shoqatë mund të ndalohet nëse veprimtari të saj përbëjnë frikësim të përhapur racor; si dhe gjykimin “Refah Partisi (Partia e Mirëgenies) dhe të tjerë kundër Turqisë” (13 shkurt 2003), për të cilin Gjykata vendosi se mund të justifikohet kufizimi që shteti, në përputhje me detyrimet pozitive, në mbështetje të nenit 1 të KEDNJ-së, të vendosë detyrimin për partitë politike që të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja, si dhe detyrimin për të mos paraqitur programe politike, që kundërshtojnë parimet themelore të demokracisë

11 Paragrafi 2 i nenit 20 të PNDCP-së përcakton se “çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare, që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi dhe dhunë, ndalohet me ligj”.

shoqërore në vepër penale. Edhe pse justifikohet sanksionimi i ligjëratave që përbëjnë nxitje të urrejtjes, nuk justifikohet ndalimi i një gjuhe që është thjesht ofenduese. Pjesa më e madhe e vendeve kanë tashmë, legjislacion të gjerë ose, të paktën, të mjaftueshëm, kundër 'gjuhës së urrejtjes'. Në shumë vende, ka rregulla shumë të përgjithshme për këtë fushë, të cilat keqpërdoren nga të pushtetshmit për të kufizuar zërat jotradicionalë, kundërshtues, kritikë, ose të pakicave, apo diskutimet rreth çështjeve shoqërore të vështira. Gjithashtu, nuk mund të arrihet zgjidhja e tensioneve në bazë të dallimeve të qenësishme kulturore apo fetare, duke mbytur shprehjen e dallimeve, por duke i diskutuar ato në mënyrë të hapur, në fakt. Prandaj, fjala e lirë është kriter dhe jo pengesë e tolerancës".¹² Me shfaqjen e rrjeteve sociale, këto fenomene negative janë bërë më të dukshme dhe më të përhapura, veçanërisht gjatë periudhave të fushatave zgjedhore. Udhëzuesi i ODIHR-it për Vëzhgimin e Fushatave Zgjedhore në Rrjetet Sociale, botuar njëkohësisht me këtë material, trajton më në hollësi, çështjen e llojeve të ndryshme të ligjëratës.

E drejta e lirisë së mendimit është një element i posaçëm i lirisë së shprehjes. Orvatjet sistematike për të ndrydhur debatin publik, për të kufizuar në mënyrë të papërshtatshme rrjedhën e informacionit të nevojshëm për formimin e mendimit apo për të manipuluar opinionin publik, jashtë periudhës zgjedhore, duhen mbajtur shënim në pjesën e Kontekstit Politik. Traktatet ndërkombëtare parashikojnë që gjithsecili duhet të gëzojë të drejtën për të pasur mendime pa u ndikuar. Kjo do të thotë se të gjithë qytetarët, por edhe shoqatat, përfshirë dhe partitë politike, duhet të jenë të lirë që të kenë pikëpamjet e veta dhe t'i njoftojnë ato gjatë fushatës zgjedhore dhe ndërmjet zgjedhjeve. Burimet interpretuese pohojnë se duhet të ketë komunikim të lirë të informacionit dhe ideve rreth çështjeve publike dhe politike mes qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Ata theksojnë se llojet e mëposhtme të komunikimit nuk duhet të kthehen asnjëherë në objekt kufizimi:

- › Diskutimi i politikave qeveritare dhe debati politik;
- › Raportimi për të drejtat e njeriut, veprimtaritë qeveritare dhe korrupsionin nga ana e autoriteteve publike, fushatat zgjedhore ose demonstratat paqësore; dhe
- › Shprehja e mendimit dhe mospajtimit, fesë apo besimit, edhe nga persona që u përkasin pakicave apo grupeve të cënueshme.¹³

12 Shih Deklaratën e Përbashkët të Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe të Shprehjes (2006), Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, Raportuesit Special të OSHA-së për Lirinë e Shprehjes dhe Raportuesit të Veçantë të KADNJP-së (Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve) për Lirinë e Shprehjes.

13 Shih Raportin e Raportuesit Special të UNHRC-së për Mbrojtjen dhe Përkrahjen e të Drejtës së Lirisë së Mendimit dhe të Shprehjes (1999), para. 4(p)(i).

Siç parashikohet në Komentin e Përgjithshëm nr. 25 të Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, “Zgjedhësit duhet të jenë në gjendje që të krijojnë opinione në mënyrë të pavarur, pa dhunë apo kanosje me dhunë, detyrim, shtytje ose ndërhyrje manipuluese të ndonjë lloji”.

d. Liria e lëvizjes

Kufizimet e papërshtatshme të lirisë së lëvizjes, të cilat cenojnë çështjet e pjesëmarrjes politike, duhet të pasqyrohen gjithashtu në pjesën e Kontekstit Politik. Traktatet ndërkombëtare mbrojnë të drejtën e lëvizjes, e cila mundëson të drejtën për të udhëtuar dhe përfshin të drejtën e individëve për të shkuar nga një pjesë e territorit të vendit në një tjetër, për t’u larguar nga vendi dhe për t’u kthyer sërish. Në kontekstin e zgjedhjeve, është shumë e rëndësishme që partitë politike dhe votuesit, si dhe personeli i votimeve dhe vëzhguesit, të lëvizin lirshëm. Gjithsesi, liria e lëvizjes nuk shihet si parakusht për pjesëmarrje të qenësishme në jetën publike vetëm gjatë periudhave zgjedhore. Partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre duhet të jenë të lirë të udhëtojnë në të gjithë vendin për të zhvilluar takime me qytetarët në çdo kohë. Për shembull, qytetarët që punojnë larg shtëpisë së tyre, edhe nga jashtë vendit, duhet të kenë mundësinë të kthehen në vend për t’u marrë me punët e tyre, përfshirë dhe për t’u regjistruar si votues.¹⁴

e. E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake

Traktatet ndërkombëtare dhe rajonale mbrojnë të drejtën e sigurisë, e cila përfshin mbrojtjen nga arrestimi dhe ndalimi arbitrar, si dhe nga dëbimi. Burimet interpretuese theksojnë nevojën për të mbrojtur votuesit ose grupet e posaçme nga ndërhyrja, detyrimi dhe frikësimi. Ato parashikojnë se politikanet dhe votueset gra, shpesh, mund të jenë më shumë pre e frikësimit dhe detyrimit krahasuar me homologët burra. Ato, gjithashtu, e zgjerojnë të drejtën e sigurisë vetjake posaçërisht për pjesë të caktuara të popullatës, përfshirë grupe të cënueshme apo profesione (të tjera), të tillë si: gazetarët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Paragrafi 16 i **Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, ndalon torturën dhe trajtimin apo ndëshkimin mizor, çnjerëzor ose degradues.

Burime nga praktika e shteteve sugjeron se ky detyrim kërkon gjithashtu, trajtim të barabartë nga ana e autoriteteve, siç është qëndrimi neutral

¹⁴ Shih edhe Raportin e ODIHR-it për Angazhimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor dhe Regjimet e Shteteve ndaj Pandemisë së COVID-19-ës, i cili analizon se si liritë themelore të posaçme, përfshirë lirinë e lëvizjes, janë ndikuar gjatë periudhës së pandemisë.

i organeve të zbatimit të ligjit. E drejta e sigurisë vetjake kërkon që individët të jenë gjithmonë të mbrojtur nga dhuna fizike dhe emocionale. Abuzimet sistematike të së drejtës së sigurisë, përfshirë burgimin e individëve, që mendohet të mund të jenë bërë për arsye politike, kërkojnë pasqyrim të qartë në pjesën e Kontekstit Politik.¹⁵

Për hulumtim:

Aspektet e përgjithshme

- ✓ A ka kufizime ligjore në lidhje me qasjen ndaj të drejtave politike?
- ✓ A ka pengesa praktike për aktorët lidhur me qasjen ndaj lirive themelore?
- ✓ A janë kufizimet ekzistuese të të drejtave, përfshirë dhe ato gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, të nevojshme dhe proporcionale për qëllimin e tyre?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme?

Liria e tubimit

- ✓ A garantohet dhe mbrohet plotësisht, në kushtetutë, liria e tubimit?
- ✓ A janë të parashtruara qartë në legjisllacion, rregullat që normojnë grumbullimet publike dhe kushtet përkatëse lidhur me to?
- ✓ A munden partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe individët të grumbullohen paqësisht jashtë periudhës zgjedhore?
- ✓ A gëzohet dhe respektohet plotësisht e drejta e qytetarëve për të organizuar demonstrata dhe takime paqësore?
- ✓ A ka kufizime praktike të lirisë së tubimit, që zvogëlojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike ose politike? A janë të nevojshme, a i shërbejnë një interesi legjitim dhe a janë proporcionale me qëllimet e deklaruara?
- ✓ A kërkohet vetëm njoftim për organizimin e një grumbullimi publik, apo nevojitet leje nga autoritetet?
- ✓ A ekzistojnë mjetet juridike të efektshme dhe a janë përdorur ndonjëherë në mënyrë të suksesshme? A i trajtojnë gjykatat problemet brenda një kohe të arsyeshme?
- ✓ A ka grupe që gëzojnë trajtim preferencial në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit? Nga ana tjetër, a ka grupe që përballen me kufizime të papërshtatshme?

15 Për më shumë, shih Udhëzuesin e ODIHR-it për Ofruesit e Sigurisë Publike në Zgjedhje.

Liria e organizimit

- ✓ A garantohet dhe mbrohet plotësisht, në kushtetutë, liria e organizimit për partitë politike?
- ✓ A janë të qarta rregullat në lidhje me lirinë e organizimit dhe a janë të gjitha kushtet përkatëse të parashtruara në legjisllacion?
- ✓ A gëzohet dhe respektohet plotësisht në praktikë, e drejta e organizimit?
- ✓ A ka kërkesa ligjore të paarsyeshme, shproporcionale, të panevojshme ose të paqarta, për regjistrimin e partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile?
- ✓ A janë të bazuara në ligj, vendimet në lidhje me regjistrimin e partive politike ose organizatave të shoqërisë civile?
- ✓ A mundet që vendimet për refuzimin e regjistrimit të shqyrtohen në kohë nga gjykatat?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme? A janë përdorur në mënyrë të suksesshme?
- ✓ A ka të dhëna për refuzime për regjistrim apo çregjistrim të partive politike ose organizatave të shoqërisë civile?
- ✓ A ka grupe që cenohen posaçërisht nga kufizimet për të drejtën e organizimit?
- ✓ A ka prova për diskriminimin e ndonjë grupi, nga ana e autoriteteve, në lidhje me të drejtën e organizimit?
- ✓ A ka grupe që përballen me vështirësi të panevojshme gjatë funksionimit apo zhvillimit të veprimtarive? A munden të sigurojnë fonde apo përballen me pengesa praktike që nuk e lejojnë këtë gjë?

Liria e shprehjes, formimit dhe mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve

- ✓ A garantohet dhe mbrohet plotësisht, në kushtetutë, liria e shprehjes, formimit dhe mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve?
- ✓ A janë të qarta rregullat në lidhje me lirinë e shprehjes, formimit dhe mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve dhe a ekzistojnë të gjitha kushtet përkatëse të parashikuara në legjisllacion?
- ✓ A u lejon ligji qytetarëve dhe kandidatëve të japin lirisht, informacione dhe ide rreth çështjeve publike dhe politike?
- ✓ A janë qytetarët dhe kandidatët të lirë dhe të aftë të formojnë dhe të mos ndryshojnë në mënyrë të pavullnetshme pikëpamje, si dhe të japin informacione e ide në praktikë, rreth çështjeve publike dhe politike?

- ✓ A lejohen qytetarët të angazhohen në debat publik dhe të botojnë materiale politike?
- ✓ A janë qytetarët të lirë të mbështesin apo të kundërshtojnë qeverinë, pa asnjë lloj ndikimi apo shtrëngimi të papërshtatshëm?
- ✓ A e ka gjithsecili lirinë të kërkojë, të marrë dhe të japë informacione dhe ide të çdo lloji, pavarësisht kufijve, qoftë me gojë, me shkrim ose me shtyp, apo nëpërmjet çdo mjeti tjetër komunikimi që zgjedhin?
- ✓ A ka historik ndërhyrjesh apo kufizimesh të qasjes ndaj lirisë së shprehjes? Po ashtu, a ka të dhëna të përpjekjeve për të penguar lirinë e qytetarëve për të formuar mendime në mënyrë të pavarur, pa kërcënim, shtytje apo ndërhyrje manipuluese?
- ✓ A përballen qytetarët me kufizime të ushtrimit të së drejtës së lirisë së shprehjes?
- ✓ A ka kufizime të diskutimit apo debatit politik, qoftë me ligj apo në praktikë?
- ✓ A janë të nevojshme kufizimet e mundshme me ligj të fjalës, a i shërbejnë një interesi legjitim, që mbrohet nga e drejta ndërkombëtare dhe a janë proporcionale me qëllimin e synuar?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme?
- ✓ A ka grupe, veçanërisht prej atyre të papërfaqësuar mjaftueshëm, që shpesh përbëjnë segmentet më të cenushme të shoqërisë, që përballen me trajtim/pengesa diskriminuese për të ushtruar lirinë e shprehjes ose për të formuar dhe për të mos ndryshuar mendime në mënyrë të pavullnetshme?

Liria e lëvizjes

- ✓ A ka ndonjë kufizim të lirisë së aktorëve për të lëvizur në të gjithë vendin apo për të dalë dhe për t'u kthyer sërish?
- ✓ A e kanë mundësinë partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre që të takohen me qytetarët në të gjithë territorin e vendit?
- ✓ A munden qytetarët që ndodhen larg vendbanimit të tyre, të marrin pjesë në mënyrë të qenësishme në qeverisje dhe në drejtimin e punëve publike, në kuptim të gjerë?

E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake

- ✓ A përcaktohet me ligj e drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake? A respektohet në praktikë?
- ✓ A janë të mbrojtur qytetarët nga arrestimi dhe ndalimi arbitrar?
- ✓ A ndalohen me ligj tortura dhe dënimet mizore dhe të pazakonta? A respektohen në praktikë këto ndalime?
- ✓ A ka të dhëna për shkelje të lirisë dhe sigurisë, në zgjedhjet e mëparshme?

- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme? A ka ndonjë grup që është më i cenueshëm se të tjerët nga abuzimi me të drejtën e lirisë dhe sigurisë?
- ✓ A i trajtojnë autoritetet shtetërore të gjitha grupet në mënyrë të barabartë në lidhje me respektimin e të drejtës së lirisë dhe sigurisë vetjake?
- ✓ A ka grupe që janë më të cenueshëm se të tjerët nga abuzimi me të drejtën e lirisë dhe sigurisë?
- ✓ A kanë sjellje neutrale organet e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë?
- ✓ A ka organizata ndërqeveritare ose ndërkombëtare joqeveritare, që kanë shprehur shqetësime në lidhje me respektimin e të drejtës së lirisë dhe sigurisë vetjake në vend?

2. Rrethanat e posaçme

Ka raste që zgjedhjet organizohen në kushte të pazakonta, si, për shembull, në kohë gjendjeje të jashtëzakonshme apo situatash të tjera të gatishmërisë shtetërore, gjatë së cilave kufizohet qasja ndaj lirive themelore. Në kontekste të tjera, zgjedhjet mund të shoqërohen me tensione politike ose shoqërore, të cilat mund të çojnë në dhunë, qoftë të nxitura për së brendshmi apo nga ndërhyrjet e huaja. Zhvillimi i zgjedhjeve në këto rrethana mund të prejë integritetin e procesit dhe/ose besimin e publikut tek procesi. Ndërsa çdo shfaqje dhune sistematike për arsye politike apo zgjedhore, që ka ndodhur në zgjedhjet e mëparshme, duhet pasqyruar në pjesën e raporteve që trajton sfondin politik, aktet dhe rastet e dhunës që kanë ndodhur në zgjedhjet aktuale, në proces vëzhgimi, duhet të pasqyrohen në pjesën përkatëse të raportit (zakonisht në pjesët që trajtojnë mjedisin e fushatës ose zhvillimet paszgjedhore).

a. Zgjedhjet në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme

Si reagim ndaj incidenteve të një shkalle apo ndikimi të gjerë, me natyrë kriminale, rebele apo terroriste, ndaj dhunës ose emergjencave të shëndetit publik dhe fatkeqësive natyrore, autoritetet mund të shpallin gjendjen e jashtëzakonshme apo të ngrenë mekanizma të tjerë, të posaçëm, për të mbrojtur më mirë, mirëqenien publike. Gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet në nivel vendor, rajonal ose kombëtar. Praktika tregon se mund të shpallen nivele të ndryshme të gjendjeve të jashtëzakonshme, gjatë të cilave autoritetet ekzekutive kanë nivele të ndryshme kompetencash, në varësi të asaj se sa e rëndë është situata dhe/ose të dispozitave ligjore që normojnë gjendjet e jashtëzakonshme. Traktatet ndërkombëtare parashikojnë

se shtetit mund t'i lejohet të vendosë kufizime të disa lirive themelore, të drejtave të njeriut dhe detyrimeve zgjedhore, ose t'i derogojë ato në kohë të tilla.¹⁶

PNDCP-ja dhe KEDNJ-ja parashikojnë se në kohë lufte apo emergjencash publike, që kërcënojnë jetën e kombit, shtetet mund të ndërmarrin masa derogimi i detyrimeve për të garantuar të drejtat dhe liritë sipas këtyre instrumenteve, përfshirë lirinë e lëvizjes, të organizimit, të tubimit dhe të shprehjes, por vetëm aq dhe për aq kohë sa nevojitet në rrethanat ekzistuese. **Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990**, parashikon gjithashtu se derogimet duhet të kufizohen me “aq sa është saktësisht e nevojshme për situatën”. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë marrë gjithashtu përsipër që “çdo derogim i detyrimeve në lidhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, gjatë gjendjes së emergjencës publike, duhet të mbetet saktësisht brenda kufijve të parashikuara nga e drejta ndërkombëtare, veçanërisht brenda instrumenteve ndërkombëtare përkatëse, me të cilat lidhen, sidomos sa i takon respektimit të të drejtave, të cilat nuk lejohet të derogohen”.

Derogimet zyrtare mund të bëhen vetëm pas shpalljes botërisht të gjendjes së jashtëzakonshme ose pas miratimit të proceseve të tjera ligjore të emergjencave zyrtare. Ligjet që normojnë gjendjet e jashtëzakonshme duhet të parashikojnë një shqyrtim të shpejtë dhe të pavarur të nevojës për këto derogime nga legjislativi. Si në rastet e tjera, kufizimet duhet të pajtohen me cilësimin trepjesësh të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe përpjesëtueshmërisë, si dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor. Edhe pse disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ndalime kushtetuese ose ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, nuk ka standard ndërkombëtar të posaçëm në lidhje me organizimin e zgjedhjeve nën regjimin e emergjencave. Sidoqoftë, praktika e mirë ndërkombëtare dëshmon qartë se nuk mund të ketë zgjedhje demokratike pa garantim të lirive themelore. Ekuilibrimi i garancive të lirive themelore me sigurinë ose me kufizimet e vendosura si rrjedhojë e shqetësimit për shëndetin publik, bëhet veçanërisht i ndërlikuar gjatë zgjedhjeve; prandaj është e nevojshme të shqyrtohet nëse kufizimet ose derogimet e të drejtave dhe lirive mund të ndikojnë procesin dhe rezultatet.

Në kontekstin e zgjedhjeve, gjendja e jashtëzakonshme mund të ndikojë mjedisin duke zvogëluar të drejtat e lirisë së tubimit (p.sh.: duke kufizuar grumbullimet); së shprehjes (p.sh.: duke i vendosur medias urdhër “heshtjeje”); dhe/ose së lëvizjes (p.sh.: shtetrrëthimet). Ajo mund të çojë gjithashtu në rritje të pranisë së personelit të sigurisë, përfshirë dhe ushtarakët, rreth mjediseve që përdoren për qëllime zgjedhore. Në fund, ajo mund të kërkojë

16 Parimet e Sirakuzës (1985) për Kufizimin e Derogimit të Dispozitave të PNDCP-së, të Komisionit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK), përcaktojnë se derogimet justifikohen “vetëm kur përballemi me situatë të pashmangshme rreziku të jashtëzakonshëm dhe të momentit, e cila kërcënon jetën e kombit” dhe sqarojnë se “konflikti dhe pakënaqësitë e brendshme, të cilat nuk përbëjnë kërcënim të rëndë dhe të pashmangshëm ndaj jetës së kombit, nuk mund të justifikojnë derogimet”.

zhvendosjen e infrastrukturës dhe të administratës zgjedhore. Informacionet faktike në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme që shpallet apo mbahet gjatë periudhës zgjedhore, si dhe referencat e mundshme të raporteve të organizatave ndërkombëtare të besueshme për ndikimin e saj tek qasja ndaj lirive themelore, duhen përfshirë në pjesën e Kontekstit Politik. Vlerësimi dhe hollësitë e posaçme, që prekin aspekte të veçanta të procesit zgjedhor, duhet të shtellohen në pjesët përkatëse tematike të raporteve të ODIHR-it për zgjedhjet, për shembull, në pjesët e Kuadrit Ligjor ose të Mjedisit të Fushatës. Në përgjithësi, këto vlerësime kërkojnë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet analistëve, p.sh.: ndërmjet Analistëve Politikë dhe Ligjorë.

Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u prekën nga shpërthimi botëror i pandemisë së COVID-19-ës, në vitin 2020 dhe morën masa të ndryshme për të parandaluar përhapjen e mëtejshme. Gjatë pandemisë, shteteve u është dashur të ekuilibronin mbrojtjen e lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut me masat e reagimit në kushte emergjence. Në këtë kuadër, u vështirësua zbatimi i aspekteve të dimensionit njerëzor të OSBE-së. Në përputhje me mandatin, ODIHR-i u orvat t'u kujtonte angazhimet shteteve pjesëmarrëse. Ai botoi Raportin për Angazhimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë së COVID-19-ës, duke theksuar vështirësitë e posaçme, që buruan nga kriza përgjatë zonës së OSBE-së. Raporti paraqet një tablo të detyrimeve të shteteve, kur shpallin gjendje të jashtëzakonshme dhe kur derogojnë apo kufizojnë liritë themelore, përshkruan ndikimet e ndryshme, që kanë këto masa tek institucionet demokratike dhe tek të drejtat e njeriut dhe jep rekomandime për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, në lidhje me trajtimin e emergjencave të njëjta apo të ngjashme në të ardhmen.

b. Dhuna politike dhe zgjedhore

Zgjedhjet janë mekanizëm konkurrimi politik paqësor ndërmjet garuesve që synojnë një detyrë publike. Në disa kontekste, aspektet e procesit zgjedhor mund të shoqërohen nga tensione politike ose shoqërore; kjo ka më shumë gjasa të ndodhë në rastet kur zgjedhjet preken nga manipulimi ose kur aktorët nuk kanë besim tek integriteti i procesit.

Dhuna politike mund të përshkruhet si dhunë e shkaktuar apo kërcënim për dhunë, që shteti bën kundrejt aktorëve joshitetërorë (p.sh.: dhuna policore) dhe kundrejt shteteve të tjera (p.sh.: konfliktet e armatosura apo luftërat). Ajo mund të nënkuptojë edhe dhunë me motive politike nga aktorët joshitetërorë kundrejt shtetit (p.sh.: demonstrata të dhunshme, trazira ose grusht shteti), ose kundrejt aktorëve të tjerë joshitetërorë. Disa shfaqje të caktuara të mosveprimit të shtetit mund të karakterizohen gjithashtu si forma të dhunës politike, siç është mosveprimi për mbrojtjen e popullsisë nga dëmtimet e shkaktuara nga natyra ose nga njeriu. **Dhuna zgjedhore**, zakonisht, i referohet akteve ose kërcënimeve për shtrëngim, frikësim ose lëndim fizik, me qëllim ndikimin tek procesi ose konkurrimi zgjedhor. Kandidatet dhe votueset gra,

grupet e papërfaqësuar mjaftueshëm, përfshirë dhe pakicat kombëtare, por edhe kategori të caktuara profesionale, të tilla si: gazetarët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, mund të jenë veçanërisht të cenueshme dhe të prekshme nga rreziku. Këto rreziqe mund të përfshijnë dhunën fizike ose psikologjike, siç është edhe mujshimi në internet; komentet poshtëruese seksiste dhe të llojeve të tjera; dhe format e ndryshme të frikësimit. Për të kuptuar dhunën zgjedhore, është e rëndësishme të shqyrtohen shkaqet e mundshme të saj, të cilat mund të përfshijnë ndarjet e thella shoqërore dhe politike; historikun e dhunës politike; interesat madhore që karakterizojnë zgjedhjet; shqetësimet në lidhje me të drejtat e njeriut; institucionet shtetërore të dobëta; varfërinë; pabarazinë shoqërore dhe ekonomike; dhe korrupsionin.

Shtytësit e mundshëm të dhunës zgjedhore mund të jenë parregullsitë apo shkeljet që ndodhin në secilën pjesë të procesit, të tilla si: mungesa e regjistrimit gjithëpërfshirës të kandidatëve; kushtet e padrejta të fushatës dhe retorika agresive; proceset për nxjerrjen e rezultateve që nuk janë transparente dhe të administruara mirë; mungesa e mjeteve juridike të efektshme; perceptimi për institucione të njëanshme, përfshirë dhe institucionet që gjykojnë mosmarrëveshjet; pakënaqësitë, manipulimet ose problemet me organizimin gjatë ditës së zgjedhjeve; kuadrot ligjore diskriminuese ose jofunksionale; caktimi i padrejtë ose i manipuluar i kufijve zgjedhorë; dhe regjistrimi jo gjithëpërfshirës dhe diskriminues i votuesve. Këto shkelje dhe parregullsi të tjera, shpesh, kanë për synim ndikimin tek rezultati, duke përcaktuar fituesin/fituesit ose rezultatin e referendumit. Në të njëjtën mënyrë, është e rëndësishme të pranohet se dhuna mund të jetë e rrënjësuar dhe e nxitur nga elemente që nuk lidhen me garën zgjedhore, siç janë urrejtja gjinore apo racore. Ndonjëherë, aktorët mund t'i përdorin zgjedhjet si mundësi për të nxitur grindjet shoqërore dhe dhunën. Është e rëndësishme të vërehet dhe të shënohet në raporte të misionëve se grupet e papërfaqësuar mjaftueshëm, si gratë, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara, mund, në disa raste, të kthehen në objektiva të dhunës politike ose zgjedhore dhe të jenë veçanërisht të cenueshme nga format e ndryshme të dhunës.

Dhuna zgjedhore mund të jetë spontane, si për shembull në rastin kur protestuesit reagojnë ndaj shkeljeve. Por, ajo mund të jetë edhe e paramenduar dhe e kryer në mënyrë, pak a shumë, të planifikuar me qëllim shtytjen e një kauze të posaçme apo të një qëllimi politik. Ajo mund të ndodhë gjatë periudhës zgjedhore, edhe në ditën e zgjedhjeve apo si reagim ndaj shpalljes së rezultateve, por mund të shfaqet edhe shumë më herët, duke ndikuar kështu tek atmosfera e përgjithshme përpara votimeve. Çdo rast i dhunës politike, veçanërisht kur është sistematike, përbën pjesë të rëndësishme të kontekstit ku zhvillohen zgjedhjet dhe prandaj duhen trajtuar: goftë në pjesën e Kontekstit Politik, në rastin kur dhuna shfaqet përpara zgjedhjeve; në pjesën e Mjedisit të Fushatës, nëse shfaqet gjatë fushatës zgjedhore; ose në pjesën e Zhvillimeve Paszgjedhore, nëse shfaqet pas votimeve.

Për hulumtim:

Gjendja e jashtëzakonshme

- ✓ A është shpallur gjendje e jashtëzakonshme apo a është njoftuar zyrtarisht ndonjë masë tjetër emergjence në vend? Kur është shpallur/njoftuar?
- ✓ A u shpall gjendja e jashtëzakonshme apo masa e emergjencës, në përputhje me kushtetutën dhe a pati konsensus politik?
- ✓ Çfarë lloj emergjence është? Cilat janë llojet e ndryshme të regjimit të emergjencës, që parashikohen nga kushtetuta?
- ✓ A pranohen gjerësisht nga aktorët, bazat e gjendjes së jashtëzakonshme? Me aq sa mund të vlerësohet, a janë masat e emergjencës proporcionale dhe të nevojshme?
- ✓ A pajtohen kufizimet e lirive themelore me kriteret e cilësimit tre pjesësh të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit?
- ✓ A përmbajnë referenca të posaçme për zgjedhjet, dispozitat për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme apo të masave të tjera të emergjencës?
- ✓ Çfarë ndikimi ka pasur shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme tek ushtrimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore?
- ✓ Cilat derogime të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore janë vendosur së bashku me gjendjen e jashtëzakonshme?
- ✓ A janë marrë masa për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme?

Dhuna politike dhe zgjedhore

- ✓ A ka raste të dhunës me natyrë politike ose zgjedhore, në vend?
- ✓ A ka historik të dhunës politike ose zgjedhore? A janë rastet e dhunës të izoluar apo janë pjesë e një fenomeni më të gjerë ose të një strategjie të organizuar?
- ✓ Nëse janë të përhapura, a ndodhin rastet e dhunës në të gjithë vendin apo kufizohen në zona të caktuara?
- ✓ Cilët janë aktorët kryesorë, si nga ana e autorëve dhe e viktimave të dhunës?
- ✓ A ka shtresa të shoqërisë, për shembull, grupet e papërfaqësuar mjaftueshëm, që janë më të prekura nga dhuna politike ose zgjedhore?
- ✓ Si po reagon shteti ndaj rasteve të dhunës zgjedhore? Si shihet ky reagim nga aktorët?
- ✓ Si ndikon dhuna dhe reagimi ndaj saj tek përgatitjet e zgjedhjeve?

3. Aspektet e situatës zgjedhore

Raporti zgjedhor standard i ODIHR-it duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme të situatës zgjedhore:

a. Sistemi politik dhe përbërja e parlamentit dhe qeverisë (që u mbaron mandati)

Informacionet në lidhje me strukturën shtetërore dhe me sistemin politik, si dhe referencat në lidhje me marrëdhënien ndërmjet ekzekutivit dhe legjislativit, duhet të pasqyrohen qartë në nisje të raportit të misionit. Informacionet në lidhje me përbërjen e parlamentit që i mbaron mandati (dhe ndonjë ndryshim përkatës i rëndësishëm), mund të ndihmojnë publikun të kuptojë zhvillimet politike në vend që prej zgjedhjeve të mëparshme. E njëjta gjë vlen për informacionet në lidhje me përbërjen e qeverisë apo me ndryshimet më të fundit të anëtarëve të qeverisë. Së paku, këto informacione i japin lexuesit botëkuptim më të plotë rreth aktorëve politikë me rëndësi. Gjithashtu, ato mund të shërbejnë si kontekst për pjesët e mëvonshme të raportit, për shembull, në lidhje me përbërjen e administratës zgjedhore apo me shpërndarjen e kohës mediatike pa pagesë, gjatë fushatës (p.sh.: kur përdoret model me kuota proporcionale). Në fund, informacionet tregojnë se cilat janë forcat politike që garojnë në zgjedhje, të cilat gëzojnë përfaqësim dhe/ose janë në detyrë.

Informacionet në lidhje me përbërjen e parlamentit dhe të qeverisë duhet të ndahen sipas gjinisë.¹⁷ Disa instrumente ndërkombëtare, përfshirë dhe dokumentet e OSBE-së, bëjnë thirrje për pjesëmarrje të ekuilibruar të grave dhe burrave, në jetën politike dhe publike. Ato kërkojnë gjithashtu, grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme, për të mbikëqyrur dhe përmirësuar situatën e grave. Prandaj, vlerësimi sasior dhe ai cilësor i përfaqësimit, përfshirë numrin e pozitave kryesore, që drejtohen nga përfaqësues të gjinive të ndryshme, meritojnë të pasqyrohen në pjesën e Kontekstit Politik.

b. Zhvillimi i zgjedhjeve të mëparshme

Numri i zgjedhjeve të mëparshme, të vëzhguara nga ODIHR-i, në shtetin pjesëmarrës duhet të pasqyrohet në pjesën e Kontekstit Politik. Aty mund të përfshihet edhe një përmbledhje e shkurtër e gjetjeve nga raporti i fundit, veçanërisht nëse nuk janë përmbushur standardet ndërkombëtare kryesore

¹⁷ Çdo muaj, Unioni Ndërparlamentar boton informacione në lidhje me përfaqësimin e grave në parlamentet kombëtare.

për zgjedhje demokratike. Edhe pse metodologjia e ODIHR-it përjashton krahasimet e zgjedhjeve në kohë (në një shtet pjesëmarrës të vetëm) dhe hapësirë (ndërmjet shteteve pjesëmarrëse), këto referenca mund t'i shërbejnë lexuesit për të kuptuar më mirë trajektoren e zhvillimit demokratik në shtetin pjesëmarrës.

c. Elemente të tjera që duhen marrë parasysh

Aspektet e sipërpërmendura, të cilat Analisti Politik duhet të synojë t'i trajtojë në pjesën e Kontekstit Politik, nëse janë të rëndësishme, nuk janë kurrsesi shteruese. Ndërsa këto aspekte përbëjnë pjesën kryesore të mjedisit politik të përgjithshëm, ku zhvillohen zgjedhjet, ka edhe aspekte të tjera që ndoshta duhet të merren parasysh. Disa prej faktorëve më të rëndësishëm janë, si më poshtë:

Sundimi i ligjit dhe funksionimi i institucioneve demokratike: Në kontekste ku ka shqetësime në lidhje me ndarjen e pushteteve, respektimin e sundimit të ligjit dhe me funksionimin e saktë të institucioneve demokratike, për shembull, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit, këto shqetësime duhen sqaruar në pjesën e Kontekstit Politik.¹⁸ Duhet trajtuar gjithashtu, çështjet përmbajtësore dhe procedurale, të tilla si: përkeqësimi i dukshëm i cilësisë së parlamentarizmit ose shkeljet e rënda të procedurës parlamentare, një prej të cilave do të ishte mungesa e konsultimeve të gjera dhe gjithëpërfshirëse me opozitën dhe/ose me shoqërinë civile, gjatë miratimit të ligjeve, apo edhe shkeljet e normave të tjera demokratike.

Politikat dhe praktikat kundër korrupsionit: Në ato shtete pjesëmarrëse, ku korrupsioni përbën pengesë të ndjeshme për funksionimin e institucioneve demokratike, ku perceptohet si shumë i përhapur në administratën publike, ose ku politikat kundër korrupsionit përbëjnë temë të rëndësishme në jetën politike, një gjë e tillë duhet të theksohet në pjesën e Kontekstit Politik. Ndërsa çështjet e transparencës trajtohen pjesërisht, në disa prej pjesëve tematike të raportit standard të ODIHR-it për zgjedhjet, mund të jetë me vend që të trajtohen shqetësimet në lidhje me mungesën sistematike të transparencës politike, apo edhe anasjelltas, të vlerësohen pozitivisht politikat që mbështesin transparencën.

Protestat dhe bojkotet politike, shoqërore ose zgjedhore: Nëse periudha parazgjedhore paraprihet nga protestat, qofshin politike, ekonomike a shoqërore, ose nëse disa garues potencialë bojkotojnë apo kërcënojnë të bojkotojnë zgjedhjet, duhet menduar përfshirja e këtyre aspekteve në pjesën e Kontekstit Politik.

¹⁸ Shih Listën e Kontrollit të Komisionit të Venecias për Sundimin e Ligjit.

Sistemi i partive politike ose lëvizjet shoqërore: Mund të përmenden gjithashtu, ndryshimet e sistemit të partive politike, përfshirë dhe daljen në skenë të partive politike të reja dhe veçanërisht të dukshme, por edhe të lëvizjeve shoqërore, që marrin pjesë në zgjedhje ose që formësojnë programin e fushatës.

Demokracia e brendshme e partive: Çështjet e organizimit të brendshëm të partive, rrallëherë, trajtohen në raportet e zgjedhjeve, por në rastin e situatave të veçanta, qofshin pozitive apo negative, ato mund të përfshihen në pjesën e Kontekstit Politik.

Përfshirja e grave, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara: Është kthyer në praktikë përfshirja e informacioneve numerike, siç është ndarja gjinore, për legjislaturën që i mbaron mandati, në pjesën e Kontekstit Politik, ndërsa çështjet më të gjera në lidhje me pjesëmarrjen e grave, pakicave kombëtare apo personave me aftësi të kufizuara, integrohen në raportet e ODIHR-it ose trajtohen në pjesë të posaçme. Sidoqoftë, duhet theksuar se aspektet në lidhje me kushtet themelore dhe gjetjet apo përfundimet e tjera, që kanë të bëjnë me përfshirjen e grupeve të papërfaqësuar mjaftueshëm mund të pasqyrohen gjithashtu, në pjesën e Kontekstit Politik. Përmendja e tyre në këtë pjesë mund të jetë veçanërisht me vlerë, kur ka arsye të qenësishme për të theksuar rëndësinë e tyre që në fillim të raportit.

Zhvillimet e brendshme politike: Që lexuesit të kenë kontekst më të mirë të zgjedhjeve, mund të jetë e dobishme të radhiten zhvillimet e fundit politike ose ekonomike, p.sh.: çështje si protesta të opozitës apo krizat ekonomike. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, mund të nevojitet të jepen informacione në lidhje me arsyet ose një përshkrim i shkurtër i ngjarjeve që çuan në shpërbërjen e parlamentit ose në mbarimin e mandatit të ekzekutivit.

Dimensioni ndërkombëtar: Në ato shtete pjesëmarrëse që kanë arritur ose po synojnë një objektiv të rëndësishëm të politikës së jashtme – p.sh.: anëtarësimin në një organizatë ndërkombëtare – këto informacione mund të përfshihen në pjesën e Kontekstit Politik. Nëse kanë të bëjnë me zgjedhjet, mund të përmenden raportet e ecurisë për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimin në organizatën e synuar, edhe në formën e sfondit dhe kontekstit politik.



KAPITULLI III

FUSHATA ZGJEDHORE

Zhvillimi i fushatës është pjesë shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme e procesit zgjedhor. Ajo u jep mundësinë garuesve të paraqesin pikëpamjet dhe platformat e tyre dhe votuesve të familjarizohen me kandidatët dhe politikat që ata propozojnë. Nuk mund të ketë zgjedhje demokratike pa shkëmbim të lirë të ideve ndërmjet garuesve dhe votuesve. Prandaj, pluralizmi politik dhe qasja ndaj lirive të shprehjes, tubimit, organizimit, lëvizjes dhe e drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake janë parakushte të nevojshme për të pasur fushata zgjedhore, qenësisht demokratike. Në të njëjtën kohë, autoritetet shtetërore kanë për detyrë të garantojnë respektimin e angazhimeve të OSBE-së dhe të standardeve ndërkombëtare, që nxisin fushatat e ndershme. Ky kapitull trajton respektimin e lirive themelore dhe përmbushjen e përgjegjësive nga

ana e shteteve për të siguruar kushte të lira dhe të barabarta gjatë periudhës së fushatës.¹⁹

Në zgjedhjet demokratike, të gjithë garuesit duhet të jenë të aftë të përcjellin dhe të promovojnë mesazhet e tyre në mënyrë të lirë dhe me mundësi të barabarta, të takojnë zgjedhësit, të udhëtojnë nëpër zonat zgjedhore për të shkuar tek votuesit për të paraqitur programet dhe pikëpamjet e tyre. Nga ana e tyre, votuesit duhet të kenë liri të formojnë mendime pa ndërhyrje të papërshtatshme, si dhe të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion kur hedhin votën. Bartësit e postit që garojnë përsëri nuk duhet të gëzojnë përparësi të papërshtatshme si pasojë e funksionit të tyre. Në zgjedhje nuk duhet të ketë dhunë, shqetësime dhe frikësim, e as nxitje të dhunës e të urrejtjes. Çdo kufizim apo përpjekje për të kufizuar të drejtat dhe liritë themelore gjatë periudhës zgjedhore, nga ana e aktorëve shtetërorë ose joshetërorë, duhet trajtuar në pjesën e raportit, që përshkruan Mjedisin e Fushatës.

Analisti Politik duhet t'i kushtojë gjithnjë vëmendje të veçantë, të gjitha pengesave zyrtare ndaj lirisë së fushatës, si në lidhje me germën e ligjit dhe me mënyrën se si zbatohen rregullat në praktikë. Rregulla që në pamje të parë mund të duken si dashamirëse, përfshirë dhe disa përpjekje për të nxitur barazinë — si për shembull, përcaktimi i numrit të tabelave të mëdha, që lejohen për kandidat, apo përmasës, formatit dhe gjerësisë së fletëpalosjeve të platformës, që mund t'u shpërndahen votuesve — mund të ketë ndikim negativ tek aftësia e votuesve për të bërë zgjedhje të bazuara në informacion. Këto kufizime mund të ndikojnë negativisht tek konkurrenca në fushatë dhe si përfundim edhe tek vetë zgjedhjet. Përpjekjet e vrazhda dhe me dorë të fortë për të ndrydhur debatin politik nëpërmjet rregullave të tepruara, as nuk mundësojnë fushatë angazhuese e as nuk lejojnë fushata zgjedhore, qenësisht demokratike.

Gjatë vëzhgimit të mjedisit të fushatës në raport me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të zgjedhjeve demokratike, Analisti Politik përpiqet të vlerësojë:

- Nëse qasja ndaj lirisë themelore parashikohet në kuadrin ligjor dhe nëse garantohet në praktikë;
- Pluralizmin dhe konkurrueshmërinë e fushatës;
- Aftësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të bazuara në informacion, pa trysni ose frikën e ndëshkimit;

¹⁹ Ky kapitull nuk trajton çështjet e financimit të partive dhe të fushatave, të cilat trajtohen në Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Financimit të Fushatës (2015). Në mënyrë të ngjashme, kapitulli nuk trajton çështjet e qasjes së kandidatëve në media dhe mbulimin mediatik të fushatës, të cilat trajtohen në Manualin e ODIHR-it për Monitorimin e Medias nga Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (2012). Përdorimi i rrjeteve sociale në fushata trajtohet në Udhëzuesin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Fushatave Zgjedhore në Rrjetet Sociale (2021).

- › Çdo faktor që ndikon në rregullat e lojës, dhe/ose u jep disa garuesve, veçanërisht bartësve të posteve, përparësi të papërshtatshme;
- › Nëse ndonjë prej garuesve është përballur me kufizime apo pengesa të papërshtatshme gjatë zhvillimit të fushatës;
- › Rastet e dhunës, ngacmimit apo frikësimit, nxitjet e urrejtjes ose edhe rastet më të ashpra të gjuhës negative; dhe
- › Çdo përpjekje të papërshtatshme për të detyruar ose joshur votuesit me ryshfete, qoftë me forma të drejtpërdrejta apo më të sofistikuar të ofertave apo premtimeve për oferta.

1. Vlerësimi i mjedisit të fushatës

Kushtetuta ose legjislacioni parësor duhet të parashikojnë garanci për të drejtat e nevojshme për zhvillimin e fushatave të lira dhe duhet të mbështeten nga rregulloret, zbatimi i të cilave duhet të mbikëqyret nga organet administrative kompetente, siç janë organet e administrimit të zgjedhjeve (OAZ-të). Në disa raste, qasja ndaj lirive themelore mund të lehtësohet nëpërmjet dispozitave të veçanta, të zbatueshme gjatë periudhës së fushatës. Analisti Politik duhet të shqyrtojë me imtësi kuadrin ligjor dhe rregullator, zakonisht, së bashku me Analistin Ligjor, dhe të kuptojë mirë mënyrën se si garantojnë liritë themelore. Është po aq e rëndësishme që analistët të evidentojnë boshllëqet apo mungesat në legjislacion, që pengojnë respektimin e plotë të standardeve ndërkombëtare apo që bien ndesh me to. Duhet vlerësuar niveli i zbatimit të rregullave, për të parë nëse:

- › Kuadri ligjor u lejon garuesve e votuesve të gëzojnë lirisht të drejtat dhe liritë themelore;
- › Kuadri ligjor lejon kushte për fushatë të ndershme dhe të lirë;
- › Të gjitha partive politike dhe/ose kandidatëve u ofrohen mundësi të barabarta për të konkurruar; dhe
- › Disa prej garuesve janë të favorizuar ose të pafavorizuar gjatë procesit.

Gjatë periudhës së fushatës, shkeljet zgjedhore, shpesh, përbëjnë aspekt të pashmangshëm të procesit zgjedhor. Ankesat në lidhje me fushatën mund të bazohen tek një diapazon i gjerë çështjesh, siç janë cenimet e lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut, abuzimet me burimet shtetërore dhe administrative apo blerja e votave.

Trajtimi i këtyre çështjeve kërkon sistem të fortë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, i cili përfshin një kuadër ligjor të plotë, si dhe mbikëqyrje të pavarur dhe të efektshme. Institucionet përgjegjëse për zbatimin, përfshirë organet e zbatimit të ligjit, duhet të marrin masa për të parandaluar shkeljet, për të trajtuar ndonjë shkelje që ka ndodhur, si dhe për të ndëshkuar autorët. Duhet të ndërmerren veprime të përshtatshme dhe proporcionale në mënyrë të saktë, të dukshme dhe në kohë, për të shkurajuar shkelje të ngjashme në të ardhmen. Në **Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar të mundësojnë “mjete të efektshme ligjore ndaj vendimeve administrative, për të garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe integritetin ligjor”. Vlerësimi i kuadrit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore, edhe për shkeljet në lidhje me fushatat, është pjesë e fushë-veprimit të Analistit Ligjor. Kështu, Analisti Politik duhet të bashkëpunojë ngushtësisht dhe të njoftojë Analistin Ligjor, rreth ndonjë problemi potencial, që del gjatë vëzhgimit të fushatës. Së bashku me Analistin Ligjor, Analisti Politik duhet të shqyrtojë sanksionet në fuqi për shkeljet në lidhje me fushatën dhe të vlerësojë nëse ato janë të efektshme, proporcionale dhe shkurajuese.²⁰

a. Respektimi i lirive themelore në fushatën zgjedhore

Respektimi i lirive themelore është thelbi i fushatës zgjedhore demokratike. Ato janë të rëndësishme si për garuesit edhe për votuesit dhe, si të tilla, përcaktohen në instrumentet kryesore ndërkombëtare ligjore dhe mbështeten nga angazhimet politike, përfshirë dhe Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990. Kur vlerësohet kuadri ligjor për fushatën, Analisti Politik duhet të shqyrtojë respektimin e lirive themelore dhe të të drejtave në kontekstin e fushatës, si përcaktohet në ligj dhe si zbatohet në praktikë.

Liria e tubimit – në kontekstin e zgjedhjeve, ajo përcakton të drejtën për të organizuar takime politike dhe veprimtari të fushatës. Siç parashtrohet në kapitullin e mëparshëm, çdo normim i lirisë për t’u grumbulluar, edhe gjatë periudhave të fushatës, duhet të kufizohet thjesht tek kërkesa për njoftim të autoriteteve përkatëse, zakonisht të qeverisë vendore, dhe më rrallë të policisë. Me fjalë të tjera, organizimi i një tubimi për fushatë ose i takimeve të tjera, nuk duhet të ketë nevojë për leje nga ndonjë autoritet.

Liria e grumbullimit është veçanërisht e rëndësishme gjatë periudhës së fushatës, atëherë kur komunikimi ndërmjet garuesve dhe votuesve ka nevojë të lehtësohet dhe të mbrohet. Prandaj, në disa kontekste, mund të vendosen rregulla të veçanta për të zgjeruar qasjen ndaj lirisë së grumbullimit gjatë zgjedhjeve. Në rastet ku, në mënyrë përjashtimore, ka kufizime në fuqi, standardet ndërkombëtare parashikojnë që ato duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë garuesit: për shembull, në disa

²⁰ Për më shumë, shih Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve Zgjedhore.

vende, ndalohen grumbullimet në afërsi të ndërtesave qeveritare, si dhe në mjediset shëndetësore dhe arsimore. Gjithashtu, partitë politike dhe kandidatët nuk duhet të ngarkohen me rregulla të tepërta apo të përballen me vështirësi administrative, të tilla si: kufizime të papërshtatshme me hapësirat kohore, kur mund të zhvillohen veprimtaritë, me kosto të paarsyeshme për mbrojtje policore ose me pengesa të tjera teknike, të pajustificuara. Është e rëndësishme të vihet në dukje se shtetet pjesëmarrëse kanë detyrimin pozitiv të garantojnë gëzimin e lirisë së grumbullimit, e cila duhet të jetë e qasshme për të gjithë.

Liria e shprehjes dhe e drejta e mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve pa u ndikuar u ofrojnë garuesve dhe votuesve të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe votuesve të drejtën për të bërë zgjedhje të bazuar në informacion. Ndërsa elementet e respektimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve do të trajtohen nga Analisti i Medias, në Pjesën e Medias së raportit të ODIHR-it për zgjedhjet, ato duhet të vlerësohen gjithashtu, nga Analisti Politik, në kontekstin e fushatës zgjedhore. Dy aspektet e kësaj lirie nënkuptojnë në fakt se të gjithë votuesit, kandidatët, por edhe shoqatat, përfshirë partitë politike, duhet të jenë të lira të ruajnë pikëpamjet e veta dhe t'i komunikojnë ato sipas dëshirës. Burimet interpretuese pohojnë se duhet të ketë komunikim të lirë të informacionit dhe ideve rreth çështjeve publike e politike ndërmjet qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Ato nënvizojnë posaçërisht se disa lloje të posaçme komunikimesh, përfshirë dhe fushatat zgjedhore, nuk duhet të jenë objekt kufizimesh.

Kufizimet e lirisë së shprehjes mund të quhen të justifikuara nëse shkojnë deri tek ndalimi i nxitjes së urrejtjes, dhunës dhe përkrahjes së terrorizmit.²¹ Me përparimin e mediave numerike dhe të rrjeteve sociale, retorikat e ndezura janë bërë gjithnjë e më të zakonshme gjatë fushatave zgjedhore, ku si votuesit edhe garuesit përdorin narrativa më të skajshme. Rastet e gjuhës që nxit dhunën ose urrejtjen, veçanërisht kur dalin prej garuesve zgjedhorë apo kanë lidhje me to, duhet të trajtohen në raportin për zgjedhjet. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të pranojmë se “edhe pse justifikohet sanksionimi i ligjëratave që përbëjnë nxitje të urrejtjes, nuk justifikohet ndalimi i një gjuhe që është thjesht ofenduese”.²²

21 Shih nenin 20.2 të PNDPC-së dhe paragrafin 40.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990.

22 Shih Deklaratën e Përbashkët të Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe të Shprehjes (2006), Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, Raportuesit Special të OSHA-së për Lirinë e Shprehjes dhe Raportuesit Special të KADNP-së (Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve) për Lirinë e Shprehjes.

Liria e lëvizjes – në kontekstin e zgjedhjeve, kjo liri u jep të drejtën garuesve dhe votuesve të udhëtojnë pa kufizime të panevojshme, në të gjithë vendin, gjatë fushatës dhe periudhës zgjedhore. Është shumë e rëndësishme që përfaqësuesit e partive politike dhe kandidatët të kenë mundësinë të takohen me votuesit për të prezantuar veten dhe platformat. Burime nga praktika e shteteve theksojnë se garuesit duhet të jenë të lirë të bëjnë fushatë, përfshirë dhe organizimin e tubimeve dhe takimeve, me të cilat mund t'i qasen më drejtpërdrejtë votuesve. Edhe votuesit duhet të jenë të lirë të udhëtojnë për të marrë pjesë në veprimtari që kanë të bëjnë me zgjedhjet, për shembull.

E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake – Në kontekstin e fushatës zgjedhore, e drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake është shumë e rëndësishme për të garantuar që garuesit të jenë të lirë, t'u paraqesin kandidaturën votuesve pa frikën e ndëshkimit. Votuesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e partive politike dhe të shoqërisë civile duhet të jenë të lirë të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme zgjedhore apo paszgjedhore, qofshin veprimtari të fushatës apo protesta, pa pasur frikë për ndonjë lloj ndëshkimi. Siç është vënë në dukje tashmë, në kapitujt e mëparshëm, burimet interpretuese theksojnë nevojën për të mbrojtur votuesit, gratë politike dhe grupet e papërfaqësuarra mjaftueshëm dhe të cenueshme nga ndërhyrja, shtrëngimi dhe frikësimi. Sa i takon fushatës, kjo e drejtë trajtohet në pjesët e mëposhtme.

Për hulumtim:

Liria e tubimit

- ✓ A ka kufizime të lirisë së tubimit, qoftë me ligj apo në praktikë, të cilat pakësojnë mundësitë e garuesve për të organizuar apo zhvilluar takime me votuesit, apo që pakësojnë mundësitë e këtyre të fundit për të marrë pjesë në fushatë?
- ✓ A janë kufizimet ekzistuese të nevojshme, a i shërbejnë një interesi legjitim dhe a janë proporcionale me qëllimin e deklaruar?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme?
- ✓ A e kanë aktorët të drejtën për të kundërshtuar vendimet për ndalimin e grumbullimit? A i trajtojnë në kohë gjykatat këto ankesa?
- ✓ A parashikon ligji kërkimin e lejes tek autoritetet për organizimin e veprimtarive të fushatave apo parashikon njoftim të autoriteteve kompetente nga ana e organizatorëve?
- ✓ A ka grupe apo garues që gëzojnë trajtim preferencial në lidhje me ushtrimin e të drejtës të tubimit? A ka grupe/garues që përballen me kufizime të panevojshme?

Liria e shprehjes

- ✓ A janë garuesit të lirë të bëjnë fushatë pa asnjë lloj kufizimi të përmbajtjes së platformës apo mesazhit të fushatës?
- ✓ A u kërkohet garuesve të paraqesin materialet e fushatës për miratim tek ndonjë autoritet, përfshirë dhe organin e administrimit të zgjedhjeve?
- ✓ A janë të lirë qytetarët të diskutojnë çështjet publike dhe politike pa kufizime të panevojshme?
- ✓ A e kanë mundësinë votuesit të formojnë mendime në mënyrë të pavarur (pa dhunë apo kërcënim për dhunë, detyrim, shtytje apo ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji)?
- ✓ A u lejohet dhe a e kanë mundësinë qytetarët të shprehin mbështetje për secilin kandidat në zgjedhje, pa ndikim të panevojshëm apo shtrëngim të çfarëdo lloji, veçanërisht të tilla që mund të shtrembërojnë apo pengojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesit?
- ✓ A janë të lirë qytetarët të bëjnë fushatë për zgjedhjet? Gjatë zbatimit të ligjit në praktikë, a ka ndonjë kufizim të lirisë së shprehjes, asaj të formimit dhe mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve, që zvogëlon pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje?
- ✓ A ka pasur garues që të jenë përballur me sanksione në lidhje me përmbajtjen e fushatës dhe/ose materialeve të fushatës? A nxiste përmbajtja në fjalë urrejtje apo dhunë ndaj ndonjë grupi?
- ✓ A po e përmbush shteti pjesëmarrës detyrën për të ofruar mbrojtje ndaj nxitjes dhe gjuhës së urrejtjes (drejtuar grupeve)?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme?
- ✓ A u jep fushata votuesve, mjaftueshëm përmbajtje, në mënyrë që ata të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion?
- ✓ A ka grupe, veçanërisht prej atyre të papërfaqësuar mjaftueshëm dhe që shpesh përbëjnë segmentet më të cenueshme të shoqërisë, që përballen me trajtim/pengesa diskriminuese për të ushtruar lirinë e shprehjes ose të formimit dhe mosndryshimit të pavullnetshëm të mendimeve?

Liria e lëvizjes

- ✓ A janë të lirë dhe të aftë përfaqësuesit e partive dhe kandidatët të udhëtojnë dhe të takohen lirisht me votuesit?
- ✓ A janë të lirë dhe të aftë votuesit të lëvizin lirisht për të marrë pjesë në veprimtari fushate ose për t'u lidhur me garuesit apo me votuesit e tjerë?

E drejta e lirisë dhe sigurisë vetjake

- ✓ A janë garuesit apo mbështetësit e tyre objekt i dhunës, frikësimit apo ngacmimit? Nëse po, nga kush?
- ✓ A ka dispozita ligjore për imunitetin e garuesve gjatë periudhës së fushatës?
- ✓ A ka grupe që janë më të cenueshme nga abuzimet me të drejtën e lirisë dhe sigurisë?
- ✓ A i trajtojnë autoritetet shtetërore të gjitha grupet në mënyrë të barabartë?
- ✓ A është zbatimi i ligjit neutral?
- ✓ A ka garues apo mbështetës të tyre, që të jenë objekt i dhunës, frikësimit apo ngacmimit? Nëse po, nga kush?

Gjithëpërfshirja

- ✓ A gëzojnë gratë, pakicat kombëtare dhe pakicat e tjera, si dhe grupet e marginalizuara qasje të barabartë tek liritë themelore?
- ✓ A ka kufizime, me të cilat përballen grupet e papërfaqësuara mjaftueshëm, në lidhje me qasjen tek liritë themelore gjatë fushatës?
- ✓ A ekzistojnë mjete juridike të efektshme dhe a janë përdorur në mënyrë të suksesshme nga pakicat dhe nga grupet e marginalizuara?
- ✓ A janë proaktive autoritetet, në përpjekjet e tyre për të lehtësuar pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm në fushatë?
- ✓ A gëzojnë gratë, pakicat kombëtare dhe pakicat e tjera, si dhe grupet e cenueshme qasje të barabartë tek liritë themelore?
- ✓ A ka masa pozitive që u lejojnë personave me aftësi të kufizuara, të marrin pjesë në mënyrë të efektshme në procesin zgjedhor, përfshirë dhe qasjen ndaj informacioneve të fushatës si votues dhe mundësitë për t'iu qasur votuesve si kandidatë?

b. Klimë e paanshme dhe e lirë e fushatës

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar të garantojnë kushte të lira dhe të ndershme fushate. Përtej nevojës për respektimin e plotë të lirisë themelore, Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, i vitit 1990, përmban trajtim më të hollësishëm të mënyrës se si janë angazhuar shtetet pjesëmarrëse të garantojnë fushata të lira dhe të ndershme. Në të, shtetet janë angazhuar

të garantojnë se legjislacioni mundëson një mjedis ku garuesit të jenë të lirë të paraqesin kandidaturën, pa ndërhyrje të panevojshme dhe ku votuesit të jenë të aftë të bëjnë zgjedhje pa trysni apo shtytje.

Paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, parashikon se shtetet pjesëmarrëse do të “garantojnë që ligji dhe politika shtetërore të kontribuojnë që fushatat politike të lejohet të zhvillohen në një klimë të paanshme dhe të lirë, në të cilën as veprimet administrative dhe as dhuna apo kanosja të mos i pengojnë partitë dhe kandidatët të shprehin lirisht pikëpamjet dhe cilësitë e tyre, ose t’i pengojnë zgjedhësit që të informohen për to dhe t’i diskutojnë ato, apo ta hedhin votën e tyre pa frikën se mos ndëshkohen”.

Në thelb, për të mundësuar një “klimë të paanshme dhe të lirë”, legjislacioni duhet t’i mbrojtë garuesit dhe votuesit nga dhuna, frikësimi dhe shtrëngimi, që lidhen me zgjedhjet, përfshirë dhe përpjekjet për kërcënime apo rryshfetet. Ai duhet të mbrojtë gjithashtu votuesit, nga format e ndryshme të trysnisë së drejtpërdrejtë dhe asaj të tërthortë: jo vetëm për të dalë apo për të votuar për një garues të posaçëm, por dhe për të marrë pjesë në veprimtari të fushatës apo për të treguar mbështetje për një garues të caktuar. Arrestimet dhe ndalimet e kandidatëve ose mbështetësve, prishja e veprimtarive të fushatës, ndërhyrja e panevojshme e policisë (dhe, në disa raste, thjesht prania e organeve ligjzbatuese) ose shkatërrimi i materialeve të fushatës, mund të dëshmojnë për përpjekje për frikësimin e garuesve dhe mbështetësve të tyre. Organet ligjzbatuese duhet të sillen në mënyrë neutrale; kur vëzhgojnë dhe vlerësojnë veprimtaritë e fushatës, që nga tubimet e mëdha deri tek grumbullimet e vogla në qoshe të rrugëve, është e rëndësishme të shqyrtohet si përmasa e pranisë policore, ashtu edhe sjellja e policisë. Veprimet e drejtpërdrejta apo të tërthorta, që mund të ndikojnë tek numri i pjesëmarrësve në veprimtaritë e fushatave, duhet të vlerësohen kundrejt kuadrit ligjor dhe të pasqyrohen në pjesën e Mjedisit të Fushatës.

Standardi i “klimës së paanshme dhe të lirë” të fushatës nënkupton gjithashtu, që kandidatët, aktivistët e partisë dhe të fushatës, si dhe votuesit në përgjithësi, duhet të jenë të mbrojtur nga shkarkimi prej vendit të punës apo nga kërcënimet me vendin e punës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e disa grupeve të posaçme ose të cenueshme votuesish apo kandidatësh, të tillë: si studentë, punonjës të sektorit publik, anëtarë të forcave të armatosura, apo grupe të tjera shoqërore që mund të bëhen objekt i trysnisë politike.

Blerja e votës apo pretendimet për blerje të votës vazhdojnë të jenë tipar i fushatave zgjedhore në disa prej shteteve pjesëmarrëse. Kjo praktikë, shpesh, përkufizohet si ofrimi i parave, të mirave ose shërbimeve, apo premtimeve për të sipërpërmendurat, në këmbim të mbështetjes së votuesit. Në shumë raste, çështja e blerjes së votës lidhet drejtpërdrejtë me fshehtësinë e votës.

Blerja e votës mund të jetë shumë e vështirë për t'u diktuar dhe vëzhguar. Analisti Politik duhet të përcaktojë nëse ka ndalime ligjore kundër blerjes së votës dhe të gjurmojë të gjitha pretendimet e besueshme për blerje të votës, në përpjekje për kryqëzimin e informacioneve të ardhura prej burimeve të ndryshme, dhe të vlerësojë nëse për këto raste është bërë ankesë zyrtare. Ata duhet të evidentojnë gjithashtu se si po reagojnë autoritetet, nëse po reagojnë, ndaj këtyre pretendimeve. Autoritetet shtetërore kanë detyrimin të trajtojnë raportimet e besueshme për blerje të votës apo për ushtrimin e trysnisë mbi votuesit. Aty ku nuk ka përjasje proaktive, përhapja e pretendimeve mund të ulë besimin e publikut tek procesi. Siç trajtohet më shumë në vijim, VAGJ-të kanë rol shumë të rëndësishëm për vëzhgimin e këtyre rasteve, në zonat e tyre të vëzhgimit.

Përveç përdorimit të logjikës së “kulaçit e kërbacit” për shtytje dhe frikësim, ka edhe faktorë të tjerë që mund të formësojnë atmosferën e përgjithshme të fushatës. Retorikat shumë luftarake, siç janë rastet e gjuhës së urrejtjes apo gjuhës nacionaliste të skajshme, por edhe format e tjera agresive të “fushatës negative” mund të zbehin debatin dhe në fund të vështirësojnë aftësinë e votuesve për t'u familjarizuar me përmbajtjen e platformave të garuesve, në mënyrë që të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion. Në tërësi, gjuha që nxit dhunë dhe urrejtje duhet të jetë objekt i normimit në përputhje me parimet, standardet dhe angazhimet e pranuar ndërkom-bëtarisht. Shpeshherë është më e vështirë të trajtohen çështjet e retorikës populiste, besnikërisë së skajshme ndaj partisë ose polarizimit të skajshëm, të cilat mund të pengojnë diskutimin kuptimplotë ndërmjet garuesve dhe/ose mbështetësve të tyre, duke i bërë votuesit më pak të aftë të mësojnë rreth programeve dhe platformave të partive politike dhe kandidatëve në garë. Gjatë raportimit të këtyre rasteve, është gjithashtu e rëndësishme të mendohet për reagimin që ata ngjallin, si nga ana e shtetit që në disa rrethana ka detyrimin pozitiv për të vepruar, edhe nga ana e shoqërisë civile dhe qytetarëve, të cilët mund të tërhiqen.

Për hulumtim:

- ✓ A mundësojnë kuadri ligjor dhe ai rregullator, një klimë të paanshme dhe të lirë fushate për të gjithë garuesit?
- ✓ A përmban kuadri ligjor dhe ai rregullator, rregulla të mjaftueshme dhe të qarta, që synojnë të mundësojnë një mjedis fushate të paanshëm dhe të lirë?
- ✓ A e mbron në mënyrë të efektshme, kuadri ligjor dhe ai rregullator, lirinë e garuesve për t'iu qasur votuesve dhe për të përçuar mesazhet e tyre? A vlejnë rregullat për të gjithë periudhën e fushatës?
- ✓ A janë veprimet e shtetit të favorshme për një mjedis fushate të paanshëm dhe të lirë? A ka ndonjë veprim administrativ që i pengon partitë apo kandidatët të paraqesin lirisht pikëpamjet dhe/ose cilësitë e tyre?

- ✓ A ka ndonjë veprim administrativ që i pengon votuesit të marrin pjesë në fushatë, të mësojnë apo të diskutojnë pikëpamjet apo cilësimet e kandidatëve?
- ✓ A ka ligje penale (administrative ose ligje të tjera) që ndalojnë frikësimin ose shtrëngimin e votuesve? A zbatohen në praktikë në rastet e shkeljeve zgjedhore?
- ✓ A zbatohen në praktikë ligjet dhe rregullat e fushatave?
- ✓ A ka respektim të përgjithshëm të pluralizmit politik gjatë fushatës?
- ✓ A përballen garuesit me ndonjë kufizim të panevojshëm, qoftë me ligj apo në praktikë, për organizimin dhe/ose zhvillimin e fushatave?
- ✓ A ka ndonjë provë apo pretendim për dhunë, trysni, frikësim apo ngacmim të votuesve gjatë fushatës? Cilët janë faktorët që mund të ndihmojnë për të vlerësuar besueshmërinë e tyre? A hetohen menjëherë pretendimet?
- ✓ A ndalohen me ligj blerja e votave dhe format e tjera të papërshtatshme të ndikimit tek votuesit? A janë të përhapura pretendimet për blerje të votave ose për ndikime të tjera? A janë të besueshme? A hetohen menjëherë?
- ✓ A ka ndonjë grup votuesish, si për shembull punonjësit e sektorit publik, që i nënshtrohen trysnisë, kërcënimeve ose frikësimit, apo anasjelltas, ndonjë forme të shtytjes së panevojshme?
- ✓ Si reagojnë autoritetet ndaj pretendimeve për dhunë, trysni, frikësim ose ngacmim të votuesve? A kanë përjasje proaktive?
- ✓ A mbajnë përgjegjësi autorët e shkeljeve gjatë fushatës?
- ✓ A përbën fushata negative tipar të spikatur të zgjedhjeve? Çfarë natyre ka dhe si e ndikon aftësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të bazuara në informacion? A ka raste të nxitjes dhe/ose gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës?
- ✓ A po ndërmarrin autoritetet shtetërore ose aktorët e tjerë zgjedhorë, veprime për t'i kundërvënë nxitjes ose gjuhës së urrejtjes?
- ✓ A ekzistojnë kode të sjelljes (etikës) ndërmjet garuesve për të normuar sjelljen gjatë fushatës? Nëse po, çfarë statusi ligjor kanë? Kush e ka nënshkruar kodin e sjelljes? Cilave çështjeve u referohet?

c. Trajtimi i barabartë dhe barazia e mundësive

Duke njohur faktin se koncepti i ndershmërisë është thelbësor gjatë periudhave të zgjedhjeve dhe fushatës, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan me Dokumentin e Kopenhagenit, të vitit 1990, të ofrojnë mundësi të barabarta konkurrimi ndërmjet garuesve. Konkurrimi në zgjedhje kërkon fushë loje të barabartë. Kjo do të thotë që shteti është i detyruar të garantojë se garuesit trajtohen në mënyrë të barabartë, si me ligj edhe në praktikë, pavarësisht pikëpamjeve të tyre politike apo interesave që përfaqësojnë. Traktatet ndërkombëtare dhe rajonale ndalojnë diskriminimin dhe parashikojnë që të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Burimet interpretuese shtojnë se askush nuk duhet të pësojë diskriminim apo situatë të pafavorshme për arsye të kandidimit apo përkatësisë politike. Burimet nga

praktika e shteteve shtojnë se të gjithë garuesit politikë duhet të kenë të njëjtat mundësi për të paraqitur platformat apo programet tek votuesit, që do të thotë se atyre duhet t'u jepet e njëjta kohë për të bërë fushatë dhe duhet t'u nënshtrohen të njëjtave ligje dhe rregulla në lidhje me përdorimin e mjediseve publike për fushatë. Partitë politike, të krijuara rishtazi, duhet të kenë mundësinë të konkurrojnë në një terren të ndershëm kundrejt grupeve më të konsoliduara.

Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, parashikon se partitë dhe organizatat politike duhet të marrin “garancitë e nevojshme ligjore që të kenë mundësi të konkurrojnë me njëra-tjetrën, mbi bazën e **trajtimit të barabartë** përpara ligjit dhe nga autoritetet”.

Normimi i disa prej aspekteve të mëposhtme, në rrethana të caktuara, mund të çojë në trajtim të pabarabartë të garuesve:

- › Kërkesat që garuesit të paraqesin programet politike ose mesazhet e fushatës për shqyrtim nga autoritetet;
- › Kaktimi i OAZ-ve në rolin e organizatorit të veprimtarive të fushatës apo të menaxherit të programit të fushatës së garuesve; dhe
- › Rregullat e paqarta për përdorimin e hapësirave publike për veprimtaritë e fushatës apo për paraqitjen e materialeve.

Anasjelltas, në disa prej shteteve pjesëmarrëse, ka edhe shembuj të barazisë së detyruar, të tilla si: kërkesa që garuesit të përdorin tabela të mëdha, të ofruara nga shteti dhe me numër të barabartë për të gjithë, përmes të cilave partitë politike dhe kandidatët, praktikisht, nuk lejohen të hartojnë strategjitë e fushatës së tyre për t'i bërë thirrje votuesve në mënyrë të pavarur. Ndërsa kjo mund të duket si shenjë e një fushe të barabartë loje, kjo lloj barazie mund të jetë artificiale dhe të ketë efekt kundërveprues për konkurrencën e qenësishme.

Për hulumtim:

- ✓ A ka parashikime të mjaftueshme në kuadrin ligjor dhe në atë rregullator, për barazi të mundësive ndërmjet garuesve? A i mbrojnë ata në mënyrë të mjaftueshme, garuesit nga trajtimi i pabarabartë?
- ✓ A u takon të gjithë garuesve, e drejta e barabartë dhe pa diskriminim për mbrojtje nga ligji? A kanë të gjithë garuesit mundësi të barabarta për të bërë fushatë, si me ligj edhe në praktikë?
- ✓ A ka kufizime, me të cilat përballen disa parti politike apo kandidatët, të cilat cenojnë trajtimin e barabartë dhe/ose barazinë e mundësive? A janë këto pengesa të normuara me ligj apo të dala nga praktika?

- ✓ A përballen të gjithë garuesit me të njëjtat pengesa apo ka disa që janë më pak të favorizuar se të tjerët?
- ✓ Nëse ka, çfarë roli luan organi i administrimit të zgjedhjeve, në lidhje me lehtësimin e organizimit të veprimtarive të fushatës apo me paraqitjen e materialeve të fushatës?
- ✓ A ka ndreqje në kohë në rastet e shkeljeve të së drejtës së garuesve për trajtim të barabartë?
- ✓ A bëjnë autoritetet përpjekje proaktive për të garantuar trajtim të barabartë dhe barazi mundësisht ndërmjet garuesve?

d. Keqpërdorimi i burimeve administrative

Një nga çështjet që mund të ndikojë negativisht si ndershmërinë e fushatës zgjedhore, ashtu edhe trajtimin e barabartë dhe barazinë e mundësive për të gjithë garuesit, dhe që vëzhgohet shpesh në rajonin e OSBE-së, është përdorimi i papërshtatshëm i favoreve të postit ose keqpërdorimi i burimeve administrative. Ndërsa përparësia e papërshtatshme prej postit mund të ketë forma të ndryshme, ajo shfaqet kryesisht nëpërmjet keqpërdorimit të burimeve administrative, abuzimit me detyrën për qëllime të fushatës ose, në terma më të përgjithshëm, përdorimit të shumicës parlamentare për hartimin, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit, në interes të atyre që qeverisin. Dokumentet udhëzuese ndërkombëtare theksojnë se burimet publike materiale, financiare apo njerëzore nuk duhet të keqpërdoren në mbështetje apo kundër një apo më shumë partive politike apo kandidatëve. Kjo mund të përfshijë burimet buxhetore dhe financiare të autoriteteve shtetërore dhe të administratës vendore, mjediset dhe ambientet publike, punonjësit dhe automjetet publike, ose financimin e garuesve nga subjekte me pronësi apo kontroll të plotë ose të pjesshëm shtetëror. Në fund, ata porosisin që autoritetet shtetërore të mos shpallin apo të përdorin programe buxhetore ose projekte infrastrukture, të mos ofrojnë punësim në sektorin publik apo përfitime sociale, të mos rrisin rrogat e pensionet, shpesh në kushte të paqarta apo preferenciale, si mënyrë për të nxitur votuesit gjatë periudhës së fushatës apo pak përpara saj.²³

Për t'u mbrojtur nga kjo, ligji duhet të pohojë qartësisht që punonjësit publikë nuk mund të përfshihen në fushatë, në cilësinë e tyre zyrtare dhe se mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm jashtë orëve të punës. Gjithashtu, punonjësit publikë nuk duhet kurrë t'i nënshtrohen shtrëngimit ose shtytjes për të marrë pjesë në fushata dhe/ose për të bërë një zgjedhje të caktuar me votë (të votojnë apo të mos votojnë për ndonjë parti politike apo kandidat të caktuar). Ligji mund të ndalojë ose përndryshe të normojë shpalljen e projekteve me

²³ Për më shumë, shih "Udhëzues i Përbashkët i ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Keqpërdorimit të Burimeve Administrative gjatë Proceseve Zgjedhore".

peshë të madhe buxhetore, të tilla si: projekte zhvillimore madhore të infrastrukturës, gjatë periudhës së fushatës ose pas njoftimit të zgjedhjeve, për të parandaluar kështu keqpërdorimin e tyre për qëllime të fushatës. Si përfundim, ligji duhet të përmblajë procedura dhe ndëshkime për të shkurajuar shkelje të tilla zgjedhore.

Për të ruajtur gëzimin e barabartë të të drejtave dhe si mbrojtje nga përparësitë e papërshtatshme të postit, **paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, i vitit 1990**, parashikon “një ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike; veçanërisht, partitë politike nuk shkrihen me shtetin”.

Ajo që del prej praktikës së mirë ndërkombëtare, është që bartësit e posteve nuk mund të kërkojnë të përdorin favorët e postit zyrtar për të përfutur përparësi të padrejtë gjatë fushatave zgjedhore. Analisti Politik duhet të vlerësojë nëse bartësi i postit është duke përmbushur një rol institucional të nevojshëm dhe të pashmangshëm apo nëse lloji i shfaqjeve që lidhen me zgjedhjet, është abuzim me cilësinë zyrtare. Kjo nuk i përjashton kandidatët bartës të posteve të garojnë në zgjedhje dhe të bëjnë fushatë jashtë detyrave zyrtare apo orëve të punës dhe pa përdorur burime administrative. Duhet theksuar se jo çdo përparësi që rrjedh nga posti, detyrimisht bie ndesh me standardin që përshkruhet në paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990. Në terma praktikë, shumë forma të keqpërdorimit të burimeve apo të abuzimit me detyrën inkuadrohen si aspekte që ndikojnë tek fusha e barabartë e lojës, që përshkruhet në paragrafin 7.6. Në disa rrethana, mundësia e barabartë për garuesit mund të jetë angazhimi më i përshtatshëm për t’u përdorur.

Në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, nuk është e pazakontë që bartësit e posteve të përdorin ndërtesat publike për qëllim fushate, ndërsa garuesit e tjerë nuk përfitojnë privilegje të tilla. Kjo mund të vlejë edhe për vendosjen e reklamave të fushatës, si shiritat apo tabelat e mëdha, në pronë publike. Nga ana tjetër, edhe pse rregullat ndryshojnë përgjatë zonës së OSBE-së, në disa shtete pjesëmarrëse, bartësve të postit që synojnë tjetër mandat, mund t’u kërkohet të japin dorëheqje nga posti për të gjithë kohëzgjatjen e fushatës.

Në përpjekje për të frenuar përparësitë e papërshtatshme të pozitës dhe keqpërdorimin e saj për qëllim të rizgjedhjes, disa shtete pjesëmarrëse ndalojnë shpalljen e punëve publike madhore apo të programeve të ndihmës sociale, përgjatë një periudhe të caktuar përpara zgjedhjeve. Nuk është e pazakontë që bartësit e postit të paraqesin arritjet e tyre në detyrë si pjesë të fushatës zgjedhore, por fushatat e informimit publik, që paguhen nga buxheti i shtetit dhe që shpallen ose nisin ndërsa po zhvillohet fushata zgjedhore, në disa raste mund t’u mbivendosen dukshëm mesazheve të fushatës së garuesve, duke shkaktuar hutim tek votuesit për interes të bartësit/bartësve të postit.

Për hulumtim:

- A ka ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike, si me ligj edhe në praktikë?
- A ka dispozita ligjore që synojnë të zbusin ndikimin e përparësive të postit?
- A ka boshllëqe në ligj apo në rregullore, të cilat keqpërdoren nga partia apo kandidati në detyrë?
- A është i qartë ligji në lidhje me ndalimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore për fushatë?
- A ka legjislacion kundër korrupsionit, që mund të luajë rol për frenimin e rasteve të keqpërdorimit të burimeve publike apo të abuzimit me detyrën?
- A përmban kuadri ligjor ose ai rregullator, masa për mbrojtjen e punonjësve të sektorit publik nga trysnia apo ndikimi i papërshtatshëm?
- A përfiton fushata e ndonjë garuesi, burime shtetërore në mënyrë të padrejtë?
- A është fusha e lojës e barabartë për të gjithë garuesit? Nëse jo, cilët faktorë e bëjnë atë të jetë e pabarabartë?
- A zbatohen ligjet në fuqi? A hetohen dhe/ose ndëshkohen shkeljet?
- A janë ndëshkimet për keqpërdorimin e burimeve, mjaftueshëm shkurajuese?

e. Pjesëmarrja e grave, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara në fushatën zgjedhore

Siç vihet në dukje në nisje të Manualit, pjesë të posaçme të raporteve të ODIHR-it për zgjedhjet duhet të përmbajnë hollësi rreth pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm historikisht, në procesin zgjedhor. Këto grupe përfshijnë pakicat kombëtare, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Kur vlerësojnë Mjedisin e Fushatës, Analistët Politikë duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë dispozitave të kuadrove ligjore dhe rregullatore në lidhje me këto grupe që marginalizohen më shpesh, dhe të vlerësojnë kushtet për pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë e fushatës dhe përfshirjen e tyre më të madhe në zgjedhje. Ata duhet të pasqyrojnë gjithashtu, sjelljen e institucioneve përkatëse, përfshirë dhe organin e administrimit të zgjedhjeve dhe subjektet me mandat të posaçëm për të mbrojtur të drejtat e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm. Për këtë qëllim, Analisti Politik duhet të zhvillojë takime me përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

Analisti Politik ose Analisti i Pakicave Kombëtare, nëse është caktuar një i tillë, duhet të vlerësojë gjithashtu, nivelin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në fushatën zgjedhore. Ai/ajo duhet të shqyrtojë edhe nëse garuesit zgjedhorë, që përfaqësojnë pakicat kombëtare, kanë të njëjtat mundësi për të bërë fushatë si garuesit e tjerë. Disa prej aspekteve që analistët duhet të marrin parasysh gjatë vlerësimit, përfshijnë: nëse anëtarët

e pakicave kombëtare, qoftë si individë, edhe si grupe, gëzojnë qasje ndaj lirive themelore dhe të drejtave të njeriut gjatë periudhës së fushatës, edhe në zonat me përqendrim të madh të pakicave; nëse e kanë mundësinë të marrin pjesë pa pengesa në veprimtaritë e fushatës; nëse ata mund të përdorin mjediset e fushatës dhe të shfaqin materialet e fushatës sipas të njëjtave kushte si garuesit e tjerë; nëse mund të bëjnë fushatë në gjuhën e pakicës; dhe nëse ka ndonjë fushatë kundër pakicave, që zhvillohet nga garues apo grupe të tjera.²⁴

Në **paragrafët 30-39 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990**, shtetet pjesëmarrëse njohin se “çështjet në lidhje me pakicat kombëtare mund të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme vetëm në një kuadër politik demokratik” dhe se “respektimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, si pjesë e të drejtave të njeriut, të njohura universalisht, është faktor thelbësor për paqe, drejtësi, qëndrueshmëri dhe demokraci në shtetet pjesëmarrëse”. Dokumenti thekson gjithashtu se “Shtetet pjesëmarrëse respektojnë të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare për pjesëmarrje të efektshme në punët publike, përfshirë dhe pjesëmarrjen në punët që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e identitetit të këtyre pakicave”.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarive të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet është vëzhgimi dhe vlerësimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje. Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, Analisti Politik duhet të vlerësojë nëse personat me aftësi të kufizuara e kanë mundësinë të marrin informacione nga palët dhe nga kandidatët, si dhe të marrin pjesë në veprimtari të fushatës me qëllim që të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion. Vlerësimi duhet të përfshijë edhe shqyrtimin nëse kandidatët me aftësi të kufizuara kanë qenë në gjendje të bëjnë fushatë lirisht dhe nëse ata kanë mundësi të barabarta për të garuar në zgjedhje. Disa prej shembujve të praktikës së mirë në rajonin e OSBE-së përfshijnë materialet e krijuara nga shteti, që shpjegojnë dhe nxisin detyrimet ligjore të partive politike sipas KDPAK-së; përgatitjen e informacioneve të fushatës, në mënyrë të barabartë për të gjithë garuesit, posaçërisht për votuesit me aftësi të kufizuara dëgjimi ose shikimi; ose ofrimin e fondeve publike për të mbuluar kostot shtesë, me të cilat mund të përballen kandidatët me aftësi të kufizuara, të tilla si: transportin dhe interpretimin në gjuhën e shenjave.²⁵

Disa prej paragrafëve të përmendura më parë të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, kërkojnë prej shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së të sigurojnë

24 Për më shumë, shih Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin dhe Nxitjen e Pjesëmarrjes së Pakicave Kombëtare në Procesin Zgjedhor.

25 Për më shumë, shih Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin dhe Nxitjen e Pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në Zgjedhje dhe Udhëzuesin e ODIHR-it për Nxitjen e Pjesëmarrjes Politike të Personave me Aftësi të Kufizuara.

të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, në paragrafin 5.9 të Dokumentit, shtetet pjesëmarrëse kanë rënë dakord se “të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë, pa u diskriminuar, të mbrohen njëjloj nga ligji. Në këtë aspekt, ligji ndalon çdo diskriminim dhe për të gjithë njerëzit garanton mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi për çfarëdo shkak”.

Të gjithë shtetet pjesëmarrës së OSBE-së e njohin barazinë ndërmjet grave dhe burrave dhe janë angazhuar të nxisin mundësitë e barabarta për të çuar përpara pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha aspektet e jetës politike dhe publike. Niveli i përfshirjes së grave në fushatën zgjedhore mund të jetë tregues shumë i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm të natyrës demokratike të procesit zgjedhor. Në këtë kuadër, Analistët Politikë duhet të vlerësojnë pjesëmarrjen e grave në fushatë. Ata duhet të familjarizohen me kuadrot ekzistuese ligjore dhe rregullatore të fushatës, si dhe me politikat e brendshme të partive. Ata duhet të evidentojnë nëse këto dokumente parashikojnë masa të veçanta për të mbështetur pjesëmarrjen e grave, burime financiare dhe/ose kohë mediatike shtesë për gratë kandidatë apo për partitë me numër më të lartë të grave që garojnë në zgjedhje. Gjithashtu, ata duhet të vlerësojnë aftësinë e grave kandidatë për të bërë fushatë, duke parë edhe aspektet më pak të dukshme, si fondet dhe burimet që partitë politike kanë në dispozicion për gratë kandidatë.²⁶ Gjithashtu, Analisti Politik duhet të shqyrtojë nëse gratë marrin pjesë në mënyrë aktive në fushatë dhe si mund të vlerësohet kjo pjesëmarrje, mënyrat se si u drejtohen atyre garuesit dhe nevojat e tyre si votuese, si dhe nëse këto elemente përmenden apo trajtohen në materialet dhe mesazhet e fushatës.

Ndërsa **Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së**, i vitit 1990, përmban pjesën më të madhe të angazhimeve të posaçme në lidhje me zgjedhjet dhe me mosdiskriminimin, standardet parësore të OSBE-së për barazinë gjinore përfshihen në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, dhe në Dokumentin e Stambollit, të vitit 1991, në Kartën për Sigurinë Evropiane dhe në vendimet e Këshillit Ministror.

Analisti Politik duhet të përdorë të njëjtën përjasje për të gjitha grupet e papërfaqësuar mjaftueshëm: ai ose ajo duhet të vlerësojë nëse gratë po marrin pjesë në fushatë; shkallën në të cilën garuesit u drejtohen apo trajtojnë nevojat e tyre gjatë veprimtarive të fushatës dhe në materialet e fushatës; si dhe të përcaktojë se cilët janë faktorët që pengojnë pjesëmarrjen më të madhe të këtyre grupeve dhe se çfarë masash janë marrë, nëse ka, për të trajtuar këto mangësi. Pavarësisht përpjekjeve të dukshme nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së për të mbrojtur dhe nxitur pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuar mjaftueshëm

²⁶ Për më shumë, shih Manualin e ODIHR-it për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Gruas në Zgjedhje.

në jetën publike dhe politike, praktika tregon se përfaqësuesit e këtyre grupeve mbeten objekt i ngacmimit, frikësimit dhe shpesh edhe të dhunës. Grupet e papërfaqësuara mjaftueshëm janë bërë më të cenueshme me daljen e mediave të reja dhe rrjeteve sociale, të cilat janë kthyer në tejçuese të retorikës negative, agresive dhe të ndezur, që shpesh nxit urrejtjen dhe madje, edhe dhunën. Periudhat zgjedhore, shpesh, shoqërohen me nxitje më të madhe të urrejtjes në internet. Nevojiten përpjekje të mëtijshme nga të gjithë aktorët përkatës, përfshirë dhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, partitë politike dhe aktorët e tjerë zgjedhorë, për të mbrojtur dhe nxitur pjesëmarrjen e grupeve të cenueshme në zgjedhje, dhe i takon Analistit Politik të vlerësojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm gjatë zgjedhjeve.²⁷

Për hulumtim:

Të përgjithshme

- A përmban kuadri ligjor ose ai rregullator, dispozita për përfshirjen e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm në fushatë? A po zbatohen ato në mënyrë të kënaqshme?
- A ekzistojnë kushte që lejojnë përfshirjen e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm në fushatë?
- A po marrin pjesë në fushatë, në mënyrë aktive, grupet e papërfaqësuara mjaftueshëm? Me çfarë kufizimesh përballen ato?
- Nëse ndodh, në çfarë mase i drejtohen partitë politike votuesve dhe/ose nevojave të votuesve, që bëjnë pjesë tek grupet e papërfaqësuara mjaftueshëm?
- A ekzistojnë ndjenja negative ndaj ndonjë grupi të papërfaqësuar mjaftueshëm, që shprehen në fushatë?
- A tregohen autoritetet proaktive për eliminimin e vështirësive, me të cilat përballen garuesit apo votuesit nga grupet e papërfaqësuara mjaftueshëm?
- A ka ndonjë rast dhune, frikësimi ose ngacmimi – ose anasjelltas, shtytjeje – të grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm gjatë fushatës? A ka ndonjë shembull të retorikës së ndezur gjatë fushatës?
- A janë grupet e cenueshme, objekt i ngacmimeve në rrjetet sociale?
- A tregohen autoritetet proaktive për të lehtësuar pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm, në fushatë?

27 Për më shumë, shih Udhëzuesin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Fushatave Zgjedhore në Rrjetet Sociale.

- A tregohen autoritetet proaktive për trajtimin e rasteve të dhunës, frikësimit dhe ngacmimit, ose anasjelltas, të formave të papërshtatshme të shtytjes, ndaj grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm ose të cenueshme?

Pakicat kombëtare

- Në vendet ku ekzistojnë të tilla, a janë të lirë dhe a kanë mundësi garuesit ose votuesit të përdorin gjuhët e pakicave kombëtare gjatë fushatës?
- Në vendet ku ekzistojnë të tilla, a u flitet në gjuhën e tyre përkatëse, votuesve të pakicave kombëtare, gjatë fushatës?
- A ka në dispozicion fonde shtesë për të mbuluar kostot e përkthimit me shkrim ose me gojë në gjuhët e pakicave kombëtare për garuesit?
- A trajtohen votuesit e pakicave dhe/ose nevojat e tyre gjatë fushatës?
- A e kanë mundësinë votuesit e pakicave kombëtare të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion?

Personat me aftësi të kufizuara

- A e kanë mundësinë garuesit dhe votuesit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në fushatë? Cilat janë disa prej pengesave, me të cilat përballen kandidatët dhe votuesit me aftësi të kufizuara?
- A trajtohen votuesit me aftësi të kufizuara dhe/ose nevojat e tyre gjatë fushatës?
- A ka në dispozicion fonde shtesë për të ndihmuar sigurimin e fushës së barabartë të lojës për garuesit me aftësi të kufizuara? A ka fonde të tilla për të ndihmuar garuesit t'u qasen votuesve me aftësi të kufizuara?
- A e kanë mundësinë votuesit me aftësi të kufizuara të bëjnë zgjedhje të bazuara në informacion?

Pjesëmarrja e grave

- A marrin pjesë gratë në mënyrë aktive në fushatë, qoftë si garuese, ashtu edhe si votuese?
- Cilët janë faktorët që pengojnë pjesëmarrjen më të madhe të grave në fushatë?
- A ekzistojnë masa të veçanta që mbështesin përfshirjen e grave në fushatë?
- A ka burime në dispozicion, përfshirë financime shtetërore të fushatës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të ndihmuar përfshirjen e grave kandidate ose për të mundësuar kushte të barabarta loje?
- A ekziston ndonjë mekanizëm i brendshëm nxitës tek partitë politike për të përkrahur pjesëmarrjen e grave?
- A paraqiten gratë në fushatë? A i trajtojnë garuesit nevojat e tyre si votuese?

f. Elemente të tjera për t'u marrë parasysh

i. Kohëzgjatja e periudhës së fushatës

Një praktikë e mirë është që periudha e fushatës të përcaktohet me ligj ose me rregullore administrative, për t'u garantuar mundësi të barabarta të gjithë garuesve për të bërë fushatë dhe për të paraqitur kandidaturat lirisht dhe pa kufizime të panevojshme. Për të arritur një gjë të tillë, fushata zgjedhore duhet të ketë një pikënisje të përcaktuar, që vlen për të gjithë garuesit në mënyrë të barabartë. Kohëzgjatja e periudhës së fushatës duhet të jetë e mjaftueshme që partitë politike dhe kandidatët të hartojnë dhe të zbatojnë strategjitë e tyre të fushatës dhe t'i informojnë votuesit në mënyrë të efektshme në lidhje me platformat dhe programet.

Zhvillimet politike sugjerojnë se mund të vendosen kufizime të arsyeshme për disa veprimtari të caktuara gjatë periudhës së fushatës, të tilla si: ndalimi i fushatës menjëherë përpara ditës së votimit (e ashtuquajtura heshtje zgjedhore) për të lejuar mundësinë e reflektimit dhe për të mbrojtur të drejtën e votuesve për ta hedhur votën pa trysni të panevojshme. Në mënyrë të ngjashme, mund të ketë kufizime të botimit të sondazheve zgjedhore përpara votimit ose të rezultateve të sondazheve pas hedhjes së votës ndërsa nuk ka përfunduar ende procesi i votimit. Ndërsa këto kufizime mund të jenë të pranueshme në disa raste, ndalimet e mëdha të botimit të sondazheve ngrenë shqetësime në lidhje me respektimin e parimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës për të marrë dhe dhënë informacione.

Për hulumtim:

- A përcaktohet me ligj ose me rregullore të tjera, periudha zyrtare e fushatës? A respektohet ky hark kohor nga të gjithë garuesit ose nga palët e treta?
- A është i mjaftueshëm afati kohor zyrtar i caktuar për fushatën zgjedhore?
- A u jepen kohë dhe mundësi të barabarta garuesve për të konkurruar gjatë fushatës?
- Nëse ligji e parashikon, a i respektojnë rregullat e heshtjes zgjedhore të gjithë garuesit dhe palët e treta?

ii. Normimi i tepërt i fushatës

Në disa raste, normimi i tepërt i veprimtarive të fushatës mund të bjerë ndesh me germën dhe frymën e standardeve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Shembujt më të zakonshëm të mjedisit të fushatës që normohet me tepri, përfshijnë:

- Kriteret për të kërkuar leje për organizimin e veprimtarive të fushatës;
- Parashikimet për të njoftuar autoritetet, në mënyrë të paarsyeshme, shumë përpara organizimit të veprimtarisë;
- Ndalimin e bërjes së fushatës në zonat qendrore;
- Procedurat për miratimin e materialeve, mesazheve dhe sloganeve të fushatës apo të përmasës/formatit të tabelave dhe posterave; dhe
- Pengesat e tjera administrative, të cilat e rëndojnë në mënyrë të panevojshme organizimin dhe zhvillimin e një fushatë të efektshme, në mos e bëjnë të pamundur.

Pengesat më të tërthorta përfshijnë pengesa të pazakonta për të respektuar standardet e sigurisë për grumbullimet masive, kosto të larta për mbrojtje policore dhe për ekipet e pastrimit, ose masa të tjera të mundimshme, që rëndojnë aftësitë e garuesve, veçanërisht atyre me më pak burime, atyre që janë më të dobët nga pikëpamja e organizimit dhe partitë dhe kandidatët e opozitës.

Për hulumtim:

- Si normohet bërja e fushatës, qoftë me ligj, apo me akte të tjera, si ato që nxirren nga organi i administrimit të zgjedhjeve?
- A është niveli i normimit të fushatës i përshtatshëm për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike?
- A përballen garuesit me ndonjë kufizim të panevojshëm për organizimin ose zhvillimin e fushatave, që buron qoftë nga ligji, apo nga praktika?
- A garantojnë ligjet dhe rregulloret fushata të ndershme dhe a zbatohen në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme?
- A kanë rënë dakord vetë garuesit që të vetë-kufizojnë ligjërisht qasjen e tyre, për shembull, duke nënshkruar një kod të përbashkët të sjelljes ose me anë të mjeteve të tjera të shprehura?

iii. Zhvillimet paszgjedhore

Në raste të rralla, thirrjet apo veprimtaritë e garuesve zgjedhorë për t'iu qasur publikut shkojnë pas ditës së zgjedhjeve ose pas periudhës së parashikuar me ligj të fushatës. Kontekste të tilla duhet të pasqyrohen në pjesën e raporteve të ODIHR-it për zgjedhjet, që trajton Zhvillimet Paszgjedhore.

Përshkrimi dhe vlerësimi i këtyre veprimtarive është pjesë e kompetencave të Analistit Politik.

Veprimtari të tilla, shpesh, mund të jenë pjesë e protestave të garuesve ose votuesve, që shpeshherë u takojnë opozitës, si mënyrë për të shprehur pakënaqësinë me zhvillimin e procesit zgjedhor, ose me rezultatet e tij. Gjatë vlerësimit të zhvillimeve paszgjedhore, Analisti Politik duhet të marrë parasysh respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, aftësinë e aktorëve zgjedhorë (votuesve, garuesve, organizatave të shoqërisë civile) për të zhvilluar veprimtari publike dhe protesta, të evidentojë se cilat janë kërkesat dhe mesazhet kryesore gjatë veprimtarive paszgjedhore, nëse janë paqësore apo të dhunshme, dhe të përcaktojë rolin e autoriteteve, policisë apo ofruesve të shërbimit të sigurisë në këto veprimtari.

Për hulumtim:

- A respektohen liritë themelore dhe të drejtat e njeriut në periudhën paszgjedhore?
- A u lejohet garuesve zgjedhorë apo aktorëve të tjerë, të zhvillojnë veprimtari publike pas ditës së zgjedhjeve?
- Kush janë organizuesit kryesorë të këtyre veprimtarive?
- Cilat janë mesazhet kryesore, që dalin prej këtyre veprimtarive?
- Sa të mëdha dhe të përhapura janë këto veprimtari?
- A janë veprimtaritë paqësore apo të dhunshme? Sa të shpeshta janë rastet e dhunës?
- Cili është roli i policisë, i ofruesve të shërbimit të sigurisë apo i autoriteteve të tjera publike në këto veprimtari? A ka përdorim të tepruar të forcës nga ana e policisë apo e ofruesve të shërbimit të sigurisë?

2. Vlerësimi i zhvillimit të fushatës

Edhe pse disa informacione politike apo në lidhje me fushatën mund të sillen në vëmendje të analistëve të tjerë, që bëjnë pjesë në ekipin kryesor, Analisti Politik ka përgjegjësinë e kryesore për vlerësimin e fushatës zgjedhore. Përveç analizës së dokumenteve dhe shqyrtimit ligjor, Analisti Politik takohet zakonisht, me një numër dhe diapazon të madh aktorësh. Gjatë këtyre takimeve, ajo ose ai duhet të pyesë shprehimisht, nëse garuesit apo aktorët e tjerë zgjedhorë kanë ndonjë shqetësim në lidhje me ndonjë pjesë të kuadrit ligjor që mbulon fushatën, si dhe rreth zbatimit të ligjit, veçanërisht, për aspektet që nënvizohen në pjesët e mëparshme. Si pjesë e bashkëbisedimit, analisti duhet të diskutojë përvojën e garuesve me fushatën, deri në atë

moment, programet e garuesve apo temat, të cilat ata trajtojnë, si dhe metodat dhe strategjitë, që kanë planifikuar të përdorin.

Analistët Politikë ndërveprojnë me përfaqësues të partive politike dhe me kandidatë; në mënyrë që të ruajnë paanshmërinë, ata duhet gjithmonë t'i planifikojnë me kujdes takimet dhe të jenë të ndërgjegjshëm se si dhe kur dërgohen ftesat, duke u siguruar se dëgjojnë zërat e të gjithë spektrit politik. Ndërsa arritja e ekuilibrit të përkryer nuk mund të jetë gjithmonë e mundur, është e domosdoshme të synohet një përzierje përfaqësuese e bashkëfolësve dhe të kihen parasysh perceptimet e jashtme për misionin dhe për mënyrën se si ky i kryen punët, si dhe me kë takohet.

Analistët Politikë duhet të kryqëzojnë gjetjet prej takimeve me garuesit. Një prej mënyrave për ta bërë një gjë të tillë, është të krahasojnë informacionet e marra nga shkëmbimet me bashkëfolësit e tjerë. Për shembull, grupet vendore të mendimit ose ekspertët e politikave mund të ofrojnë më shumë kontekst për të kuptuar disa ngjarje apo zhvillime të posaçme. Grupet e shoqërisë civile dhe shoqatat rajonale ose vendore mund të jenë burime të mira informacioni ose njohurish të specializuara për fushën e tyre të veprimtarisë. Përfaqësuesit e komunitetit diplomatik, të cilët vetë nuk janë aktorë aktivë në procesin zgjedhor, mund të ofrojnë informacione, të cilave bashkëfolësit vendas nuk u kushtojnë vëmendje ose nuk duan t'i japin. Analistët Politikë duhet të vlerësojnë me kujdes, pikëpamjet e ndryshme nga një mori bashkëfolësish, përpara se të bëjnë vlerësimin e tyre.

Gjatë zgjedhjes së bashkëfolësve dhe përgatitjes për takime, është e dobishme që Analisti Politik të bisedojë me asistentin, i cili duhet ta njohë mirë politikën dhe zhvillimet e fundit në vend. Kolegët vendas mund të ndihmojnë shumë me informacione të dobishme të sfondit politik, përpara çdo takimi. Ata janë të pranishëm rregullisht gjatë takimeve, shpesh duke shërbyer si përkthyes ,në rast të pengesave gjuhësore. Është e rëndësishme të zhvillohet një marrëdhënie e mirë pune me asistentin: Analistët Politikë duhet t'i bëjnë të qarta pritshmëritë e tyre, qëllimet dhe mënyrat e parapëlqyera të punës, për të mundësuar bashkëpunim të mirë dhe, për pasojë, vëzhgim më të frytshëm, grumbullim informacioni dhe analiza. Ata duhet të theksojnë gjithashtu, se paanësia e misionit do të gjykohet edhe në bazë të sjelljes së të gjithë anëtarëve të tij, në takimet me bashkëfolësit.

Është po aq e rëndësishme të mbahet mend se qytetarët, të cilët janë në mënyrë të pashmangshme grupe të drejtpërdrejta interesi në zgjedhje, mundet që jo gjithmonë ta ruajnë neutralitetin apo të mos perceptohen gjithmonë si neutralë, veçanërisht kur përballen me çështje ndasish politike. Të gjithë anëtarët e misionit duhet të veprojnë në përputhje me Kodin e Sjelljes, por për arsye të ekspozimit të tyre ndaj aktorëve politikë, Analisti Politik dhe

kolegu/kolegia vendas/vendase duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë për të ruajtur paanshmërinë.

a. Takimet me garuesit zgjedhorë

Analisti Politik duhet të takohet me sa më shumë parti politike dhe kandidatë që të jetë e mundur. Edhe nëse nuk është e mundur të takohen të gjithë aktorët kryesorë, Analisti Politik duhet të përpiqet të caktojë takime me kampionin më përfaqësues të aktorëve politikë dhe garuesve: me ata që janë pjesë apo që mbështesin qeverinë dhe me ata të opozitës; si dhe me kandidatë të emëruar nga formacionet e pranishme në parlament dhe me ata që nuk gëzojnë përfaqësim në parlament.

Në të njëjtën mënyrë, Analisti Politik duhet të takohet me grupet politike, që nuk kanë emëruar kandidatë, ndër të tjera, për të kuptuar arsyet e vendimit të tyre dhe për të vlerësuar nëse ka ndonjë kufizim të panevojshëm me ligj ose në praktikë. Po njësoj, kur refuzimi për regjistrimin e kandidatëve është kthyer në problem, mund të jetë e nevojshme të takohen individët e prekur ose përfaqësuesit e tyre, nëse të parët nuk janë të disponueshëm (p.sh.: sepse janë larguar apo burgosur), për të vlerësuar nëse iu është shkelur e drejta për të garuar.

Ndërsa ja vlen të takohen partitë më të mëdha dhe aktorët politikë më të dukshëm, nuk është më pak e rëndësishme të gjendet kohë për të folur me aktorët dytësorë, për të dëgjuar shqetësimet dhe pikëpamjet e tyre rreth procesit, përfshirë dhe ato në lidhje me mundësitë që ata të garojnë në terren të barabartë. Edhe pse qëndrimi në kryeqytet mund të shfaqë vështirësi logjistike për t'u takuar me aktorët rajonalë, është e dobishme të dëgjohen drejtpërsëdrejti zërat nga pjesët e tjera të vendit, dhe jo vetëm me anë të VAGJ-ve. Kjo vlen veçanërisht për ato shtete pjesëmarrëse, ku ka identitete rajonale të theksuara apo sisteme politike, ndjeshëm, më pak të zhvilluara. Prandaj, përveç kohës që i kushtohet takimeve dhe analizave, Analisti Politik duhet të llogarisë kohë të posaçme për udhëtime. Është po aq e rëndësishme që Analisti Politik të përpiqet të takohet me përfaqësues të grupeve të marxhinalizuara, përfshirë dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare, apo grupe të tjera, potencialisht të pafavorizuara, përfshirë dhe ato jashtë kryeqytetit.

Analisti Politik, shpesh, shoqëron Kryetarin e Misionit, gjatë takimeve me bashkëfolësit politikë kryesorë apo me kandidatët dhe duhet të planifikojë kohën për ta informuar atë në mënyrë të përshtatshme, përpara këtyre takimeve. Një praktikë e mirë është që takimet me bashkëfolësit të zhvillohen në mjediset e tyre. Në vend që të grumbullojë informacione vetëm me anë të intervistave, Analisti Politik duhet

të përpiqet të vëzhgojë vetë disa prej aspekteve të punës së përditshme të partive politike dhe të organizatave të tjera të rëndësishme, gjatë pikut të fushatës zgjedhore. Përshtypjet e drejtpërdrejta mund të japin kontribut të paçmueshëm për analizimin e mjedisit të fushatës, duke i shtuar vëzhgimeve nuanca dhe duke ofruar një nivel të hollësive faktike, që mund të mos dalin në pah vetëm nga bisedat. Analisti Politik duhet të jetë i aftë t'i kontrollojë takimet, por jo "t'i drejtojë", në mënyrë që të mos jetë thjesht duke theksuar mendimet fillestare. Më e mira është të studiohen informacionet bazë të sfondit politik si për organizatën, ashtu edhe për vetë bashkëfolësit. Pyetjet duhet të jenë të hartuara paraprakisht, por jo të lexohen gjatë takimit, për të mundësuar në këtë mënyrë, një rrjedhë më të natyrshme të bashkëbisedimit. Një praktikë e mirë është përgatitja e temave rezervë. Është e rëndësishme të kihet zhdërvjelltësi dhe të përshtaten pritshmëritë gjatë takimit. Analistët Politikë duhet të jenë të përgatitur të heqin disa pyetje kur nuk ka shumë kohë në dispozicion dhe të kërkojnë kontakte për të sqaruar çdo pikëpyetje në të ardhmen, apo për të ndjekur çështjet më të rëndësishme. Mund të ndodhë që analistëve t'u duhet të kërkojnë takime me përfaqësuesit teknikë, për të plotësuar boshllëqet e informacionit.

i. Temat e fushatës

Përgjithësisht, shumë prej pyetjeve për hulumtim, në pjesët e mësipërme, udhëheqin takimet e Analistëve Politikë me garuesit. Përtej këtyre, është e rëndësishme të trajtohet gjithashtu, tema e platformave të fushatës së garuesve. Ndërsa shumë parti politike dhe kandidatë mund të përqendrohen tek një diapazon i ngushtë çështjesh që janë më të rrahura me votuesit, shpesh, fushatat zgjedhore mbizotërohen nga disa tema. Duke qenë se ato shërbejnë si sfond për zgjedhjet, disa prej këtyre temave mund të jenë pasqyruar paraprakisht në pjesën e Kontekstit Politik, veçanërisht nëse rëndësia e tyre shkon përtej zgjedhjeve. Këto mund të përfshijnë çështjet e korrupsionit sistematik, reformat sociale madhore, tezat e politikës së jashtme të vendit, luftën dhe konfliktet e tjera të brendshme ose të jashtme.

Pjesa e Mjedisit të Fushatës duhet të radhisë disa prej temave, të cilat garuesit i bëjnë pjesë të fushatës dhe, anasjelltas, edhe të pasqyrojnë rastet kur ata mund të marginalizojnë apo të mos përmendin tema të caktuara. Gjatë vlerësimit të fushatës, Analisti Politik duhet të synojë të lidhë në mënyrë analitike kontekstin parazgjedhor me temat që dalin më shumë në pah gjatë fushatës. Mund të jetë e rëndësishme që të tregohet edhe nëse ka mungesë të debatit për çështje të caktuara, që mbizotërojnë jetën politike, mungesë që mund të ndodhë prej dobësisë së opozitës apo prej strategjive të fushatës.

Një fushatë e lirë dhe qenësisht pluraliste përfshin domosdoshmërisht, shumë mendime të ndryshme për politikat që propozohen për ndonjë temë të caktuar, veçanërisht, për temat me rëndësi kombëtare. Debatit i gjallë dhe pluralizmi i pikëpamjeve janë përbërës të nevojshëm të një fushate zgjedhore

konkurruese. Përveç se të bazohet tek përgjigjet e bashkëfolësve dhe tek vëzhgimet e VAGJ-së, Analisti Politik duhet të ndjekë edhe temat që diskutohen në media dhe në rrjetet sociale. Kjo është shumë e rëndësishme për të evidentuar çështjet që mbizotërojnë zgjedhjet dhe motivojnë votuesit dhe, çka është thelbësore, për të vlerësuar nëse votuesit e kanë pasur mundësinë për të bërë zgjedhje të bazuar në informacion.

ii. Metodat e fushatës

Përveç fushatës në media, garuesit, në pjesën më të madhe të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, përgjithësisht, bazohen tek dy metoda tradicionale për t'iu qasur votuesve gjatë zgjedhjeve: tek shfaqjet e mjeteve pamore gjatë fushatës (tabela të mëdha, shirita, postera dhe fletëpalosje etj.) dhe tek takimet me votuesit (tubime, grumbullime të vogla, grumbullime në vend, kioskat e fushatës, vizita derë më derë etj.). Këto mjete plotësohen ndonjëherë me fushata marketingu televiziv, me dërgesa letrash me postë ose me SMS. Kohët e fundit, veprimtaria e fushatave ka shkuar gjithnjë e më shumë drejt përdorimit të internetit, qoftë në variantet në internet të medive të shkruara apo transmetuese, apo në mediat e reja, që gjenden vetëm në internet. Në mënyrë të ngjashme, rrjetet sociale, tashmë, luajnë një rol madhor në fushatat zgjedhore. Analisti Politik duhet të përpiqet të kuptojë mirë metodat që përdorin garuesit për të zhvilluar fushatën dhe përse zgjidhen disa metoda, në vend të disa të tjerave. Për arsye të mbizotërimit në rritje të fushatës në rrjetet sociale, ODIHR-i ka botuar një udhëzues të veçantë për vlerësimin e kësaj teme në lidhje me veprimtaritë e zgjedhjeve.

Gjatë takimeve me garuesit zgjedhorë, Analisti Politik duhet të hetojë lirinë e tyre për të shfaqur mjete pamore gjatë fushatës, si dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me barazinë e mundësive për partitë politike dhe kandidatët që garojnë në zgjedhje. Analisti duhet të përpiqet të përcaktojë nëse garuesit kanë ndonjë shqetësim në lidhje me caktimin e hapësirave për afishimin apo shpërndarjen e materialeve të fushatës; nëse ata përballen me ndonjë kufizim gjatë zhvillimit të veprimtarive apo gjatë shpërndarjes së materialeve; dhe nëse çmimet për shfaqjen e tabelave të mëdha, shiritave, posterave apo mjeteve të tjera pamore përbëjnë informacion publik dhe nëse janë të barabarta për të gjithë garuesit. Ata duhet të shqyrtojnë nëse kërkohen informacione në lidhje me sponsorizuesin e reklamave dhe me sasinë, dhe nëse kjo kërkesë zbatohet universalisht në praktikë. Ky vlerësim duhet të zhvillohet krahas gjetjeve nga vëzhgimet rajonale të VAGJ-ve. Këto aspekte trajtohen me hollësi në Kapitullin IV.

Në mënyrë të ngjashme, Analisti Politik duhet të përcaktojë se cilat janë rregullat në fuqi për zhvillimin e takimeve me votuesit, qoftë për veprimtari të vogla, apo të mëdha. Analisti Politik duhet të zbulojë nëse kandidatët

përballen me kufizime të panevojshme për organizimin apo zhvillimin e veprimtarive. Analisti duhet të shqyrtojë gjithashtu, nëse garuesit gëzojnë një qasje të barabartë në hapësirat dhe mjediset publike; nëse procedurat e njoftimit për veprimtaritë e fushatës janë të thjeshta, transparente dhe të ndershme; dhe nëse organet ligjzbatuese dhe ofruesit e tjerë të sigurisë sillen në mënyrë të paanshme me të gjithë kandidatët. Edhe në këtë rast, vlerësimi duhet të bazohet në pjesën më të madhe të tij, tek gjetjet prej vëzhgimit të VAGJ-ve në të gjithë vendin.

b. Takimet me aktorët e tjerë

i. Organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe komuniteti akademik

Analistët Politikë duhet të synojnë të takohen me një diapazon të gjerë ekspertësh, të cilët mund t'u zgjerojnë botëkuptimin dhe t'u ofrojnë informacione empirike të reja rreth mjedisit politik dhe atij të fushatës. Ndërsa është e rëndësishme të përcaktohet nëse këta bashkëfolës janë të lidhur ose të anuar ndaj ndonjë aktori politik të caktuar, disa prej tyre kanë gjasa të jenë më neutralë dhe mund të ofrojnë interpretime me më shumë nuanca dhe informacione të fakteve apo ngjarjeve. Në kontekstet ku zërat kundërshtues ka më pak gjasa të tolerohen, mund të jetë e nevojshme të kërkohen bashkëfolës jashtë institucioneve kryesore për të marrë vlerësime më neutrale/të paanshme.

Gjatë përzgjedhjes së bashkëfolësve, për të evidentuar institucionet dhe personalitetet më të përshtatshme, shpesh ia vlen të merren këshilla nga persona që janë më të familjarizuar me vendin. Universitetet kryesore dhe institutet kërkimore janë një pikënisje e mirë. Grupet e mendimit dhe qendrat e analizës së politikave mund të ofrojnë kontakte dhe informacione të mëtejshme në lidhje me çështje të caktuara. Është e rëndësishme të vlerësohet nëse bashkëfolësit në fjalë janë të pavarur apo, veçanërisht nëse bazohen tek mbështetja e shtetit, janë më pak të lirë të shprehin pikëpamje kritike. Në kontekstet ku organizatat e shoqërisë civile janë të ndara në kahe ideologjike, është e rëndësishme të ekzistojë një ekuilibër i pikëpamjeve për të kuptuar më mirë mjedisin e përgjithshëm.

Një prej burimeve të rëndësishme të informacionit rreth situatës politike të përgjithshme në vend, por edhe posaçërisht rreth mjedisit të zgjedhjeve dhe të fushatës, janë përfaqësuesit e “sektorit të tretë”, ose organizatat vendase të shoqërisë civile. Analisti Politik duhet të takohet me organizatat për të drejtat e njeriut dhe me grupet që veprojnë në fushën e zgjedhjeve, përfshirë dhe qytetarët që vëzhgojnë zgjedhjet, shpesh së bashku me Analistin

e Zgjedhjeve apo atë Ligjor. Në fund, institucionet që përfaqësojnë interesin e grupeve të papërfaqësuara mjaftueshëm apo të marginalizuara, të tillë si: gratë, pakicat kombëtare, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë, mund të përbëjnë burim shumë të rëndësishëm për të mësuar shqetësimet për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje dhe, më gjerësisht, në jetën politike.

Një element i rëndësishëm që duhet theksuar, është se, në disa kontekste, ka grupe që zyrtarisht e quajnë veten organizata joqeveritare ose organizata për interes publik, por që, në fakt, mund të jenë të themeluara dhe të financuara nga shteti. Disa prej këtyre subjekteve mundet që të mos përfaqësojnë domosdoshmërisht zërat e pavarur. Ky është dallim shumë i rëndësishëm, por megjithatë nuk duhet ta shkurajojë Analistin Politik të ketë shkëmbime me përfaqësuesit e këtyre organizatave: këto takime, shpesh, mund të ndihmojnë arritjen e përfundimeve në lidhje me mënyrën se si përdoren burimet shtetërore në interes të bartësve të postit. Analistët duhet të shqyrtojnë gjithmonë se si ndikon financimi në paanshmëritë dhe pikëpamjet e organizatave të ndryshme për zgjedhjet.

ii. Komuniteti ndërkombëtar

Veprimtaritë e ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet ruajnë kontakt të rregullt me komunitetin diplomatik, edhe me anë të “takimeve informuese me ambasadat” për përfaqësuesit e misioneve të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në vendin pritës. Përtej kësaj, Analisti Politik, shpesh, shoqëron Kryetarin e Misionit në takimet me bashkëfolësit e komunitetit ndërkombëtar në vend. Një praktikë e mirë është që Analisti Politik të krijojë kontakte të drejtpërdrejta dhe të bëjë takime të veçuara me personelin e komunitetit ndërkombëtar në vend. Në lidhje me misionet shumëpalëshe, një prej organizatave, me të cilat është e kuptueshme të fillohet ky proces, është prania (e përhershme) e OSBE-së, nëse ka një të tillë në shtetin pjesëmarrës. Gjithashtu, OKB-ja dhe disa agjenci të OKB-së, siç është Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) ose UN Women, mund të jenë burim i mirë informacioni për politikën vendase, përfshirë zgjedhjet. Disa prej këtyre organizatave, shpesh, janë të përfshira drejtpërsëdrejti në programe që synojnë të çojnë përpara qeverisjen e mirë dhe pjesëmarrjen në politikë.

Bashkëbiseduesit e tjerë mund të jenë Këshilli i Evropës, KSHP-ja ose Banka Botërore, si dhe forumet e tjera më të vogla. E fundit, por jo nga rëndësia, organizatat joqeveritare ndërkombëtare, përfshirë ato që veprojnë në fushën e mbështetjes dhe vëzhgimit zgjedhor, por edhe organet e tjera me

natyrë më politike ose sociale, si fondacionet politike, mund të jenë burime të dobishme informacioni.

Është e rëndësishme të theksohet se aktorët ndërkombëtarë nuk janë grupe interesi të drejtpërdrejta në procesin zgjedhor. Në të njëjtën kohë, ata përfaqësojnë interesin e vendit të tyre dhe prandaj pikëpamjet e tyre nuk duhet të merren për të mirëqena. Si në të gjitha rastet e tjera, është e rëndësishme që Analisti Politik të kryqëzojë gjetjet, me synim që të verifikojë informacionet dhe të ekuilibrojë vlerësimet e ngjarjeve ose zhvillimeve të caktuara.



KAPITULLI IV

GJETJET E VAGJ-VE

1. Roli i Koordinatorit të VAGJ-ve për vëzhgimin e fushatës zgjedhore

Metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve bazohet tek gjetjet kolektive të të gjithë misionit dhe jo tek vlerësimet individuale, pavarësisht nëse këto të fundit vijnë prej një analisti apo prej ekipit të VAGJ-ve. Mbulimi afatgjatë dhe rajonal, i përcaktuar nga misionet e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve gjatë proceseve zgjedhore, lejon që misionet të pozicionohen mirë për të vëzhguar tendencat në të gjithë vendin dhe t'i bëjnë ato pjesë të vlerësimit të përgjithshëm.

Si pjesë e ekipit kryesor, me qendër në kryeqytet, Koordinatorin e VAGJ-ve, së bashku me analistët e ndryshëm, përpiqet të grumbullojë informacione në mënyrë sistematike për të njëjtën lëndë nga VAGJ-të e pozicionuar në të gjithë vendin, përfshirë dhe informacionet për zhvillimin e fushatës. Sasia e madhe e informacionit për të njëjtën temë, nxjerr në pah modelet sistematike, të cilat krijojnë bazën e analizës, vlerësimit, përfundimeve dhe rekomandimeve të misionit.

Koordinatorin e VAGJ-ve luan rol thelbësor për konsolidimin e gjetjeve rajonale në lidhje me fushatën zgjedhore. Si ndërlidhës ndërmjet VAGJ-ve dhe ekipit kryesor, të gjitha komunikimet kalojnë nëpërmjet Koordinatorit të VAGJ-ve, i cili sigurohet që të integrohen dhe të transmetohen në mënyrë të efektshme informacionet, përditësimet dhe sqarimet përkatëse ndaj dhe nga VAGJ-të. Në praktikë, kjo do të thotë se Koordinatorin e VAGJ-ve manovron ndërmjet çështjeve përmbajtësore dhe atyre operacionale. Ky kapitull përqendrohet shprehimisht tek aspektet e punës së Koordinatorit të VAGJ-ve dhe ofron udhëzime praktike për Koordinatorin e VAGJ-ve dhe për Analistin Politik, për vëzhgimin e fushatës zgjedhore.

Për të ndihmuar në mënyrë të efektshme Analistin Politik të kuptojë zhvillimin dhe përmbajtjen e fushatës në nivelin rajonal, Koordinatorin e VAGJ-ve duhet:

- Të mbajë lidhje të rregullta me Analistin Politik për të grumbulluar përditësime ose informacione që u vlejné VAGJ-ve. Në të njëjtën mënyrë, Analisti Politik duhet t'i qaset në mënyrë proaktive Koordinatorit të VAGJ-ve, për ta njoftuar në lidhje me çështjet që u vlejné VAGJ-ve;
- T'i tërheqë vëmendjen Analistit Politik tek modelet që zhvillohen në rajone të posaçme, për shembull, një shkelje potenciale e angazhimeve, refuzim të qasjes (p.sh.: në vendet ku zhvillohet fushatë), apo fushatë njollosjeje ndaj një kandidati të caktuar; dhe të diskutojë mundësitë e ndjekjes së këtyre çështjeve nga VAGJ-ja;
- Të grumbullojë informacionet që kanë të bëjnë me njoftimin informues ditor (që u dërgohet të gjitha ekipeve të VAGJ-ve gjashtë herë në javë);
- Të diskutojë dhe të bjerë dakord me Analistin Politik, për disa pika për hulumtim dhe për përparësitë e vëzhgimit në periudhën e ardhshme; dhe
- Të bashkëpunojë me Analistin Politik dhe me Zëvendëskryetarin e Misionit për përgatitjen e raporteve të misionit, për t'u siguruar se gjetjet rajonale pasqyrohen në mënyrë të saktë dhe për të mbështetur vlerësimin e përgjithshëm të misionit.

2. Komunikimi me VAGJ-të

Me të marrë çdo lloj raportimi nga VAGJ-të, qoftë për vëzhgimin e një tubimi apo për një shkelle të rregulloreve të fushatës, Koordinatori i VAGJ-ve duhet të përcaktojë së pari, vlerën e vëzhgimit. Kjo përfshin përcaktimin nëse janë përmbushur parimet bazë të metodologjisë së ODIHR-it për vëzhgimet. Procesi i plotë i shqyrtimit nga Koordinatori i VAGJ-ve përfshin hapat e mëposhtme:

- Kontrollin nëse raporti trajton pyetjet bazë: ku, kur, kush, çfarë, pse dhe, nëse ka vlerë, sa shpesh është bërë vëzhgimi;
- Sqarimin e informacioneve që mund të mos jenë të qarta, për lexuesit që nuk e njohin kontekstin rajonal;
- Shqyrtimin e nevojës për të marrë informacione nga burime të tjera, të ndryshme nga ato që ka takuar deri në atë moment ekipi i VAGJ-ve; dhe
- Shqyrtimin e vlerësimit të ekipit të VAGJ-ve kundrejt fakteve dhe analizave të paraqitura dhe, nëse është e nevojshme, diskutimin e mëtejshëm me ekipin e VAGJ-ve.

Koordinatori i VAGJ-ve merr raporte me bollëk, që mbulojnë një diapazon të gjerë çështjesh që lidhen me fushatën, të cilat janë hartuar prej shumë ekupeve të VAGJ-ve. Informacioni duhet organizuar, strukturuar dhe integruar në mënyrë koherente dhe sistematike, në mënyrë që të jetë i lehtë për t'u përdorur nga Analisti Politik dhe nga anëtarët e tjerë të misionit. Për disa lloje të caktuara të informacioneve, Koordinatori i VAGJ-ve duhet të synojë të nxjerrë, bashkojë dhe të ruajë informacionet kryesore, të marra nga raporte të ndryshme të VAGJ-ve, në regjistra apo në baza të dhënash, që zakonisht zhvillohen bashkërisht me Analistin Politik (trajtohet më tej në vijim).

Duke qenë në majë të zinxhirit të komunikimit – dhe në bazë të informacioneve të grumbulluara nga ekupe të ndryshme të VAGJ-ve, si dhe nga Analisti Politik – Koordinatori i VAGJ-ve ka pozicionin më të mirë për t'u ofruar VAGJ-ve, udhëzime të efektshme për vëzhgimin që ata i bëjnë fushatës. Caktimi i detyrave dhe ofrimi i udhëzimeve janë thelbësore për të pasur vëzhgim sistematik dhe të plotë. Vëzhgimi është sistematik dhe i plotë, kur përmban informacione për të njëjtën lëndë nga sa më shumë rajone që është e mundur, për një periudhë raportimi të caktuar. Një gjë e tillë lejon bërjen e krahasimeve rajonale, çka hedh dritë mbi modelet/tendencat dhe elementet e tjerë të jashtëm.

Në lidhje me zhvillimin e fushatës zgjedhore, VAGJ-të, zakonisht, kërkojnë udhëzime apo sqarime nga ekipi kryesor për: ndalimet për keqpërdorimin e burimeve shtetërore për qëllim fushate; çfarë informacionesh mund të përdoren në raportet e misionit; anasjelltas, pse disa prej gjetjeve nuk mund të bëhen pjesë e raporteve; si të veprohet me një garues zgjedhor që refuzon sistematikisht të takohet me ekipin; si të vlerësohet besueshmëria e një burimi; ku mbaron vëzhgimi dhe ku nis ndërhyrja; dhe çfarë veprimesh mund të ndërmarrë ekipi për të provuar pretendimet për praktika që bien ndesh me standardet ndërkombëtare dhe/ose shkeljen e rregulloreve vendase të fushatave.

Në këtë kuadër, Koordinatorin e VAGJ-ve duhet:

- Të mbështesë VAGJ-të, përgjatë tërë periudhës së vëzhgimit, për t'u siguruar se zbatohet me qëndrueshmëri, metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin – që do të thotë që vëzhgimet dhe vlerësimet e fushatave zgjedhore të mund t'i kalojnë shqyrtimet e brendshme apo të jashtme;
- Të sigurohet që VAGJ-të të kenë sasi të përshtatshme informacioni të nevojshëm për bërjen e punës;
- Të informojë VAGJ-të për përparësitë e vëzhgimeve në javët e ardhshme;
- Të vendosë përparësitë dhe të caktojë detyra të posaçme në bazë të diskutimeve me Analistin Politik; dhe
- T'u përgjigjet pyetjeve të VAGJ-ve nëpërmjet kanaleve zyrtare ose jozyrtare të komunikimit.

3. Caktimi i detyrave dhe udhëzimi i VAGJ-ve

Mbikëqyrja që Koordinatorin e VAGJ-ve u bën të gjitha veprimtarive të VAGJ-ve, si në lidhje me përmbajtjen, ashtu edhe me aspektet operacionale, e bën atë të ketë pozicionin më të mirë për t'u siguruar që kërkesat për informacion nga analistët e misionit, të jenë të arsyeshme, të integruara dhe të ndihmojnë përdorimin optimal të burimeve të fundme. Prandaj, Koordinatorin e VAGJ-ve duhet të filtrojë dhe t'u caktojë përparësi, kërkesave në bazë të diskutimeve me të gjithë analistët, si dhe me Analistin Politik në rastin e çështjeve të fushatës.

Takimi i parë ndërmjet Analistit Politik, Koordinatorit të VAGJ-ve dhe VAGJ-ve, zhvillohet në takim informues të VAGJ-ve, në nisje të misionit. Toni dhe mënyra se si informacionet, edhe ato për kontekstin politik dhe për fushatën zgjedhore të ardhshme, u njoftohen VAGJ-ve, duhet të respektojë një prej parimeve bazë metodologjike të ODIHR-it – të thuhet vetëm fakte.

Deklaratat orientuese, që sugjerojnë mendime personale, bien ndesh me metodologjinë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Pjesa më e madhe e fakteve që paraqiten gjatë takimit informues të VAGJ-ve, janë ato që pasqyrohen në raportin e Misionit të ODIHR-it të Vlerësimit të Nevojave (MVN). Gjatë takimit informues dhe javës së parë të VAGJ-ve në rajone, Analisti Politik (dhe analistët e tjerë) nuk duhet t'u ofrojnë VAGJ-ve pyetje që kërkojnë një përgjigje të caktuar apo pyetje orientuese. Në vend të kësaj, VAGJ-të duhet të synojnë një gamë sa më të gjerë temash për shqyrtim për të kuptuar më mirë kontekstin politik në rajonin ku janë pozicionuar.

Procesi i vëzhgimit kërkon vizionin e gjerë dhe mendjen e hapur të njerëzve kureshtarë, me ide dhe hamendësi të përfuara nga përvoja e jetës. Në mënyrë progresive, nëpërmjet vëzhgimeve të drejtpërdrejta dhe informacioneve të grumbulluara nga takimet me një spektër të gjerë bashkëfolësish, VAGJ-të lëvizin metaforikisht nga pjesa e gjerë e hinkës drejt pjesës së ngushtë, teksa krijohen mendimet, arrihen përfundimet dhe bëhen vlerësimet. Manuali për Vëzhguesit Afatgjatë të Zgjedhjeve: Pas Ditës së Vëzhgimit të Zgjedhjeve u sugjeron VAGJ-ve një grup pyetjesh për bashkëfolësit, të cilat mbulojnë fusha tematike të ndryshme, përfshirë dhe fushatën zgjedhore. Këto pika për hulumtim duhet të ngrihen në mënyrë sistematike me sa më shumë bashkëfolës që të jetë e mundur, për të siguruar njëtrajtshmëri të çështjeve të diskutuara dhe për të mundësuar kontroll krahasimor dhe kryqëzim të efektshëm të informacionit.

Për të pasur komunikim dhe udhëzime të qenësishme dhe të efektshme, Analisti Politik duhet të synojë që të informojë vazhdimisht Koordinatorin e VAGJ-ve dhe VAGJ-të, në lidhje me zhvillimet në të gjithë vendin, përfshirë dhe ndarjen në kohë të informacioneve përkatëse nga takimet me bashkëfolësit në kryeqytet. Koordinatorin e VAGJ-ve dhe Analistin Politik duhet të mendojnë të përdorin mjetet e mëposhtme, kur të caktojnë afatet kohore të detyrave të VAGJ-ve:

Kalendari zgjedhor – krijohet nga OAZ-ja dhe ofron afatet e veprimtarive kryesore në lidhje me zgjedhjet, që vlejné për institucione të ndryshme. Ky është dokument publik dhe shpesh përmban shumë hollësi. Misioni përgatit një variant të shkurtuar për lehtësi përdorimi dhe nxjerr afatet që kanë rëndësi për ekipet e VAGJ-ve. Për shembull, Analisti Politik mund të dojë të dijë nëse administrata vendore po i përmbush përgjegjësitë e saj në lidhje me zgjedhjet, sipas kalendarit. Disa shembuj të këtyre përgjegjësive janë: caktimi në kohë i hapësirave publike për veprimtaritë e fushatës ose për ekspozimin e materialeve, heqja e posterave për të pasqyruar nisjen e heshtjes zgjedhore etj.

Kalendari i misionit – që përfshin afatet për raportet e VAGJ-ve dhe për raportet publike të misionit. Koordinatori i VAGJ-ve duhet të sigurohet që gjetjet nga rajonet të raportohen në kohë, që të përfshihen në raportet e misionit. Kalendari i misionit përmban afate për botimin e raporteve të misionit, të cilat, vetvetiu, përcaktojnë edhe programin e raportimit për VAGJ-të. Për të pasur raportim të saktë, është i rëndësishëm raportimi në kohë nga ana e VAGJ-ve dhe vënia në dispozicion e një kohe të mjaftueshme për Koordinatorin e VAGJ-ve për të diskutuar shqetësimet e mundshme me ekipin dhe që VAGJ-të të mund ta ndjekin më tej ndonjë çështje.

Përmbledhja javore e VAGJ-ve - (trajtuar më hollësisht në vijim) ofron një përmbledhje të informacioneve nga rajonet në lidhje me fushatën dhe nënvizon tendencat e vërejtura gjatë zhvillimit të fushatës, përgjatë periudhës së raportimit. Gjithashtu, përmbledhja e ndihmon Analistin Politik, nëpërmjet Koordinatorit të VAGJ-ve, ta drejtojë vëmendjen e VAGJ-ve drejt përparësive të vëzhgimit dhe i jep shtysë realizimit të detyrave që u janë caktuar VAGJ-ve. Për shembull, nëse përmbledhja përmend që disa ekipe kanë vërejtur prishjen e posterave të një kandidati të caktuar, Analisti Politik mund të kërkojë komente nga të gjitha ekipet nëse edhe ata e kanë vërejtur një gjë të tillë, apo të shqyrtojë nëse ekipet kanë takuar përfaqësues të kandidatit për të peshuar mendimin e këtij të fundit dhe për të mësuar nëse ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë ndonjë veprim.

Memorandumi për rregullat e fushatës – krijohet nga Analisti Politik, shpesh, në konsultim me Analistin Ligjor. VAGJ-të duhet të kuptojnë qartë ligjin dhe rregullat vendase për fushatën, në mënyrë që të marrin vendime të bazuara në informacion se ku duan ta përqendrojnë vëmendjen. Gjithashtu, është e domosdoshme të kuptohen rregullat e fushatës për të vlerësuar saktë, nivelin e zbatimit të legjislacionit vendas. Dokumenti duhet të përmbajë çështje të posaçme, që VAGJ-të duhet t'i kenë parasysh, kur vëzhgojnë fushatën dhe pyetje për hulumtim për bashkëfolësit.

Pyetjet që sugjerohen për hulumtim, gjatë hartimit të memorandumit për rregullat e fushatës:

- ✓ Kush është i autorizuar të bëjë fushatë?
- ✓ Cilat metoda fushate lejohen? Anasjelltas, cilat metoda janë të ndaluara shprehimisht?
- ✓ Cilat janë rregullat për tubimet në mjedise të jashtme dhe veprimtaritë e fushatës në mjedise të brendshme?
- ✓ Cilat janë rregullat për materialet e fushatës?
- ✓ Cilat janë rregullat për përdorimin e burimeve shtetërore për qëllim fushate?
- ✓ Cilat janë rregullat për përdorimin e pozitës zyrtare për qëllim fushate?
- ✓ Cilat veprimtari të fushatës, nëse ka, nuk janë të normuara qartësisht?

Çështje për t'u pasur parasysh kur u caktohen detyra dhe u jepen udhëzime VAGJ-ve:

- A janë formuluar me ton neutral, a janë të pakufizuara dhe a janë hartuar qartë pyetjet për hulumtim, që përdoren për të udhëzuar ekipet e VAGJ-ve në punën e tyre?
- A përmbajnë njoftimet informuese ditore, kujtesa për afatet e ardhshme në lidhje me fushatën dhe për gjërat, për të cilat pritet vëzhgim dhe raportim nga ekipet e VAGJ-ve?
- A kanë VAGJ-të informacion të mjaftueshëm nga ekipi kryesor (memo, shënime takimi, përditësime të njoftimit informues ditor etj.) për të kuptuar kontekstin e përgjithshëm të vëzhgimit që po kryejnë?
- A është i plotë dhe i hartuar qartë, memorandum i për rregullat e fushatës?
- A u shpjegohet ekipeve të VAGJ-ve, arsyetimi i përdorur për caktimin e përparësive të vëzhgimit?
- A përdoret mjaftueshëm komunikim jozyrtar për të udhëzuar dhe ndihmuar ekipe të caktuara të VAGJ-ve, të anashkalojnë vështirësitë gjatë vëzhgimit të fushatës?

4. Grumbullimi dhe përmbledhja e gjetjeve të VAGJ-ve

Raportet e VAGJ-ve, si raporti javor, raporti i incidenteve, raporti për çështje të posaçme dhe raportet e tubimeve, përbëjnë shtyllën kurrizore të vlerësimit të misionit.²⁸ Analisti Politik bazohet shumë tek ngjarjet e vëzhguara dhe informacionet e grumbulluara dhe të raportuara nga VAGJ-të për të kuptuar, krijuar mendim dhe për të vlerësuar cilësinë e fushatës. Prandaj, Koordinator i VAGJ-ve luan rol qendror në ndihmën ndaj Analistit Politik, që ky i fundit të kuptojë si zhvillimin, ashtu edhe përmbajtjen e fushatës në rajone. Që misioni të mbërrijë në analizë dhe vlerësim të plotë dhe të besueshëm të cilësisë së fushatës, Koordinator i VAGJ-ve duhet të grumbullojë, të ruajë dhe të organizojë në mënyrë sistematike informacionet që përftohen nga raportet e VAGJ-ve.

Radhitja e fakteve të zhveshura nga analiza nuk e përmbush qëllimin dhe Koordinator i VAGJ-ve duhet të nxisë rregullisht ekipet e VAGJ-ve, që të reflektojnë në lidhje me informacionet që marrin dhe që japin. Reflektimi ofron mundësinë për të kërkuar lidhjet ndërmjet informacioneve të ndryshme dhe për të përzgjedhur se çfarë duhet theksuar dhe çfarë duhet hequr. Procesi i vazhdueshëm i hulumtimit dhe reflektimit në lidhje me informacionet e marra dhe me rezultatet e shqyrtimit vijues, ndihmon aftësinë e VAGJ-ve për të kuptuar rajonet e tyre dhe vlerësimin që ata i bëjnë cilësisë së fushatës.

²⁸ Informacionet e hollësishme dhe udhëzimet për llojet e raporteve dhe për elementet që VAGJ-të duhet të fusin në to, gjenden tek Manuali për Vëzhguesit Afatgjatë të Zgjedhjeve – Pas Ditës së Vëzhgimit të Zgjedhjeve.

a. Raportet Javore të VAGJ-ve

Gjetjet që kanë të bëjnë me fushatën, pasqyrohen në dy prej kapitujve të Raporteve Javore të VAGJ-ve. Kapitulli për Administratën Vendore duhet të ofrojë informacione dhe shembuj që ilustrojnë nëse administrata e përbush rolin dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me fushatën dhe nëse ajo e respekton parimin e neutralitetit dhe të mosndërhyrjes. Është gjithashtu e rëndësishme që kapitulli të përmbajë informacione, që tregojnë nëse autoritetet vendore u ofrojnë të gjithë garuesve, mundësi të barabarta për të garuar me njëri-tjetrin. Siç theksohet më lart, ndërsa është e ditur se posti mbart njëfarë niveli përparësie, ekipet e VAGJ-ve duhet të raportojnë rastet, kur kjo keqpërdoret për përfitime zgjedhore. Gjatë leximit të raporteve të VAGJ-ve, Koordinator i VAGJ-ve dhe Analisti Politik duhet të mbajnë shënim treguesit ose shembujt konkretë të keqpërdorimit të pushtetit dhe duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse ka apo jo, ndarje të qartë ndërmjet veprimtarive të shtetit dhe atyre të partive.

Shembujt e keqpërdorimit të burimeve shtetërore apo të postit mund të përfshijnë:

- ♦ Përdorimin e mjediseve të zyrave qeveritare si seli të partisë apo të fushatës vetëm nga një garues;
- ♦ Praninë vetëm të posterave të bartësve të posteve, jashtë apo brenda ndërtesave publike;
- ♦ Trajtimin preferencial gjatë dhënies së lejeve për përdorimin e mjediseve publike për qëllim fushate;
- ♦ Inaugurimet e punëve publike, të cilat planifikohen në kohë fushate, apo përdorimi i këtyre inaugurimeve për të bërë fushatë;
- ♦ Nxitja apo përdorimi i programeve buxhetore madhore gjatë kohës së fushatës;
- ♦ Përdorimi i faqeve qeveritare të internetit për të reklamuar arritjet e kandidatit bartës i postit ose të partisë; dhe
- ♦ Rastet e trysnisë apo të shtytjeve ndaj punonjësve të sektorit publik, për të bërë fushatë apo për të votuar për bartësin e postit.

Kapitulli i Raportit Javor të VAGJ-ve, që trajton Mjedisin e Fushatës, përmban informacione për atmosferën nëpër rajone, në lidhje me mënyrën se si zhvillohet fushata dhe me veprimtaritë rajonale të garuesve në zgjedhje. Gjatë vëzhgimit dhe reflektimit për fushatën, Koordinatorit i VAGJ-ve duhet të nxisë VAGJ-të të kenë vëmendjen dhe të bëjnë dallimin ndërmjet përmbajtjes së fushatës dhe vetë procesit. Shembujt e informacioneve përmbajtësore përbëjnë tonin dhe thelbin e platformave dhe mesazheve të partive, që u njoftohen votuesve gjatë veprimtarive të fushatës, siç janë tubimet. Vlerësimet në lidhje me procesin kërkojnë vëmendje ndaj pyetjeve, të tilla si: nëse të drejtat civile dhe politike të të gjithë aktorëve respektohen nga përfaqësuesit e qeverisë apo nga institucionet shtetërore. Rastet e dhunës, frikësimit, trysnisë, pengesës ose diskriminimit gjatë fushatës, humbjes apo kërcënimit për humbje të vendit të punës përbëjnë gjithashtu shembuj të vëzhgimeve të fushatës në lidhje me procesin. Këto ngjarje, qoftë të vërejtura drejtpërdrejt, apo të raportuara tek VAGJ-të, duhet të përfshihen në kapitullin e Raportit Javor, që trajton Mjedisin e Fushatës, dhe të trajtohen më tej, në raporte të incidenteve të posaçme (shpjegohet më poshtë).

Pyetjet që i sugjerohen për hulumtim

Koordinatorit të VAGJ-ve gjatë shqyrtimit të Raporteve Javore:

- A shpjegohet mjaftueshëm toni dhe niveli i intensitetit të veprimtarive të fushatës?
- Cilat mjete të fushatës përdoren? Pse parapëlqehen disa metoda të caktuara dhe jo disa të tjera?
- A komunikojnë garuesit mesazhe dhe platforma, gjatë veprimtarive të fushatës?
- A ka informacion për nivelin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera, si dhe të grupeve të marginalizuara në fushatë?
- A bëhet vlerësimi i nivelit të respektimit të rregullave të fushatës nga aktorët e ndryshëm? A ofrohen shembuj të shkeljeve?
- A ka shqetësime të posaçme në lidhje me respektimin e lirive themelore nga aktorët e ndryshëm, përfshirë dhe autoritetet dhe garuesit? A janë të bazuara në prova mjaftueshëm?
- A ka shqetësime të posaçme në lidhje me trajtimin e barabartë të garuesve zgjedhorë nga ana e autoriteteve?
- A përmban kapitulli analizë dhe vlerësim progresiv të mjaftueshëm të mjedisit të fushatës?

Me pak fjalë, kapitujt për Administratën Vendore dhe Mjedisin e Fushatës, pjesë të Raportit Javor të VAGJ-ve, përbëjnë mjetet kryesore, që përdor Analisti Politik, për të peshuar nëse faktet dhe vlerësimet nga rajonet përputhen

me gjykimin dhe analizën e tyre, si dhe për të pohuar ose refuzuar përshtypjet e krijuara gjatë punës në nivelin kombëtar.²⁹

b. Raporti i Incidenteve

Në varësi të llojit të veprimtarisë, Raporti i Incidenteve mund të përmbajë informacione të grumbulluara gjatë takimeve me disa bashkëfolës dhe nga të gjitha palët e përfshira. Për shembull, një Raport i Incidenteve për vandalizimin e mjediseve të fushatës mund të ofrojë informacione të dhëna nga pala e prekur, nga policia, nga personi i dëmtuar dhe nga një gazetar, me të cilin ekipi i VAGJ-ve njihet dhe informacionet e të cilit kanë qenë të sakta në raste të mëparshme. Koordinator i VAGJ-ve duhet të sigurohet se të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me një incident të caktuar, të përmbliidhen në një dokument të vetëm, çka mundëson lehtësi përdorimi gjatë përgatitjes së raporteve të misionit.

Koordinatori i VAGJ-ve duhet t'i kërkojë një ekipi të VAGJ-ve, të hartojë një Raport të Incidenteve, kur ka ngjarje apo zhvillime të jashtëzakonshme apo me rëndësi të veçantë. Temat e Raporteve të Incidenteve mund të përfshijnë pengesat e veprimtarive të VAGJ-ve apo garuesve, rastet e dhunës, pretendimet serioze për shkelje të ligjit apo të të drejtave zgjedhore, rastet e frikësimit, trysninë ndaj votueseve, aktivistëve ose kandidatëve, tërheqjen e kandidatëve, tubimet me rëndësi të veçantë, apo fjalimet që përmbajnë nxitje të urrejtjes ose dhunës. Pjesa më e madhe e këtyre shembujve, normalisht, përbën shkelje të rregullave dhe praktikave të fushatave në vend dhe bie ndesh me detyrimet dhe standardet ndërkombëtare, me angazhimet politike dhe me praktikën e mirë.

Hollësitë e incidenteve të posaçme, që kanë të bëjnë me fushatën, duhet të klasifikohen dhe të ruhen në një bazë të dhënash/regjistër të incidenteve zgjedhore. Një vështrim i shpejtë i përmbajtjes së saj tregon llojin dhe shpejtësinë e çdo shkeljeje të detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, baza e të dhënave i ofron lexuesit një tablo të natyrës dhe cilësisë së përgjithshme të fushatës. Është një mjet shumë i rëndësishëm për hartimin e raporteve të misionit. Për të pasqyruar aspektet e rëndësishme të mjedisit të fushatës, shablloni i bazës së të dhënave mund të përgatitet bashkërisht nga Analisti Politik dhe nga Koordinator i VAGJ-ve. Ndërsa Koordinator i VAGJ-ve ofron informacionet përkatëse, të cilat i nxjerr prej

²⁹ Shpesh Koordinatorët e VAGJ-ve krijojnë një version përmbledhës të pashkurtuar të secilit prej të dy kapitujve. Versioni përmbledhës i pashkurtuar i lejon Analistit Politik t'i referohet një dokumenti për të krahasuar me lehtësi gjetjet e VAGJ-ve në të gjitha rajonet, për të njëjtën temë dhe për të njëjtën periudhë raportimi.

raporteve të VAGJ-ve (javore, të incidenteve dhe të tubimeve), mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave të incidenteve, zakonisht, është pjesë e kompetencave të Analistit Politik.

Lista e kontrollit për përpilimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave/regjistrin të incidenteve:

Përpilimi

- Radhitja e të gjitha shkeljeve të mundshme në lidhje me fushatën – rregullisht; kjo radhitje duhet të jetë pasqyruar tashmë, në memon e fushatës, të përgatitur bashkërisht nga Analistët Politikë dhe Ligjorë;
- 4 pyetjet (kush, çfarë, ku, kur);
- Burimi i informacionit;
- Niveli i besueshmërisë së burimit dhe të informacionit; dhe
- Indeksimi (ose ofrimi i link-ut) për tek raporti i pashkurtuar javor i VAGJ-ve – i incidenteve dhe i tubimeve, sipas rastit.

Mirëmbajtja dhe përditësimi

- A është i plotë informacioni që ofrohet për secilin zë?
- A indeksohet/a i referohet secili prej zërave raportit të plotë të pashkurtuar të VAGJ-ve?
- A është baza e të dhënave e lehtë për përdoruesin dhe e thjeshtë për t'u kuptuar, çka e bën më të thjeshtë përdorimin si referencë nga analisti?

c. Raportet e Tubimeve

Pas vëzhgimit të një tubimi të fushatës, ekipet e VAGJ-ve duhet të hartojnë një Raport të Tubimit, i cili përshkruan formën dhe zhvillimin e veprimtarisë, si dhe përmbytjen dhe tonin e mesazheve të fushatës. Tubimet e fushatës i japin mundësi misionit të kuptojë:

- Atmosferën e përgjithshme të fushatës (p.sh.: nëse ka qenë festive, e tensionuar, e orkestruar, spontane);
- Pjesëmarrjen në veprimtari (numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe ndarjen sipas gjinisë);

- › Përmbajtjen dhe tonin e fjalimeve (përfshirë shtytjen);
- › Reagimet e publikut;
- › Cilësinë në të cilën folësit u drejtohen pjesëmarrësve (shpesh është tregues për të parë nëse është keqpërdorur përparësia e postit);
- › Nivelin e pjesëmarrjes së grave, pakicave kombëtare, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe të grupeve të tjera të marginalizuara, qoftë si folës, apo si pjesëmarrës, si dhe nëse ka mesazhet që u drejtohen këtyre grupeve; dhe
- › Shkallën e pranisë së policisë.

Në varësi të situatës, Koordinatori i VAGJ-ve mund t'i kërkojë ekipit që të hartojnë gjithashtu një raport të incidentit pasi të kenë zhvilluar takime me bashkëfolës të tjerë. Nëse, për shembull, veprimtaria është ndërprerë ose nëse ekipi i VAGJ-ve ka vëzhguar apo ka marrë raportime për keqpërdorim të burimeve administrative për organizimin e veprimtarisë dhe/ose gjatë zhvillimit të vetë veprimtarisë, ata duhet ta tregojnë qartësisht këtë në raport duke ofruar sa më shumë informacione që të jetë e mundur. Bashkëbisedimet me pjesëmarrësit në veprimtari mund të nxjerrin në pah nëse ndokush është detyruar të organizojë, marrë pjesë apo të sigurojë pjesëmarrje të caktuar në veprimtari.

Secili Raport i Tubimit shënohet tek ditari i tubimeve, i cili, zakonisht, përpilohet dhe mirëmbahet nga Koordinatori i VAGJ-ve. Për qëllim të Raportit Përmbledhës Javor të VAGJ-ve dhe kur vlen për raportet publike të misionit, Koordinatori i VAGJ-ve ofron statistikat, narrativat dhe analizat e mëposhtme:

- › Numrin e plotë të tubimeve të vëzhguara për secilin garues në zgjedhje; kjo gjë mund të tregojë strategjinë e fushatës së garuesit;
- › Elementet e posaçme rajonale, përfshirë rajonet, të cilave garuesit u japin përparësi, dhe analizën e arsyeve të mundshme, në bazë të informacioneve që ofrohen nga bashkëfolësit;
- › Pjesëmarrjen e publikut, përfshirë ndarjen e përafërt gjinore;
- › Tablonë e nivelit të pjesëmarrjes së grave, pakicave kombëtare, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe grupeve të tjera të marginalizuara; dhe
- › Tendencat, nëse ka, të shkeljeve të rregullave të fushatës përpara apo përgjatë veprimtarisë dhe se kujt garuesi i vishen shkeljet.

Lista e kontrollit për përpilimin e ditarit të tubimeve:

- 4 pyetjet (kush, çfarë, ku, kur);
- Folësit, së bashku me një ndarje gjinore, dhe cilësinë në të cilën ata u drejtohen publikut;
- Numrin e plotë të pjesëmarrësve në secilën veprimtari;
- Ndarjen gjinore të përlogaritur të pjesëmarrësve në secilën veprimtari;
- Mesazhet kryesore, përfshirë fusha të ndara për mesazhet për çështjet gjinore dhe pakicat kombëtare;
- Gjuha/gjuhët e përdorura nga folësit;
- Përdorimi i gjuhës që nxit urrejtje ose dhunë, dhe gjuha e ndezur;
- Shkeljet e rregullave të fushatës gjatë veprimtarisë; dhe
- Çdo koment tjetër me rëndësi nga VAGJ-të.

d. Raportet për çështjet e posaçme dhe formularët e fushatave

Ndonjëherë, disa vëzhgime kanë nevojë për analiza plotësuese dhe më të thelluara se sa ato që përfshihen në Raportin Javor të VAGJ-ve. Në raste të tilla, Analisti Politik, pas diskutimit me Koordinatorin e VAGJ-ve, mund të përpilojë një shënim informues të shkurtër, që përmban edhe disa pyetje që kërkojnë përgjigje nga VAGJ-të.

Për shembull, kur Analisti Politik kërkon të kuptojë më mirë nëse pretendimet për trajtim preferencial të disa garuesve nga autoritetet, janë me baza, Koordinatorin e VAGJ-ve mund t'u kërkojë VAGJ-ve t'i shënojnë përgjigjet e disa pyetjeve të posaçme, në një tabelë. Kjo shërben si një prej disa elementeve përbërëse të përfundimeve paraprake në lidhje me faktin se a kanë arritur autoritetet të mundësojnë fushë loje të barabartë për garuesit zgjedhorë, gjatë periudhës së fushatës.

Ndonjëherë ka edhe mjete të tjera, si formularët në internet, që hartohen nga Analisti Politik për të krijuar një tablo të përgjithshme për mjedisin e fushatës apo për çështje të posaçme, gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore. Përgjithësisht, formulari përmban lloje të ndryshme pyetjesh (po/jo, shpesh-tësinë etj.) dhe mund të ndihmojë Analistin Politik të kuptojë më mirë shkallën dhe përhapjen e një çështjeje të caktuar, që lidhet me fushatën.

e. Raportet Përmbledhëse Javore

Raporti Përmbledhës Javor, i cili, zakonisht, njihet edhe me emrin Raporti Javor i VAGJ-ve në Terren, është përmbledhje e të gjitha vëzhgimeve të fushatës, gjetjeve dhe analizave të raportuara nga ekipet e VAGJ-ve, përgjatë një periudhe raportuese të caktuar. Informacionet për përmbledhjen javore duhet të nxirren nga raportet javore, ato të incidenteve, të tubimeve dhe të çështjeve të posaçme. Koordinatori i VAGJ-ve i sistemon të gjitha informacionet në një dokument të kuptueshëm, që bazohet tek faktet, që synon të nënvizojë tendencat që mbështesin analizën e bërë. Gjatë përgatitjes së përmbledhjes, Koordinatori i VAGJ-ve përqendrohet njëkohësisht, tek tri detyra kryesore:

- Sigurimin se zbatohet metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Është e rëndësishme që të paraqiten të gjitha aspektet e veprimtarive që lidhen me zgjedhjet. Nëse bëhen vlerësime negative të zhvillimit të një veprimtarie, është mirë që ato të shoqërohen me narrativë për të bërë ndarjen ndërmjet gabimeve rastësore dhe praktikës së keqe të qëllimshme. Ilustrimet që përfshihen në përmbledhjen javore duhet të jenë “të blinduara” (d.m.th., t’i rezistojnë oponencës) dhe informacionet duhet të jenë të përdorshme në raportet e misionit;
- Kontrollin e vërtetësisë së fakteve duke u konsultuar gjerësisht me VAGJ-të. Shqyrtimet vijuese të VAGJ-ve ose faktet e pakonsultuara plotësisht, pasqyrohen si të tilla në përmbledhje; dhe
- Shqyrtimin e lidhjes logjike të argumentimeve dhe lidhjeve ndërmjet fakteve, analizave dhe përfundimeve.

Që Raporti Përmbledhës Javor të jetë i dobishëm dhe i qenësishëm, ai duhet:

- Të ofrojë nivel (sasi) dhe larmi (shumëllojshmëri) burimesh, nga të cilat merren informacionet. Koordinatori i VAGJ-ve krijon referenca të hollësishme, edhe për numrin e përgjithshëm të takimeve të zhvilluara me secilin garues dhe për numrin e përgjithshëm të veprimtarive të fushatës, që janë vëzhguar;
- Të përdorë strukturë të qartë, tituj e nëntituj, në mënyrë që informacioni të jetë i organizuar sipas temave. Për shembull, nëntitujt në kapitullin e Mjedisit të Fushatës mund të përmbajnë: mesazhet e fushatës; metodat e fushatës; pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara; shkeljen e rregullave të fushatës (të cilat mund të ndahen më tej në keqpërdorim të burimeve administrative; blerje të votave; dhunë; prishje të posterave etj.);

- Të nënvizojë tendencat e përgjithshme në vend, si ato pozitive, ashtu edhe ato negative; dhe të
- Të ketë ekuilibër ndërmjet informacioneve tejet të hollësishme dhe atyre të paplota.

f. Raportet Përfundimtare të VAGJ-ve

Raportet Përfundimtare të VAGJ-ve ofrojnë një vlerësim të përgjithshëm të procesit zgjedhor. Veçanërisht, raporti ofron vlerësimin dhe përfundimet e ekipit të VAGJ-ve në lidhje me tërësinë e procesit, përfshirë dhe zhvillimet e rëndësishme paszgjedhore. Është me rëndësi të theksohet që ai përmban rekomandime konkrete për autoritetet e vendit pritës, në lidhje me përmirësimin e procesit apo afrimin e tij me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe me angazhimet e OSBE-së. Informacionet e Raportit Përfundimtar të VAGJ-ve shqyrtohen për pasqyrim të mundshëm në Raportin Përfundimtar të misionit.

Ndërsa pjesa më e madhe e informacioneve dhe vëzhgimeve që kanë të bëjnë me fushatën, pasqyrohen në raportet javore ose të tjera, kur është e mundur, Raporti Përfundimtar i VAGJ-ve duhet të përfshijë zhvillimet paszgjedhore, që kanë vlerë për Analistin Politik. Ndërsa ekipi kryesor ka përgjegjësinë e përgjithshme për hartimin e rekomandimeve të misionit, Raporti Përfundimtar i VAGJ-ve ofron informacione me vlerë, në bazë të vëzhgimeve rajonale. Gjithashtu, Raporti Përfundimtar i VAGJ-ve u jep VAGJ-ve një platformë për dhënien e komenteve për të gjitha aspektet e misionit, si dhe për dhënien e ideve dhe propozimeve për përmirësimin e metodologjisë së ODIHR-it për vëzhgimin, edhe për fushatën zgjedhore.

5. Pretendimet në lidhje me fushatën

Vëzhguesit e zgjedhjeve nuk e kanë mundësinë të vëzhgojnë drejtpërsëdrejti çdo incident të fushatës përgjatë misionit, prandaj atyre u sillen në vëmendje pretendime të shumta për shkelje gjatë fushatës dhe çështje të tjera, që shqetësojnë publikun. Për këtë arsye, vëzhguesit duhet të shqyrtojnë se sa i rëndë është incidenti i pretenduar, në mënyrë që të caktojnë përparësitë se cilat pretendime të shqyrtojnë më me imtësi. Metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin bazohet tek ndjekja e arsyeshme, e kujdesshme dhe e përpiktë e pretendimeve dhe e raportimeve për shkelje gjatë fushatës, apo për incidente, të tilla si: dhuna, frikësimi ose trysnia ndaj votuesve dhe blerja e votave. Referimet e këtyre rasteve shqyrtohen me kujdes dhe disa herë nga anëtarë të ndryshëm të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve, për të

konfirmuar vërtetësinë e gjetjeve dhe besueshmërinë e pretendimit, përpara se të mbërrihet në përfundime në raportet e ODIHR-it për zgjedhjet.

Koordinatori i VAGJ-ve dhe Analisti Politik mund t'i këshillojnë ekipet e VAGJ-ve në lidhje me kriteret që duhet të marrin parasysh, kur vendosin përparësitë në lidhje me atë çfarë do të ndjekin. Për përfshirjen apo jo të rasteve të frikësimit, trysnisë apo shkeljeve të rënda të rregullave të fushatës në raportet publike të misionit, metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin kërkon nivelin më të lartë të shqyrtimit të rasteve.

Praktikisht, kjo do të thotë se vërtetësia e fakteve të marra nga rajonet, nga ekipet e VAGJ-ve, si dhe vlerësimet e tyre, duhet t'u rezistojnë disa niveleve të vërtetimit. Shqyrtimi nis me Koordinatorin e VAGJ-ve dhe me Analistin Politik dhe mund të përfshijë edhe analistë të tjerë. Koordinatori i VAGJ-ve, si operatori parësor i komunikimit, merr drejtimin për t'u siguruar që faktet të jenë "të blinduara", të besueshme dhe që të grumbullohen informacione të mjaftueshme. Të gjitha palëve në një ngjarje u ofrohet mundësia për të paraqitur pikëpamjet e tyre. Të gjithë këta faktorë merren parasysh gjatë vendimit për të përfshirë apo jo, një ngjarje në raportet e misionit.

Ndonjëherë, vëzhgues të caktuar mund të kenë mendim të ndryshëm ose t'i interpretojnë ndryshe informacionet apo vërtetësinë e tyre. Është shumë e rëndësishme të ketë diskutime dhe shkëmbime të rregullta ndërmjet vëzhguesve për të mbërritur në një vlerësim të drejtë, të saktë, të paanshëm dhe të pavarur të fushatës zgjedhore. Metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parashikon posaçërisht që VAGJ-të të punojnë në ekipe shumëkombëshe dhe që analistët e ekipit kryesor të kenë formime dhe kombësi të ndryshme, në mënyrë që të bëhet një vëzhgim dhe vlerësim i paanshëm dhe i pavarur i fushatës zgjedhore.

a. Llojet e pretendimeve

Më poshtë, mund të gjeni një listë joshteruese të shkeljeve që lidhen me fushatën, ose të çështjeve që shqetësojnë publikun, të cilat shpesh sillen në vëmendjen e vëzhguesve, në formën e pretendimeve:

- › Dhuna fizike, por edhe ajo psikologjike ose në internet;
- › Frikësimi dhe/ose trysnia ndaj votuesve ose garuesve zgjedhorë;
- › Shkatërrimi i pronës dhe i materialeve të fushatës;
- › Keqpërdorimi i burimeve administrative për qëllim fushate;
- › Largimet nga puna, uljet në detyrë dhe transferimet;

- › Trysnia ndaj punonjësve të administratës publike;
- › Trajtimi i pabarabartë i garuesve zgjedhorë nga ana e autoriteteve;
- › Zyrtarët publikë që bëjnë fushatë;
- › Trysnia ose kërcënimet ndaj gazetarëve apo bloggerëve; dhe
- › Blerja e votave.

b. Vërtetimi i pretendimeve

Për ndjekjen dhe vlerësimin e llojeve të caktuara të pretendimeve si të besueshme dhe të bazuara, për të justifikuar përfshirjen e tyre në raportet e misionit, pikat e mëposhtme mund t'u vijnë në ndihmë VAGJ-ve, Analistit Politik dhe Koordinatorit të VAGJ-ve:

- › Ruani një nivel të shëndetshëm skepticizmi kur përballeni me pretendime;
- › Kryqëzoni informacionet që vijnë nga burime të ndryshme dhe të larmishme;
- › Grumbulloni prova të prekshme;
- › Shqyrtoni mundësinë për të zhvilluar vizita pa paralajmërim, kur është e dobishme; dhe
- › Kërkoni dokumente dhe kopje të ankesave, kur është e dobishme.

Vëzhguesit nuk duhet të reagojnë verbërisht ndaj çdo pretendimi apo thashethemi që dëgjojnë, por duhet të kenë një nivel të shëndetshëm skepticizmi. Koordinatori i VAGJ-ve duhet t'u kujtojë rregullisht ekipeve të VAGJ-ve, që të jenë të vëmendshëm si për idetë e tyre ekzistuese, ashtu edhe për rrezikun që, ndonjëherë, bashkëfolësit mund të paraqesin “fakte” në mënyrë mjaft bindëse dhe të sajojnë burime të tjera “të besueshme” për të mbështetur deklaratat e tyre. Në fund, i mbetet logjikës dhe rënies dakord të të dy vëzhguesve të ekipit të VAGJ-ve, nëse është e nevojshme, duke u këshilluar edhe me Koordinatorin e VAGJ-ve, për të përcaktuar se cilat pretendime duhet të vlerësohen më tej dhe cilat mund të lihen me aq.

Kryqëzimi krahasimor i informacioneve që kanë të bëjnë me fushatën me një diapazon të gjerë të burimeve, të cilat nuk kanë lidhje apo varësi me njëra-tjetrën, është një masë e efektshme, edhe pse kërkon kohë, për të shmangur përpjekjet e aktorëve për të përdorur vëzhguesit. Me fjalë të tjera, burimet që përdoren për kryqëzimin krahasimor të informacioneve, nuk duhet t'i paraqiten ekipit të VAGJ-ve nga i njëjti person.

Koordinatori i VAGJ-ve duhet të vlerësojë rregullisht se si dhe në çfarë konteksti i kanë evidentuar burimet, ekipet e VAGJ-ve. Kjo duhet të theksohet qartësisht në raportet e VAGJ-ve. Pas diskutimit ndërmjet Koordinatorit të VAGJ-ve dhe Analistit Politik, ekipeve të VAGJ-ve mund t'u kërkohet të shqyrtojnë dhe të raportojnë për praninë dhe/ose përhapjen e pretendimit në fjalë në rajonet e tyre, për të përcaktuar nivelin e shtrirjes në të gjithë vendin. Në fund, Analisti Politik duhet të përpiqet të verifikojë nëse bashkëfolësit në kryeqytet e kanë dëgjuar pretendimin në fjalë, nëse ka shqetësime të posaçme dhe nëse është ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për të nisur një hetim zyrtar. Si rregull i përgjithshëm, një pretendim që shtrihet në segmente të ndryshme të shoqërisë e ka potencialin të jetë më i besueshëm se sa pretendimet që diskutohen vetëm nga anëtarët apo mbështetësit e një partie politike.

Edhe kur VAGJ-të nuk e kanë mundësinë të vëzhgojnë drejtpërsëdrejti një incident, apo nëse mbërrijnë në vendngjarje pasi incidenti të ketë ndodhur, ata duhet të përpiqen të grumbullojnë sa më shumë prova të prekshme, që të jetë e mundur. Provat i lejojnë misionit që të mbërrijë në një vlerësim faktik të cilësisë së fushatës, duke e bazuar vlerësimin në vëzhgime të drejtpërdrejta dhe në raportime të besueshme nga ana e bashkëfolësve të misionit. Shembujt tipikë të provave të prekshme mund të përfshijnë:

- › Fotografitë e një zyre zgjedhore të vandalizuar;
- › Fotografitë e projekteve të financuara nga shteti, të cilave u mbivendosen stemat e ndonjë partie politike, përgjatë ndonjë veprimtarie të fushatës;
- › Kopje të udhëzimeve në lidhje me fushatën, që janë përgatitur nga drejtuesit rajonalë të institucioneve; dhe/ose
- › Kopje të ndonjë raporti apo ankese, që ankuesi e ka paraqitur përpara autoritetit kompetent.

Pretendimet për kërcënime ose frikësim janë të vështira për t'u provuar. Duhet përdorur përqasje hulumtuese, edhe pse kërkon, ndjeshëm, më shumë kohë dhe punë më të ndërlikuar se sa mbledhja e fakteve për një incident të dhunshëm, për shembull. Vërtetimi kërkon që VAGJ-të ta kuptojnë rajonin e tyre në mënyrë të plotë, të bashkojnë pjesë të ndryshme të informacionit nga burime të ndryshme dhe të larmishme, të mbajnë shënim ngjarjet e vëzhguara dhe raportimet e bëra, si dhe të jenë vazhdimisht të vëmendshëm për informacione plotësuese, që vërtetojnë apo hedhin poshtë deklaratat apo gjetjet e mëparshme.

Shumë shpesh, rastet e frikësimit apo të blerjes së votave janë pothuajse të pamundura për t'u vëzhguar dhe rrallëherë njoftohen me shkrim. Për shembull, raportimet e trysnisë për të mbështetur një garues zgjedhor të caktuar (apo për të mos bërë fushatë për një alternativë tjetër) janë jashtëzakonisht të vështira për t'u dokumentuar. Po njësoj, dikush që ka pësuar trysni apo kërcënim, ngurron të flasë nga frika e

ndëshkimit. Të gjithë vëzhguesit e zgjedhjeve nuk duhet të harrojnë se pasi misioni të jetë larguar nga vendi pritës, bashkëfolësit vendas do të vijojnë të jetojnë dhe të punojnë në atë vend. Vëzhguesit e ODIHR-it duhet të kenë ndjeshmëri, maturi dhe konfidencialitet maksimal, kur synojnë të takohen me viktime të pretenduara të frikësimit dhe/ose trysnisë.

Vërtetimi i pretendimeve është proces që kërkon kohë, gjatë një periudhe që, për vetë VAGJ-të, është e shkurtër dhe e ngarkuar. Për të vërtetuar pretendime të posaçme, VAGJ-të duhet të zhvillojnë disa veprimtari vijuese, të tilla si: organizimi i takimeve plotësuese me bashkëfolës të ndryshëm dhe, mbase, të udhëtojnë edhe larg për të vëzhguar dhe konfirmuar ngjarje të caktuara. Ndjekja e pretendimeve për frikësim ose kërcënim është më e efektshme kur vëzhguesi e ka kuptuar mirë kontekstin politik dhe mjedisin e fushatës dhe kur ka ndërtuar marrëdhënie profesionale me bashkëfolësit në bazë të besimit. Procesi i ndjekjes përfshin formimin e kujdesshëm të mozaikut, duke i parë ngjarjet nga kënde të ndryshme dhe duke mbetur gjithmonë i hapur për mundësinë që përshtypjet fillestare të dikujt mund të mos jenë të bazuara në fakte. Intuita e mirë apo ndjesia është pikënisje shumë e rëndësishme, por nuk është pikëmbërritje.

Për shembull, në bazë të një informacioni të një gazetari, ekipi i VAGJ-ve mund të zgjedhë të shkojë pa paralajmërim tek ndërtesa e bashkisë dhe të vëzhgojë një grumbullim të mësuesve. Në vetvete, kjo nuk mjafton për të arritur në përfundimin se, gjatë grumbullimit, mësuesit janë udhëzuar nga administrata vendore të kryejnë detyra në lidhje me fushatën. Por, ky shërben si hap i parë, i mirë, për vërtetimin e pretendimeve që mësuesit janë detyruar të kryejnë detyra në lidhje me fushatën. Kërkimi i informacioneve plotësuese, bashkëbisedimi me burime të pavarura nga njëri-tjetri dhe vëmendja ndaj të rejave, e ndihmon ekipin e VAGJ-ve të hedhë poshtë ose të vërtetojë pretendimin fillestar.

Shtojca 1: Materialet dhe burimet

OSBE

Angazhimet për Dimensionin Njerëzor – Përmbledhje e të gjitha dokumenteve referencë të OSBE-së

Vëllimi 1, Përpilimi Tematik, botimi i tretë, 2012

www.osce.org/odihr/76894

Vëllimi 2, Përpilimi Kronologjik, botimi i tretë, 2012

www.osce.org/odihr/76895

Dokumente nga organet vendimmarrëse të OSBE-së

www.osce.org/resources/documents/decision-making-bodies

Manuale dhe udhëzues të ODIHR-it për zgjedhjet

www.osce.org/odihr/elections/119893

Manual për Vëzhgimin e Zgjedhjeve: botimi i gjashtë, 2010

Manual për Vëzhgimin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve Zgjedhore, 2019

Manual për Vëzhgimin dhe Nxitjen e Pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuar në Zgjedhje, 2017

Udhëzues për Ofruesit e Sigurisë Publike në Zgjedhje, 2017

Manual për Ndjekjen e Rekomandimeve Zgjedhore, 2016

Manual për Vëzhgimin e Financimit të Fushatës, 2015

Manual për Vëzhgimin dhe Nxitjen e Pjesëmarrjes së Pakicave Kombëtare në Procesin Zgjedhor, 2014

Udhëzues për Rishikimin e një Kuadri Ligjor për Zgjedhjet, botimi i dytë, 2013

Manual për Vëzhgimin e Teknologjive të Reja të Votimit, 2013

Manual për Vëzhgimin e Regjistrimit të Zgjedhësve, 2012

Manual për Monitorimin e Medias nga Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve, 2012

Manual për Vëzhguesit Afatgjatë të Zgjedhjeve, 2007

Manual për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Gruas në Zgjedhje, 2004

Manual për Vëzhguesit Vendorë të Zgjedhjeve, 2003

Udhëzues dhe raporte të tjera të përmendura

Udhëzues për Lirinë e Tubimit Paqësor: botimi i dytë, 201

www.osce.org/odihr/73405

Angazhimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë së COVID-19-ës, 2020

www.osce.org/files/f/documents/e/c/457567_0.pdf

Opinione dhe komente ligjore të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet
www.osce.org/odihr/elections/195256

Legislationline.org – Baza e të dhënave e ODIHR-it për legjislacionin vendas për zgjedhjet
www.legislationline.org

Kurs mësimor përmes mjeteve të komunikimit elektronik për vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it
www.odihobserver.org

OKB

Baza e të dhënave e përmbledhjes së traktateve të OKB-së
<https://treaties.un.org/>

Organet e OKB-së për të drejtat e njeriut
www.ohchr.org/EN/HRBodies/Pages/HumanRightsBodies.aspx

Procedurat e veçanta të Këshillit për të Drejtat e Njeriut
www.ohchr.org/EN/HRBodies/SP/Pages/Welcomepage.aspx

Raportuesi Special për të Drejtat e Lirisë së Tubimit Paqësor dhe të Organizimit
www.ohchr.org/en/issues/assemblyassociation/pages/srfreedomassembly-associationindex.aspx

Raportuesi Special për Lirinë e Mendimit dhe të Shprehjes
www.ohchr.org/en/issues/freedomopinion/pages/annual.aspx

Rishikimi Periodik Universal
www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/UPRMain.aspx

Këshilli i Evropës

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
www.coe.int/en/web/human-rights-convention

Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore
<https://rm.coe.int/090000168092af01>

Kodi i Praktikës së Mirë për Referendumet

[www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2007\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2007)008-e)

Lista e Kontrollit për Sundimin e Ligjit e Komisionit të Venecias, 2016

[www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)007-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)007-e)

Baza e të dhënave e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{“article”:\[“P1-3”\]”}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{“article”:[“P1-3”]”})

Buletin faktik i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të drejtën për zgjedhje të lira

www.echr.coe.int/Documents/FS_Free_elections_ENG.pdf

Baza e të dhënave VOTA e Komisionit të Venecias – legjislacioni në lidhje me zgjedhjet

www.venice.coe.int/VOTA/en/start.html

KSHP

Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore

<https://cis-legislation.com/document.fwx?rgn=4669>

Konventa për Standardet e Zgjedhjeve Demokratike, të Drejtat dhe Liritë Zgjedhore

<https://cis-legislation.com/document.fwx?rgn=4711>

OSHA

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut

https://www.oas.org/dil/treaties_b-32_american_convention_on_human_rights.pdf

Karta Demokratike Ndëramerikane

https://www.oas.org/charter/docs/resolution1_en_p4.htm

BE

Karta për të Drejtat Themelore

www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

Traktati për Bashkimin Evropian

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

Traktati i Lisbonës

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12007L%2FTXT>

UNP

Baza e të dhënave për përfaqësimin e grave në parlamentet kombëtare

www.data.ipu.org

Fushatat zgjedhore janë pjesë shumë e rëndësishme e proceseve zgjedhore, ku kandidatët konkurrojnë për të marrë mbështetjen e votuesve. Gjatë fushatave zgjedhore, aktorët politikë u japin zgjedhësve energji, i gjallërojnë dhe i mobilizojnë, por njëkohësisht, në këto periudha vihen në provë liritë themelore. Fushatat zgjedhore u japin mundësi të gjithë aktorëve zgjedhorë, përfshirë dhe autoritetet, partitë politike dhe zgjedhësit, të tregojnë respekt për liritë themelore dhe të drejtat e njeriut.

Manuali parashtron qasjen e ODIHR-it ndaj vëzhgimit dhe vlerësimit të fushatave zgjedhore dhe mjediseve politike, ku zhvillohen këto të fundit. Ai mbështetet te detyrimet dhe standardet ndërkombëtare përkatëse për zgjedhjet demokratike, me vëmendje të veçantë tek angazhimet e OSBE-së dhe te praktikat e mira ndërkombëtare. Manuali ofron një paketë të përgjithshme elementesh, të cilët mund të përdoren nga kushdo që është i interesuar të vlerësojë një mjedis politik dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin e fushatave zgjedhore të qenësishme dhe pluraliste.

